



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE QARK
TIRANË, (DARQT)”**

(Auditim Përputhshmërie)

Tiranë, mars 2018



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

<i>Nr</i>	<i>Përmbatja</i>	<i>Faqe</i>
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3 - 6
II.	HYRJA	6- 11
a.	Objektivat dhe qëllimi.	
b.	Identifikimi i çështjes.....	
c.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
d.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
e.	Kriteret e vlerësimit.....	
f.	Standardet e auditimit.....	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	12 -14
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	14 - 99
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....	100-128
VI.	ANEKSE	129- 134



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

I.a.-Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë Arsimore Rajonale Qarku Tiranë (DARQT) në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1307/1, datë 19.12.2017, me afat auditimi nga data 26.12.2017 deri në datën 09.02.2018, për periudhën nga 30.09.2015 deri më 30.12.2017, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë dhe rregullshmërinë e operacioneve financiare të kryera nga ana e këtij institucioni, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me llogaridhënien vjetore, administrimin e fondeve buxhetore dhe zbatimin e procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të arsimtarëve, aspektet e menaxhimit financiar dhe të vlerësimit të sistemeve të kontrollit, etj.

I.b-Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi:

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENC A ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
1.	Llogaria 212 “Ndërtim dhe konstruksione” në Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara (aktivi i bilancit) ka të regjistruar vlerën 19,721,850 lekë, e cila detajohet në vlerën e ndërtesave të ish-subjektit “Qendra Ekonomike dhe garazh” me vlerë 12,064,250 lekë, (objekte që efektivisht nuk ekzistojnë për periudhën objekt auditimi dhe për rrjedhojë këto regjistrime denatrojnë treguesit e vërtetësisë së të dhënave të bilancit kontabël të këtij institucioni) si dhe në vlerën 7,667,600 lekë, që përfaqëson rikonstruksionin e zyrave që DAR ka në përdorim që nga viti 2006. Në vitin 2006 kur ky në institucion është transferuar dhe vendosur në mjediset e shkollës speciale „Luigj Gurakuqi“, vlera e rikonstruksionit është kontabilizuar si Aktiv i Qëndrueshëm i Trupëzuar, në llogarinë 219 „Ndërtesa“. Ky veprim kontabilizimi nuk është i drejtë sepse, në fakt ky objekt nuk është në pronësi të DAR Qark, por në bazë të përcaktimeve të pikave „2/b“ dhe „2/c“, të Aneksit nr. 1, që shoqëron VKM nr. 204, datë 26.03.20198 „Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit vendor“, i ndryshuar, pushteti lokal është kompetent, administron dhe përgjigjet për objektet arsimore.	TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET 42-62 NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT	E LARTE	1. Drejtori i DARQT të ngrejë një grup pune për të saktësuar e pasqyruar çfarë ka ndodhur me këto objekte, të ndërtojë gjurmën e auditimit për ecurinë e procesit të privatizimit apo kthimit të pronave, si dhe të informojë se çfarë janë kryer me këto objekte, (nëse janë privatizuar, zaptuar apo kthyer pronarëve) dhe vetëm pas administrimit të dhe saktësimit të dokumentacionit të plotë, në bashkëpunim me pronarët e truallit dhe ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të ndërmarrin veprimet e nevojshme ligjore dhe të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit. 2. Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme të kryejë sistemitet në librat e kontabilitetit dhe të reflektojë korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017, sa kontabilizuar padrejtësisht vlera e situacionit prej 7,667,600 lekë për rikonstruksion të mjediseve të shkollës speciale ■■■■■, (në pronësi të Bashkisë Tiranë), rikonstruksioni i kryer në vitin 2006 si shtesë e vlerës së AQT në zërin “Ndërtesa”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENC A ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
2.	Nga ana e Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme janë kryer llogaritjet e amortizimit, për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, objekti “Zyrat e Qendrës Ekonomike dhe Magazina”, në vlerën vjetore prej 197,219 lekë për v.2015 dhe për v.2016 lekë, objekte që efektivisht nuk ekzistojnë për periudhën objekt auditimi, dhe për rrjedhojë këto regjistrime denatrojnë treguesit e shpenzimeve në bilancin kontabël të këtij institucioni. Nga ana tjetër, edhe për llogaritja e amortizimit, për pjesën e rikonstruksionit të kryer sipas një fondi të akorduar nga MAS, llogaritjet për një objekt, i cili, nuk është në pronësi të DAR, sepse objektet shkollore janë në administrim të pushtetit vendor.	TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET 42-62 NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT	E LARTE	Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme, të marrë masa për rillogaritjen e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, për vitet 2015, 2016 e 2017 si dhe të kryejë sistemimet e nevojshme dhe të pasqyrojë situatën e duhur në kontabilitet e në pasqyrat financiare për vitin 2017.
3.	Tregues shumë të ulët të performancës mbi rekrutimet nga gara konkurruese e portalit “Mësues për Shqipërinë”. Më konkretisht, 1. Në Portalin “Mësues për Shqipërinë” për juridiksionin e DARQT, në konkurimin 2015-2016 dhe 2016-2017 kanë marrë pjesë 587 aplikantë gjithsej dhe janë sistemuar në vende vakante/definitive 98 kandidatë, ndërsa në pozicione provizore 49 kandidatë. Pra, konstatohet se vetëm 16,6 % e kandidatëve që kanë konkuruar nëpërmjet këtyre dy portaleve janë sistemuar me kontratë punësimi definitive, (ose vetëm 25 % janë punësuar nga pozicioni definitiv dhe zëvendësues). 2. Në Portalin “Mësues për Shqipërinë” 2015 dhe 2016 për DARQT janë sistemuar në vende vakante të gjithë kandidatët e profileve Arsim Special, përkatësisht 1 kandidat në portalin e vitit 2016-2017. Referuar të dhënave në tabelën e përgjithshme të renditjes së kandidatëve pjesëmarrës në portale, u evidentua se numrin më të lartë të kandidatëve, që janë punësuar, e përbëjnë ato të profilin Arsimi Fillor, Gjuha Angleze, Matematikë, etj. 3. Asnjëri nga kandidatët e profileve Shkenca Shoqërore, Gjuha Frënge, Gjuha Gjermane, Gjuha Italiane, të listuar në portalin 2015-2016 dhe kandidatët e profileve Gjeografi, TIK, Edukim Muzikor e Shkenca Shoqërore të listuar në portalin 2016-2017, nuk ka arritur të emërohet nëpërmjet DAR Qark Tiranë. Sa më sipër, bazuar dhe në këto indikatorë të matjes së performancës, nuk arrihen synimet dhe pritshmëritë e nismës së portalit, në bazë të së cilit, “kjo nismë do të krijojë mundësi për të rinjtë të cilëve do t’u ofrohen mundësi reale punësimi dhe përfitim të eksperiencave pozitive në drejtim të mësimdhënies. Angazhimi i tyre si mësues në zonat ku ata aplikojnë ose në komunitetet në nevojë i shërben pozitivisht çdo individ, por edhe vetë shoqërisë”, sikundër synohet me ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.	TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET 62-79 NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT	E LARTE	Të përsosën mekanizmat, për të nxitur jo vetëm pjesëmarrjen e mësuesve dhe të rinjve të diplomuar në procesin e konkurimit në portalin e punësimit “Mësues për Shqipërinë”, por edhe të krijojë shanset dhe mundësinë reale të punësimit të tyre. Në këtë mënyrë, kjo iniciativë mund të ndikojë në përmirësimin e cilësisë në arsim në komunitetet në nevojë si dhe në ndryshimin e mentalitetit të kërkuesve të punës në arsim, meqenëse, ende në disa shkolla të qarkut të Tiranës vijojnë ende të jenë të punësuar një numër i lartë i mësuesve jashtë profilin, apo i atyre pa arsimin përkatës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENC A ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
4.	Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për largimin e padrejtë nga puna të punonjësve, në shumën 12,234,657 lekë. Janë likuiduar shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas 14 urdhër shpenzimeve të kaluara në thesar për vitin 2015 për 5 persona në shumën 6,222,721 lekë, 3 urdhër shpenzime për vitin 2016 për 2 persona në shumën 1,747,075 lekë dhe 16 urdhër shpenzimeve në vitin 2017 për 5 persona në shumën 4,264,861 lekë. E gjithë shuma për ekzekutimin këtyre vendimeve gjyqësore, është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit, duke qenë se i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, në shumën 12,234,657 lekë gjithësej, ku përfshihen 368,200 lekë tarifa përmbartimore dhe shpenzime gjyqësore. Sa vepruar në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET 42-62 NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT	E LARTË	Drejtori i DARQT: a. të marrë masa për ndjekjen e gjithë shkallëve të gjyqësorit për çështjet gjyqësore që nuk ka vendim të formës së prerë, duke bërë një përgatitje serioze për përfaqësimin dhe mbrojtjen e tyre në gjykatë. b. të analizohen me përgjegjësi shumat e shenhuara për ekzekutimin vendimeve gjyqësore dhe shkaqet për situatën e këtyre pasojave financiare. Për këtë, të nxirret përgjegjësia për moszbatimin e dispozitave ligjore për çdo rast largimi nga puna të punonjësve dhe për zgjidhje të kontratës së punës, për këto shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, pasi u përkasin vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, në shumën 12,234,657 lekë në total, (ku përfshihen dhe 368,200 lekë tarifa përmbartimore dhe shpenzime gjyqësore), sa vepruar në kundërshtim me nenin 144; 153; 154 të ligjit nr. 7961, datë 11.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe përcaktimet e pikës 62, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit
5.	Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit për periudhën e audituar 2015 dhe 2016 gjendja e saj paraqitet respektivisht me vlerën 3,455,707 lekë dhe 3.143.230 lekë, si stok i 31,427 copë libra shkollorë jashtë katalogut. Kjo vlerë përfaqëson një kontingjent prej 89 artikujsh të regjistruar të librave stok, të regjistruar në v.2015 dhe 77 artikujsh në v.2016, ose 31,427 copë librash shkollorë jashtë katalogut, që përfaqëson përkatësisht: - Tekste të arsimit 9 vjeçar, 16.752 copë libra, me vlerë 1.670.555 lekë, - Tekste të arsimit të mesëm, 14.675 copë libra, me vlerë 1.472.675 lekë. Këto gjendje të stokut të librit në magazinë, janë krijuara gjatë periudhës 2002 - 2005, duke mbetur stok pasi janë jashtë <i>curricul-ave</i> (jashtë programit mësimor), e për pasojë nuk kanë vlera përdorimi. Krijimi i një nomenklature të tillë të librit shkollor stok prej 31,427 copë librash shkollor jashtë katalogut me vlerën 3,455,707 lekë lidhet vetëm me DAR Qark, (por kjo situatë rezulton dhe në DAR Qytet, ku stoku i librit në v.2015 është në vlerën 4,453,819 lekë, gjë që do të thotë se vetëm në dy DAR-et e Qytetit dhe Qarkut Tiranë arrin vlerën 7,9 milionë lekë), tregon për një proces të pa studiuar dhe një përdorim jo efektiv të fondeve të buxhetit për periudhat kur ata janë shpenzuar.	TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET 42-62 NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT	E LARTË	a. Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të evidentojë dhe vlerësojë gjendjen në shkallë vendi, të librit shkollor të mbetur stok, tekste që janë jashtë <i>curricul-ave</i> (jashtë programit mësimor), e për pasojë nuk kanë vlera përdorimi dhe mbi këtë bazë të hartojë e miratojë një udhëzim të posaçëm, se si do të veprohet për këtë kontingjent të teksteve shkollorë stok dhe jashtë funksionit, duke shqyrtuar gjetjen e mundësive për një përdorim eficient të këtyre vlerave. Ky proces duhet shoqëruar edhe me një analizë të shkaqeve, nxjerrjen e përgjegjësi dhe me reflektim në praktikatat aktuale, për të mos u përballur me situata të ngjashme në të ardhmen.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1307/1, datë 19.12.2017, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 26.12.2017 deri në datën 09.02.2018, në subjektin Drejtoria Arsimore Rajonale Qark Tiranë, (në vijim DARQT), për periudhën nga 30.09.2015 deri më 30.12.2017, u krye auditimi i Përputhshmërisë.

- a) **Titullin.** Auditim i përputhshmërisë.
- b) **Marrësi.** Raporti i drejtohet subjektit të audituar Drejtoria Arsimore Rajonale Qark Tiranë (DARQT).
- c) **Procedura e ndjekur:** Raporti i auditimit i është dërguar zyrtarisht institucionit dhe kthimi i projektraportit të nënshkruar së bashku me observacionet është bërë me shkresën nr. 372 prot, datë 29.02.2018 me lëndë “Dërgohen sqarimet për projektraportin e dërguar nga KLSH”, (prot në KLSH me nr 1307/4, datë 28.02.2018) dhe me shkresën nr. 422 prot, datë 08.03.2018 (prot në KLSH me nr 1307/5, datë 09.03.2018).
- d) **Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

- **Qëllimi i auditimit:**

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime¹

- **Objektivat e auditimit** synojnë:

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

- e) **Identifikimi i çështjes.**

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë arsimore vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi: mbështetjen e shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimet e këtij sektori, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtij shërbimi publik,

¹ -Rregullorja e procedurave të auditimit në KLSH, faqe 28



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me emërimin, lëvizjen paralele të mësuesve, respektimin e kriterëve mbi normat e ngarkesës mësimore, buxhetimi dhe shpenzimet, etj.

Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare në DARQT, realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

f) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).

Drejtori i DAQRT (Nëpunësi autorizues) znj. [REDAKTUAR], si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme (Nëpunësi zbatues) z. [REDAKTUAR] janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Komisioni i Vlerësimit për rekrutimin dhe lëvizjen paralele të arsimtarëve, i drejtuar nga z. [REDAKTUAR], Sektori i Kurikulës dhe Cilësisë, në bashkëpunim me specialistin e burimeve njerëzore, kanë përgjegjësinë e zbatimit të Udhëzimit të MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.

g) Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) nëse janë zbatuar konstatimet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga auditues jashtë KLSH, (auditimi i brendshëm i Ministrisë, Inspektimi Financiar Publik, etj).

d) Interesin publik ose pritshmëritë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)

e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe gjatë kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin DARQT, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

h) Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar
- ✓ ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ ligji nr. 160/2014, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015” dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit, ligji nr. 147/2015, datë 17.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”.
- ✓ ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
- ✓ ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014,
- ✓ ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- ✓ ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, etj.
- ✓ ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar me ligjin nr. 110/2015
- ✓ ligji Nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, etj.
- ✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”;
- ✓ VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
- ✓ VKM Nr. 194 datë 22.04.1999 “Për miratimi e strukturës së pagave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar.

- ✓ UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor...”, i ndryshuar.
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- ✓ Urdhër i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”,
- ✓ Urdhër i MF nr.89, datë 28.12.2015 "Për Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Performancës së Njësive Publike" , etj.

i) Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë” që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

j) Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve dhe Projekt Raportit të Auditimit, të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe shqyrtimit të objeksioneve të subjektit, u përgatit ky Raport i Auditimit.

k) Praktikë e ndjekura në kryerjen e auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320** dhe **ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nën gjykimin profesional të audituesit, për institucionin Drejtoria Arsimore Rajonale Qarku Tiranë (DARQT) grupi i punës ka marrë në konsideratë **faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet**. Për rrjedhojë niveli i precizionit për materialitetin pranohet në vlerën **20,814,218 lekë²**, dhe gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm **kanë risk të ulët deri në të moderuar**.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet **testeve të kontrolleve**. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri të moderuar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar vlerësimin përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon e konkretisht:

$\text{Risku i Auditimit} = \text{Risku i qënesishëm} * \text{Risku i kontrollit} * \text{Risku i Zbulimit}$
--

Nisur sa sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jofinanciar si p.sh krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në letër ose elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë.

l) Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

² Shiko Aneksin 1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari në Ministrinë e Financave dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm



III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

1. Informacioni i përgjithshëm:

DARQT është krijuar me VKM nr.66, datë 03.02.2010 “Për riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”, që në pikën nr. 6 të tij, përcakton se, “*Për qarkun e Tiranës të ketë dy drejtori arsimore rajonale, nga të cilat, DAR-i Tiranë, të mbulojë qytetin e Tiranës dhe DAR-i Tiranë të mbulojë fshatrat e Tiranës dhe Kavajën e fshatrat e saj*”.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 863, datë 27.10.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr 66, datë 03.02.2010 “Për riorganizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore”, janë bërë këto shtesa dhe përmirësime:

“Për qarkun e Tiranës të ketë dy drejtori arsimore rajonale: DAR-ja, Tiranë, që do të mbulojë qytetin e Tiranës, dhe DAR-ja e qarkut të Tiranës, që do të mbulojë fshatrat e Tiranës, ZA-në, Kavajë dhe ZA-në, Kamëz, që do të mbulojë edhe komunat Paskuqan dhe Zall - Herr.”

Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim formimin e çdo individi, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes, të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin dhe në mënyrë të veçantë:

- a) të njohë, të respektojë, të mbrojë identitetin kombëtar e të zhvillojë trashëgiminë dhe diversitetin tonë kulturor;
- b) të zhvillohet në aspektin etik, intelektual, fizik, social dhe estetik, të jetë i aftë të mendojë në mënyrë të pavarur, kritike e krijuese, t’u përshtatet ndryshimeve, të ketë vetëbesim e shpirt bashkëpunimi, të jetë i gatshëm të ofrojë ndihmesën e tij për mirëqenien, përparimin, lirinë e demokracinë;
- c) të ketë bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia, bashkëpunimi dhe respekti për të tjerët janë vlerat më të larta njerëzore;
- ç) të njohë dhe të respektojë traditat e popujve të tjerë;
- d) të ndërgjegjësohet për të përmbushur përgjegjësitë e tij për mbrojtjen e mjedisit.

Funksionimi i njësive arsimore vendore bazohet në nenin 30, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet:

1. Ministria përfaqësohet në nivelin vendor nga njësitet arsimore vendore, të cilat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura dhe organika e tyre miratohen me urdhër të Kryeministrit.

2. Njësitet arsimore vendore janë drejtoritë arsimore, në nivel qarku, dhe zyrat arsimore, në nivel rrethi.

3. Njësia arsimore vendore është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj.

4. Njësia arsimore vendore:

- a) zbaton Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;
- b) mbështetet institucionet arsimore për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor;
- c) bashkëpunon me njësinë bazë të qeverisjes vendore për planifikimin, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, si dhe për rastet e braktisjes së shkollës;
- ç) siguron për institucionet arsimore publike mjetet mësimore, sipas formulës “për nxënës”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

d) përdor fondin e veçantë të buxhetit vjetor për shpërblimin e punonjësve të institucioneve arsimore publike me arritje të shquara. Kriteret e përdorimit të këtij fondi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

DARQT ushtron aktivitetin e tij mbështetur në:

- ✓ Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- ✓ ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;
- ✓ ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 311 prot., datë 18.01.2011, “Për rregulloren e funksionimit të drejtorisë arsimore rajonale dhe zyrës arsimore”.
- ✓ si edhe udhëzime dhe rregullore të tjera, dalë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës në funksion të gjithë sa më sipër.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- a. **Objekti i këtij auditimi** është përputhshmëria e veprimtarisë dhe rregullshmëria e operacioneve financiare të kryera nga ana e subjektit DAR Qarku Tiranë përgjatë periudhës **30.09.2015** deri më **30.12.2017**
- b. **Qëllimi i auditimit:** është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315**)³. Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.
- c. **Fushëveprimi:** Janë audituar hartimi dhe zbatimi i parimeve të buxhetit të shtetit për vitet objekt angazhimi, saktësia e rregullshmëria e pasqyrave financiare të subjektit për vitin 2015 dhe 2016, (ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit për pagat, sigurimet shoqërore, transportin, etj); procedurat e rekrutimit dhe lëvizjes paralele për arsimtarët, si edhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në periudhën 30.09.2015 - 30.12.2017. Nuk ka ndonjë kufizim i mundshëm që mund të ketë ndodhur gjatë kryerjes së auditimit.

³ Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.



IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Auditim mbi zbatimimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Nga auditimi mbi zbatimimin e rekomandimeve për auditimin kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në DARQT, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2008 deri më datë 31.12.2010, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar me shkresën nr. 285/13, datë 04.07.2011, marrja e 3 (tre) masave organizative dhe 1 (një) masë për zhdëmtimin e dëmit ekonomik të shkaktuar.

Nga verifikimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve rezulton se:

DARQT, i ka kthyer përgjigje KLSH, mbi zbatimimin e rekomandimeve të lëna, me shkresën nr. 666, datë 07.07.2011, brenda afatit ligjor (20 ditë).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

A. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 3 rekomandime. Nga të pranuarat, 2 rekomandime janë zbatuar plotësisht dhe 1 rekomandim rezulton i pazbatuar.

c. Për zhdëmtimin e dëmeve ekonomike të shkaktuara, është lënë 1 rekomandim, i cili është pranuar plotësisht. Rekomandimi i pranuar është zbatuar pjesërisht. Është kërkuar shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 292,506 lekë, ku rezulton e arkëtuar vlera 89,150 lekë.

Nuk është arkëtuar vlera 203,356 lekë, nga e cila vlera 176,275 lekë, ju përket punonjësve të Zyrës Arsimore Kamëz si dhe vlera 27,081 lekë, punonjësve që nuk janë më në marrëdhënie pune me DARQT.

Në mënyrë më të detajuar:

A. Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar 3 masa organizative, e përkatësisht:

1. Nisur nga fakti se, për tarifën e aplikuar në shumën 200 lekë për vërtetimet e dokumenteve për vulosjen e dëftesave shkollore, nuk u paraqit asnjë dokument që vërteton miratimin e kësaj tarife, rekomandojmë që, Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të marrë masat e duhura që aplikimi i tarifave të bëhet në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore” dhe udhëzimit të përbashkët nr. 33, datë 10.10.2006, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me Ministrinë e Financave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të arsimit”. (Menjëherë)

Përgjigja e subjektit

Në lidhje me detyrën për tarifën e aplikuar në shumën 200 lekë për vërtetimet e dokumenteve për vulosjen e dëftesave shkollore, DAR me shkresën 523 prot, datë 16.05.2011; nr. 688 prot, datë 18.07.2011; nr. 718 prot, datë 02.08.2011, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në të cilën ka kërkuar unifikimin e tarifave, për të cilat nuk ka marrë përgjigje zyrtare.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se DAR, Qarku Tiranë për periudhën 2011 e në vazhdim nuk e aplikon më tarifën me vlerë 200 lekë, për shërbimin e ciklinit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

dokumentave shkollorë të arsimit para universitar, pa marrë miratimin shkresor nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga ana e DARQT për këtë çështje në observacionet e dërguara me shkresën nr. 372 prot, datë 29.02.2018, “Dërgohen sqarimet për projektraportin e dërguar nga KLSH”, (prot në KLSH me nr 1307/4, datë 28.02.2018) ka bërë komente dhe shpjegime në lidhje me mosaplikimin e tarifave për siglim dokumentacioni, dhe konkretisht:

*“Në lidhje me aplikimin e tarifave për konfirmim të dokumentacionit, i tarifës 200 lekë ju sqarojmë se ky konstatim qëndron por Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë i është drejtuar disa herë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës por pa marrë përgjigje. Me shkresën nr.369 datë 28.2.2018 i jemi drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe jemi në pritje të një përgjigje nga ky institucion. Në shkresë thuhet :”Në raportin e KLSH është lënë rekomandim që në bashkëpunim me MASH të merren masat e duhura që aplikimi i tarifave të bëhet në bazë të VKM nr. 432, datë 28.06.2016 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore” dhe udhëzimit të përbashkët të MASH dhe MF me nr. 33, datë 10.10.2016 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave nga institucionet e sistemit të arsimit”, **ndërkohë që në këtë udhëzim nuk përcaktohet asnjë lloj tarife për kryerjen e këtij shërbimi.** Për sa më sipër kërkojmë të na bëhet me dije se cila do të jetë tarifa nga ana e institucionit për kryerjen e këtij shërbimi”.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se MASR duhet të përcaktojë tarifën përkatëse dhe të komunikojë institucioneve arsimore. Në këto kushte, ky koment i institucionit arsimor merret në konsideratë nga grupi i auditimit, por menjëherë duhet të ndërhyhet pranë MASR për qartësimin përfundimtar të këtij procesi..

2. Nisur nga fakti se, në disa raste për emërimet e punonjësve në funksione drejtuese, apo në pozicionin e mësues, nuk është aplikuar pagesë e njëjtë për të njëjtat kritere, por janë zbatuar dy mënyra pagese, rekomandojmë që, Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë, në të ardhmen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të zbatojë të njëjtën pagesë për punonjësit me të njëjta kritere. *(Vazhdimisht).*

Përgjigja e subjektit

Emërimet e punonjësve në funksione drejtuese, apo në pozicionin e mësues, për periudhën në vijim, janë aplikuar pagesa të njëjta për të njëjtat kritere, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Komenti

Për sa më sipër kjo masë konsiderohet e pranuar nga subjekti dhe **e realizuar.**

3. Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë, të marrë nga Filiali i Postës Shqiptare, Tiranë, listat e përfituesve të subvencionit të librit shkollor për vitet 2008-2009 dhe të arkivohen në institucion ndërsa, për periudhën në vazhdim të bëhet rakordimi çdo muaj me filialet e Postës Shqiptare, Tiranë, për subvencionet e paguar të librit shkollor, si dhe të mbahet aktrakordimi përfundimtar me listat bashkëngjitur dhe të firmosur nga të gjithë personat përfitues të subvencionit, në bazë të faturave të paraqitura të plotësuar saktë, pa gabime dhe me nënshkrimet përkatëse. *(Menjëherë dhe Vazhdimisht).*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Përgjigja e subjektit

Në lidhje me këtë detyrë, DAR i është drejtuar me shkresën nr. 536 prot, datë 20.05.2011 Filialit të Postës, Tiranë, ku i ka kërkuar të paraqesin në pranë DAR, Qarku Tiranë, listat e përfituesve të subvencionimit për librin shkollor 2008-2009 ndërsa për periudhën në vazhdim të bëhet rakordimi me filialet e Postës, Tiranë, për subvencionimin e paguar të librit shkollor, si dhe të mbahet aktrakordimi përfundimtar me listat bashkangjitur, të firmosura nga të gjithë personat përfitues të subvencionit.

Komenti

Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, janë paraqitur në DAR, Qarku Tiranë, listat e përfituesve të subvencionimit për librin shkollor 2008-2009, ndërsa për periudhën në vazhdim është bërë rakordimi me filialet e Postës, Tiranë, për subvencionimin e paguar të librit shkollor, si dhe është mbajtur aktrakordimi përfundimtar me listat bashkangjitur, të firmosura nga të gjithë personat përfitues të subvencionit. (akt rakordimi nr. 1076, datë 09.05.2012; nr. 1081, datë 09.06.2013; nr. 884, datë 06.05.2014; nr. 1781, datë 20.07.2015; nr. 746, datë 22.04.2016; nr. 1079/1, datë 24.04.2017)

Për sa më sipër kjo masë konsiderohet e pranuar nga subjekti dhe **e realizuar**.

B. Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është propozuar një masë për shpërblim dëmi, e konkretisht:

1. Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të kërkojë kthimin e pagesës të marrë padrejtësisht më tepër, për 16 punonjës, në shumën 292,506 lekë, sipas listës së përfituesve.

Përgjigja e subjektit

Mbështetur në urdhrin nr. 36, të Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë, kanë filluar ndalesat për 16 raste, për mësuesit që rezultojnë se kanë përfutur padrejtësisht vlerën **292,506 lekë**. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se është ndaluar vlera **89,150 lekë**.

Me shkresën 521 prot, datë 16.05.2011, DARQT i është drejtuar Zyrës Arsimore Kamëz në të cilën e informon se nga auditimi i ushtruar nga KLSH në DARQT, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.10.2008 deri më datë 31.12.2010, nga detyrat e lëna nga ky auditim rezulton se, duhet të bëhet ndalesa me vlerë **176,275 lekë**, nga paga për punonjësit e shënuar në tabelën e mësipërme. Vlera **27,081 lekë** i përket punonjësve të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune me DARQT.

Nga ana e DARQT për këtë çështje në observacionet e dërguara me shkresën nr. 372 prot, datë 29.02.2018, “Dërgohen sqarimet për projektraportin e dërguar nga KLSH”, (prot në KLSH me nr 1307/4, datë 28.02.2018) ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Nga Z Kamëz, i është kthyer përgjigje DARQT me shkresën nr 153, datë 22.02.2018, “Kthim përgjigje”, ku për detyrimet e lënë nga KLSH për arsimtarët, nga kjo ZA janë kryer ndalesa vetëm për 4 prej tyre, pasi sikundër shprehet znj.E.cekani, drejtore e ZA Kamëz në këtë shkresë, “emrat tjerë nuk kanë punuar pranë shkollave tona”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se kjo masë konsiderohet e pranuar nga subjekti dhe e realizuar pjesërisht.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

II. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të shtetit me ligjin organik të buxhetit, pagat dhe shpërblimet, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

a. Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit. Detajimi i planit fillestar dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore. Realizimi i shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Auditimi u krye për vitet 4- muhori i fundit i vitit 2015, viti 2016 dhe viti 2017 duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016 datë 02.06.2016,
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin Nr 110/2015
- Ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”,
- Ligji nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”
- VKM nr. 285, datë 01.04.2015 “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2016-2018”
- VKM nr. 696, datë 31.07.2015 “Për tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018”
- Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2014 “Për Përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2015-2017”
- Udhëzimi Standard i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 02.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”,
- Udhëzimi nr.23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”
- Udhëzimi nr.4, datë 29.02.2016“Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019”
- Udhëzimi nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar me udhëzimin nr. 3 datë 16.01.2015 Për disa shtesa dhe ndryshime
- Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”
- Ligji nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”

Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit të shtetit për 4-mujorin e vitit 2015, viti 2016 dhe 2017, në mbështetje të udhëzimeve të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit.

Drejtorja Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, është njësi vartëse e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë e cila ka për detyrë të menaxhojë veprimtarinë ekonomike-financiare të institucionit, të administrojë me efikasitet dhe efektivitet vlerat materiale dhe monetare të vëna në dispozicion bazuar në rregullat dhe standardet buxhetore, merr masa për programimin, sigurimin dhe realizimin e të ardhurave, organizon dhe realizon kontrole për respektimin e disiplinave financiare dhe buxhetore në drejtim të përdorimit të tyre. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme përgatit kërkesat buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, me qëllim që të sigurojë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në Programin e Qeverisë gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave të politikës së programit. Është e rëndësishme të kihet parasysh që përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm si dhe që buxheti vjetor do të jetë viti i parë i këtij programi. Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, bazuar në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime në ligji nr 9936, datë 26.06.2008”, Udhëzimit nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, i shfuqizuar me udhëzimin nr 23 datë 22.11.2016, udhëzimit nr.7, datë 28.02.2014 “Për Përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2015-2017”, - Udhëzimi nr.23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe Udhëzimi nr.4, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019”, për të përballuar nevojat e saj me fonde, ka hartuar projektbuxhetin për vitin 2015, 2016 dhe vitin 2017 dhe i është dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Drejtorja Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë me shkresën nr. 498 prot., datë 14.08.2014 ka dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, projektbuxhetin afatmesëm për vitin 2015-2017 sipas niveleve arsimore si dhe relacioneve përkatëse duke respektuar afatin për dorëzimin e Fazës së Dytë të projektbuxhetin jo me vonë se data 01 Shtator.

Me shkresën nr. 498 datë 14.08.2014 është dërguar faza e II e planifikimit për projektbuxhetin afatmesëm për periudhën 2015-2017 sipas niveleve arsimore drejtuar Ministrisë së Arsimit.

Me shkresën nr. 1857 datë 18.08.2015 është dërguar faza e II e planifikimit për projektbuxhetin për periudhën afatmesëm 2016-2018 sipas niveleve arsimore dhe me shkresën nr. 1462 datë 15.08.2016 drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për periudhën 2017-2019 është hartuar projektbuxheti i planifikuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë.

Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme që zbatojnë më shumë se një program buxhetor, drejtues programi konsiderohet menaxheri i nivelit më të lartë në varësi direkte nga nëpunësi autorizues. Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të programit janë përgjegjës dhe raportojnë, përpara nëpunësit autorizues, për hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Anëtarë të ekipit të menaxhimit të programit janë ekspertë të fushës së programit përkatës buxhetor/nëpunës autorizues të nivelit të dytë, përgjegjës për menaxhimin e nënprogrameve/grupeve të aktiviteteve/aktiviteteve që ata drejtojnë dhe japin llogari nga pikëpamja funksionale tek drejtuesi i programit. Anëtarët e ekipit të menaxhimit të programit janë përgjegjës për realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore, të cilat lidhen me programin e tyre, përfshirë këtu punën që kërkohet për të detajuar: i) Deklaratën e Politikës së Programit; ii) Produktet e programit; dhe iii) Aktivitetet e programit. Nga auditimi u konstatua se institucioni për periudhën objekt auditimi nuk ka ngritur dhe për pasojë as nuk ka miratuar asnjë ekip për menaxhimin e programit në kundërshtim piken 45 të udhëzimit nr. udhëzimin nr 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” i cili citon se “Drejtuesit e programeve ka përgjegjësi për propozimin e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit të tyre, për t’u miratuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Titullari si Kryetar i këtij grupi”

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 3 programe buxhetore të cilat janë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrimi”(01110), është një program i cili mbulon formulimin e politikave dhe strategjive të sektorit përfshin aparatin, në këtë program përfshihen pagat sigurimet shoqërore e shëndetësore, pagesat e energjisë, ujit telefoni si dhe shërbimet postare.

2. Programi “Arsimi Bazë (09120), në këtë program përfshihet arsimi bazë nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Në këtë program përfshihen pagat sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, furnizimet me shkumësa, regjistrat, dëftesa e amza, shpenzime gjyqësore sipas vendimeve të përcaktuara, si dhe dieta për shërbime kur mësuesit janë angazhuar nga MASRS, shërbime interneti si dhe shërbimet e transportit deri në vitin 31.12.2015 dhe nga data 01.09.2017 ka rivazhduar likuidimi nga DAR qarkut Tiranë për transportin e mësuesve dhe nxënësve pasi për periudhën 2016, likuidimi është bërë nga Bashkia e Tiranës

3. Programi “Arsimi Mesëm” (09230) ky program, përfshin arsimi e mesëm nga klasa 10 deri në klasën 12. Në këtë program përfshihet, paga sigurime shoqërore dhe shëndetësore, furnizimet me shkumësa, regjistra, dëftesa e amza, shërbime interneti, shpenzime gjyqësore si dhe transporti i mësuesve dhe nxënësve ne datën 31.12.2015 dhe duke rivazhduar më likuidimin nga DAR, qarku Tiranë ne datën 01.09.2017, pasi për vitin 2016 likuidimi është bërë nga bashkia e Tiranës me urdhër te Ministrisë se Arsimit dhe Sportit.

Planifikimi për vitin 2015.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “*fondin e pagave & “sigurimeve shoqërore” (600 & 601)*, llogaritja e tyre është bazuar në nivelin aktual të punonjësve për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, ku saktësisht janë mbështetur në nivelin aktual të pagave duke përfshirë të gjithë elementet e pagës dhe shtesat mbi pagën e punonjësve të përcaktuar në VKM nr.624, datë 24.07.2013 si dhe aktet e tjera nënligjore.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *Shpenzime të tjera korrente (602-606)* Parashikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime në nivel arsimor për çdo program, është rikonceptuar duke dhënë informacion mbi kategoritë kryesore të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes. Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, ka planifikuar në buxhetin e vitit 2015, kërkesat për shpenzimet për mallra dhe shërbime si:

- Shpenzime për transportin e nxënësve dhe mësuesve ne zbatim të VKM nr. 709, datë 05.10.2011 “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”i ndryshuar me vendimin nr. 682, datë 29.07.2015 i ndryshuar, e cila është hartuar në mbështetje të numrit të linjave, numrit të nxënësve dhe numrit të mësuesve që udhëtojnë në këto linja si dhe periudhat mësimore për të cilat nevojitet ky shërbim. Ky zë është parashikuar në vlerën 19,465,919 lekë
- Shpenzime për blerjet materialeve didaktike mësimore, dokumentacione shkollor dhe shkumës mësimor, ku buxheti është parashikuar sipas numrit të nxënësve për çdo shkollë dhe numrit të klasave/kabineteve/kompleteve sipas lëndëve për të cilat është hartuar kërkesa për mjete didaktike e diferencuar për arsimin bazë plus parashkollorin, për arsimin e mesëm të përgjithshëm si dhe atë profesional.
- Shpenzime për mallra të tjera dhe dokumentacion shkollor regjistra amza, dëftesa, fletë lavdërimi, gazeta zyrtare që përfshihen në këtë grup shpenzimesh.

Janë parashikuar shpenzime për subvencionet libri shkollor për çdo program sipas kriterëve të vendosura në vendimin nr.107, datë 10.02.2010.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Planifikimi për vitin 2016.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *“fondin e pagave & “sigurimeve shoqërore” (600 & 601)*, llogaritja e tyre është bazuar në nivelin aktual të punonjësve për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, ku saktësisht janë mbështetur në nivelin aktual të pagave duke përfshirë të gjithë elementet e pagës dhe shtesat mbi pagën e punonjësve të përcaktuar në VKM nr.624, datë 24.07.2013 si dhe aktet e tjera nënligjore. Ky zë është parashikuar në vlerën 1,230,808,000 lekë

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *Shpenzime të tjera korrente (602-606)* Parashikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime në nivel arsimore për çdo program, është rikonceptuar duke dhënë informacion mbi kategoritë kryesore të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes. Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, ka planifikuar në buxhetin e vitit 2016, kërkesat për shpenzimet për mallra dhe shërbime si:

- Shpenzime për transportin e nxënësve dhe mësuesve në zbatim të VKM nr.682 datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit” i ndryshuar, e cila është hartuar në mbështetje të numrit të linjave, numrit të nxënësve dhe numrit të mësuesve që udhëtojnë në këto linja si dhe periudhat mësimore për të cilat nevojitet ky shërbim. Ky zë është parashikuar në vlerën 20,439,214 mijë lekë
- Shpenzime për blerjet materialeve didaktike mësimore, dokumentacione shkollor dhe shkumës mësimor, ku buxheti është parashikuar sipas numrit të nxënësve për çdo shkollë dhe numrit të klasave/kabineteve/kompleteve sipas lëndëve për të cilat është hartuar kërkesa për mjete didaktike e diferencuar për arsimin bazë plus parashkollorin, për arsimin e mesëm të përgjithshëm si dhe atë profesional.
- Shpenzime për mallra të tjera dhe dokumentacion shkollor regjistra amza, dëftesa, fletë lavdërimi, gazeta zyrtare që përfshihen në këtë grup shpenzimesh.

Është parashikuar shpenzime për subvencionet e librit shkollor për çdo program sipas kriterëve të vendosura në vendimin nr.107, datë 10.02.2010 si dhe shpërblimet për dalje në pension.

Planifikimi për vitin 2017.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *“fondin e pagave & “sigurimeve shoqërore” (600 & 601)*, llogaritja e tyre është bazuar në nivelin aktual të punonjësve për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, ku saktësisht janë mbështetur në nivelin aktual të pagave duke përfshirë të gjithë elementet e pagës dhe shtesat mbi pagën e punonjësve të përcaktuar në VKM nr.624, datë 24.07.2013 si dhe aktet e tjera nënligjore.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *Shpenzime të tjera korrente (602-606)* Parashikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime në nivel arsimore për çdo program, është rikonceptuar duke dhënë informacion mbi kategoritë kryesore të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes. Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, ka planifikuar në buxhetin e vitit 2017, kërkesat për shpenzimet për mallra dhe shërbime si:

- Shpenzime për transportin e nxënësve dhe mësuesve në zbatim të VKM nr.682 datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit” i ndryshuar me VKM nr. 398 datë 03.05.2015 i ndryshuar me VKM nr.624 datë 01.11.2017 “Për disa ndryshime në vkm nr. 682 datë 29.07.2015.”, e cila është hartuar në mbështetje të numrit të linjave,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

numrit të nxënësve dhe numrit të mësuesve që udhëtojnë në këto linja si dhe periudhat mësimore për të cilat nevojitet ky shërbim. Ky zë është parashikuar në vlerën 13,323,672 lekë

- Shpenzime për blerjet materialeve didaktike mësimore, dokumentacione shkollor dhe shkumës mësimor, ku buxheti është parashikuar sipas numrit të nxënësve për çdo shkollë dhe numrit të klasave/kabineteve/kompleteve sipas lëndëve për të cilat është hartuar kërkesa për mjete didaktike e diferencuar për arsimin bazë plus parashkollorin, për arsimin e mesëm të përgjithshëm si dhe atë profesional.
- Shpenzime për mallra të tjera dhe dokumentacion shkollor regjistra amza, dëftesa, fletë lavdërimi, gazeta zyrtare që përfshihen në këtë grup shpenzimesh.

Janë parashikuar shpenzime për subvencionet e librit shkollor për çdo program sipas kriterëve të vendosura në vendimin nr.107, datë 10.02.2010.

-Nga auditim i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi u konstatua se, për shkak të mos krijimit dhe miratimit të ekipit të menaxhimit të programit nuk është hartuar deklarata e politikës së programit, produktet e programit si dhe aktivitetet e programit, gjithashtu çdo program nuk ka të përcaktuar produktet programeve buxhetore.

-Nga auditimi u konstatua se hartimi i PBA-ve për periudhën objekt auditimi ka mangësi në trajtimin e tyre, të tilla si përshkrimi i misionit të njësisë, përshkrimi i programeve dhe veprimtarive të njësisë, paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës së performancës, planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve dhe aktiviteteve si dhe treguesit faktik për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin në vazhdim si dhe për tri vitet e ardhshme buxhetore në kundërshtim me pikën 6 të udhëzimit nr 23. Datë 22.11.2016 i cili citon se “*kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme duhet të përmbajnë:*

- a) misionin e njësisë;*
- b) përshkrimin e programeve dhe veprimtarive të kësaj njësie;*
- c) paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës;*
- d) planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve dhe aktiviteteve.*
- e) treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tri vitet e ardhshme buxhetore;*
- f) projektin e planit të arkës vjetor dhe të ndarë në muaj, si pjesë e projektbuxhetit vjetor dhe përfshin:*
 - i. Planin e prokurimeve dhe angazhime të tjera të planifikuara;*
 - ii. Pagesat e parashikuara që rrjedhin nga angazhimet.”*

-Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, nga institucioni për periudhën objekt auditimi është dërguar vetëm faza e dytë e Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm, duke mos dorëzuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit fazën e I të planifikimit të buxhetit afatmesëm në kundërshtim me Kapitullin III të Udhëzimit të MF nr. 23 datë 22.11.2016 “*Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm*” i cili përshkruan Fazën e Pare të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm si dhe detajon afatet.

-Nga auditimi u konstatua se kërkesat buxhetore nuk i referohen standardeve të përcaktuara në Udhëzimin nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” i shfuqizuar me udhëzimin nr. 23 datë 22.11.2016 për hartimin e PBA 2016-2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

3/2. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit për periudhën objekt auditimi, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.

- Me shkresën e ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.9662/36, datë 12.01.2015 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2015” drejtuar DAR Qarkut Tiranë, është bërë **çelja e buxhetit**, në zbatim e në mbështetje të ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015” Udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, është dërguar detajimi i buxhetit të miratuar në grupin e shpenzimeve korrente për vitin 2015, për çdo njësi shpenzuese të MAS sipas klasifikimeve buxhetore. Vlera për DAR, qarku Tirane është 1,011,036,000 lekë

-Me shkresën e ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.111103/3, datë 21.01.2016 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2016” drejtuar DAR Qarkut Tiranë, është bërë **çelja e buxhetit dhe detajimi i tij**, në zbatim e në mbështetje të ligjit nr. 147/2015, “Për Buxhetin e vitit 2016” si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 15.01.2016 “Për Zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, në vlerën 1,107,484,616 lekë e ndarë në programe dhe llogari ekonomike.

-Me shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.460, datë 20.01.2017 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2017”, është bërë **çelja e buxhetit dhe detajimi i tij**, në zbatim e në mbështetje të ligjit nr. 130 datë 15.12.2016, “Për Buxhetin e vitit 2017” si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në vlerën 1,057,703,237 lekë e ndarë në programe dhe llogari ekonomike.

3/3. Zbatimi i buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Realizimi i treguesve të buxhetit, analizimi dhe krahasimi me vitet e kaluara.

-Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë , ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas tre programeve të miratuara, si më poshtë:

1. Planifikim menaxhim administrim

2. Arsimi Bazë

3. Arsimi i Mesëm

Realizimi i shpenzimeve sipas programeve buxhetore rezulton si më poshtë:
lekë

Emërtimi	2015		2016		2017	
	Plan.	Realizim	Plan.	Realizim	Plan.	Realizim
Planifikim Menaxhim Administrim	22,804,000	16,979,540	19,928,000	18,165,000	19,525,000	15,651,097
Arsimi Bazë	1,319,803,000	999,803,280	1,300,267,000	856,629,013	926,684,000	886,953,351
Arsimi Mesëm	226,848,000	211,549,816	302,840,000	219,092,902	262,200,000	228,552,503
Totali	1,569,091,000	1,228,332,636	1,623,035,000	1,096,887,068	1,224,409,000	1,131,156,951

Nga auditimi rezulton se buxheti i vitit 2015, nga 1,569,091,000 lekë lekë që ishte planifikuar është realizuar për 1,228,332,636 lekë, ose në masën 78.3%, me një mosrealizim prej 340,758,364 lekë, ku me nivel të ulët realizimi janë programet “Planifikim, menaxhim, administrim” në masën 74,5 % dhe diferencën prej 5,824,460 lekë si dhe “Arsimi Bazë” në masën 76 % në, në diferencën prej 319,999,720 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Buxheti i vitit 2016, nga 1,623,035,000 lekë që ishte planifikuar është realizuar për 1,096,887,068 lekë, ose në masën 67,6%, me një mosrealizim prej 526,147,932 lekë, ku me nivel të ulët realizimi janë programet “Arsimi bazë” në masën 66 % dhe diferencën prej 443,637,987 lekë si dhe “Arsimi Mesëm” në masën 72,3 % dhe me një diferencën prej 83,747,098 lekë.


Buxheti i vitit 2017, nga 1,224,409,000 lekë të cilat janë planifikuar është realizuar në vlerën 1,131,156,951 lekë, ose në masën 90 %, me një mosrealizim prej 113,252,049 lekë, ku nivel të ulët realizimi janë programet “Planifikim, menaxhim, administrim” në masën 80 % dhe diferencën prej 3,873,903 lekë si dhe “Arsimi i Mesëm” në masën 87 % në, në diferencën prej 33,647,497 lekë.

Referuar shpenzimeve, Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë për vitin 2016 ka bërë një parashikim në planifikimin e Buxhetit afatmesëm për vitin 2016-2018, në vlerën 1,623,008,000 lekë. Sipas ligjit nr.147/2015 “Për buxheti e vitit 2016” është miratuar në vlerën 1,107,484,617 lekë. Referuar aktit normativ, shpenzimet kanë patur një rënie të ndjeshme në vlerën 1,105,353,254 lekë. Fakti i realizimit të shpenzimeve në fund të vitit ushtrimor rezultoi 1,096,887,068 lekë.

Më pas, gjatë vitit janë bërë ndryshime si më poshtë:

Në grafikun më poshtë, po paraqesim trendin e shpenzimeve korrente për vitin 2016, nga momenti i planifikimit buxhetor afatmesëm, e deri në realizimin faktik:

Titulli: trendi i shpenzimeve korrente për vitin 2016



Burimi: DARQT

Për vitin 2017

Referuar shpenzimeve, Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë për vitin 2017 ka bërë një parashikim në planifikimin e Buxhetit afatmesëm për vitin 2016-2018, në vlerën 1,224,409,000 lekë. Sipas ligjit nr.130/2016 “Për buxheti e vitit 2017” është miratuar në vlerën 1,057,702,717 lekë. Referuar aktit normativ, shpenzimet kanë patur një rënie të ndjeshme në vlerën 1,146,186,474 lekë. Fakti i realizimit të shpenzimeve në fund të vitit ushtrimor rezultoi 1,131,156,951 lekë.


Në grafikun më poshtë, paraqesim trendin e shpenzimeve korrente për vitin 2017, nga momenti i planifikimit buxhetor afatmesëm, e deri në realizimin faktik:

Titulli?



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”



Burimi?

Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit konstatohet se programimi është prekur nga Aktet Normative duke çuar në një rënie të ndjeshme krahasuar me PBA si dhe Buxhetin e miratuar me ligj. Gjithashtu shikojme se Planifikimi i Buxhetit Afatmesëm nuk i referohet vitit parardhës për të minimizuar ndryshimet e ndjeshme të cilat ndodhin kur perballemi me faktin në fund të vitit duke krijuar kështu mosrealizim të shpenzimeve korrente dhe kapitale. Strukturat drejtuese të DAR- Qarku Tiranë, dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos, me qëllim arrijten e objektivave dhe minimizimin e shmangieve të larta mes nivelit të programuar dhe atij të realizuar.

3/4/a. Mbi monitorimin e menaxhimit të shpenzimeve publike, reflektimi në raportet e monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit kundrejt kuotave të planifikuara në nivel programi. Auditim mbi saktësinë e hartimit dhe përgatitjes së raporteve të monitorimit, mbi saktësisë e realizimit të produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiorë dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Për 4-mujorin e vitit 2015 ky institucion me shkresën nr.360 date 22.02.2016 ka dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raportin e monitorimit vetëm për tre mujorin e katërt të vitin 2015. Nga auditimi u konstatua se mungojnë raportet e monitorimit për 3-mujorin e parë, të dytë dhe të tretë për vitin 2015. Raporti vjetor i dorëzuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit përmban vetëm formatet standardë të monitorimit të buxhetit duke mos paraqitur asnjë relacion mbi ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar në nivel programi apo artikulli në kundërshtim me pikën IV Monitorimi të Udhëzimit e MF nr.2 Drtë 09.01.2015 “Udhëzim plotësues mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2015” i cili citon se raportet periodike gjatë vitit 2015 duhet të plotësohen me informacionin si, “Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara”.

Për vitin 2016

Me shkresën nr. 1306 datë 07.07.2016 DAR- Qarku Tiranë ka dorëzuar realizimin e shpenzimeve operative për periudhën janar-qershor 2016 dhe me shkresën nr.65 datë 18.01.2017 drejtuar Degës së Thesarit, DAR Qarku Tiranë ka dërguar realizimin e buxhetit për vitin 2016. Nga auditimi u konstatua se për vitin 2016 mungon raporti i monitorimit për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

periudhën tre mujore janar-mars i realizimit të buxhetit për DAR/Qarkun Tiranë. Për te dy kanë mangësi në trajtimet e tyre, duke mos ju përmbajtur udhëzimit të MF nr. 22 datë 17.11.2017 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit Për Njësitë e Qeverisjes Qendrore”

Për vitin 2017

Me shkresën nr. 1470/1 datë 30.05.2017 drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, DAR-qarku Tirane ka dërguar raportin e monitorimit mbi zbatimin e buxhetit për periudhën Janar-Prill 2017 dhe me shkresën nr.2014 datë 14.09.2017 institucioni ka dërguar raportin e monitorimit për periudhën Janar-Gusht 2017. Raporti vjetor i monitorimit është në proces pune, pasi afati i fundit për ta dërguar është më 30 Shkurt 2018. Dy raportet 4-mujore të monitorimit të dorëzuara në MAS. Duke ju referuar 3 raporteve 4-mujore të dorëzuara në MAS, nga auditimi u konstatua se ky raport përmban vetëm anekset të firmosura nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues por në asnjë prej dy raporteve nuk është shoqëruar me relacionet shpjeguese për çdo program si dhe relacioni përmbledhës për MAS mbi evidentimin për çdo program të realizimit të qëllimeve, objektivave dhe të treguesve të performances, të evidentohen problematikat dhe mangësitë e vërejtura për çdo program, realizimin e produkteve në krahasim me planin i në terma sasiorë ashtu edhe në vlerë duke evidentuar koston për njësi, në kundërshtim me kreun IV të Udhëzimit të Ministrisë së Financës nr. 22 datë 17.11.2016 etj.

Të përmbledhura në zërat kryesorë të shpenzimeve, plani fillestar si dhe realizimit të tyre për periudhën objekt auditimi, paraqiten si më poshtë:

Viti 2015

Emetimi		600	601	602	606
		Paga	sig.shoq	Mallra dhe Shërb	Transferta Buxhetore
Planifikim Menaxhim Administrim	Plan	17,643,000	2,815,000	2,146,000	200,000
	Fakt	13,279,961	2,135,528	1,564,051	0
	%	75.3	75.8	72.8	0
Arsimi Bazë	Plan	1,105,403,000	175,812,000	28,492,000	10,096,000
	Fakt	821,473,675	137,775,249	28,935,548	11,618,808
	%	74.3	78.3	100	115.1
Arsimi Mesëm	Plan	186,071,000	29,594,000	5,139,000	5,680,000
	Fakt	179,057,000	29,006,925	443,480	3,042,411
	%	96.2	98	8.60%	53.6
TOTALI	Plan	1,309,117,000	208,221,000	35,777,000	15,976,000
	Fakt	1,013,810,636	168,917,702	30,943,079	14,661,219
	%	77.4	81	86.4	91.7

Burimi: DARQT

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se:

Për Programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” Shpenzimet për pagat (600) janë realizuar në vlerën 13,279,961 lekë ose në masën 75.3% kundrejt planit fillestar dhe në një difference prej 3,363,039 lekë, sigurimet shoqërore (601), janë realizuar në masën 75.8%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 679,472 lekë. Për programin “Arsimi Bazë” *Shpenzimet për pagat (600)* janë realizuar në vlerën 821,473,675 lekë ose në masën 74.3% kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 283,929,325 lekë, *sigurimet shoqërore (601)*, janë realizuar në vlerën 137,775,249 në masën 78.3 % kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 38,036,751 lekë.

Shpenzimet operative (602), janë realizuan, në vlerë 28,935,548 lekë, ose në masën 100% kundrejt planit fillestar.

Shpenzime për (606) “*Transferta buxhetore*” janë realizuar në vlerën 11,618,808 mijë lekë, ose në masën 115 % kundrejt panit fillestar duke pasur një tejkalim në vlerën 10,092,208.

Arsimi i Mesëm” *Shpenzimet për pagat (600)* janë realizuar në vlerën 179,057,000lekë ose në masën 96.2% kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 7,010,000 lekë, *sigurimet shoqërore (601)*, janë realizuar në vlerën 29,006,925 në masën 98 % kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 587,075 lekë.

Shpenzimet operative (602), janë realizuan, në vlerë 443,480 lekë, ose në masën 8.6% kundrejt planit fillestar, kjo për shkak të vonesave të dhënies së vendimeve gjyqësore nga ana e gjykatës, e si rezultat mospagimi i tyre.

Shpenzime për (606) “*Transferta buxhetore*” janë realizuar në vlerën 3,042,411 lekë, ose në masën 53 % kundrejt panit fillestar duke pasur mosrealizim në vlerën 1,314,781 lekë.

Titulli: Analiza e shpenzimeve 2016

Viti 2016

Emetimi		600	601	602	606
		Paga	sig.shoq	Mallra dhe Shërbime	Transferta Buxhetore
Planifikim Menaxhim Administrim	Plan	15,148,000	2,409,000	2,371,000	
	Fakt	14,280,000	2,156,030	1,729,123	0
	%	94.2	89.4	72.9	
Arsimi Bazë	Plan	1,088,873,000	173,183,000	28,215,000	9,996,000
	Fakt	719,027,626	119,276,530	9,107,156	12,217,701
	%	66	68.8	32.3	122.2
Arsimi Mesëm	Plan	253,296,000	40,233,000	4,555,000	4,756,000
	Fakt	184,805,616	29,938,510	120,000	4,228,776
	%	72.9	74.4	2.63	88.9
TOTALI	Plan	1,357,317,000	215,825,000	35,141,000	14,752,000
	Fakt	918,113,242	151,371,070	10,956,279	16,446,477
	%	67.6	70	31	111.5

Burimi: DAQRT

Për Programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” *Shpenzimet për pagat (600)* janë realizuar në vlerën 14,280,000 lekë ose në masën 94.2% kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 868,000 lekë, *sigurimet shoqërore (601)*, janë realizuar në masën 89.4% kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 252,970 lekë. Për programin “Arsimi Bazë” *Shpenzimet për pagat (600)* janë realizuar në vlerën 719,027,626 lekë ose në masën 66% kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 368,845,372 lekë, ky mosrealizim ka ardhur si pasojë e ndryshimit të VKM mbi pagesat e mësuesve, *sigurimet shoqërore (601)*, janë realizuar në vlerën 119,173,183 lekë ose në masën 68.8 % kundrejt



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

planit fillestar dhe në një diferencë prej 53,906,470 lekë, mosrealizim ky sipas arsyes së sipërpërmendur.

Shpenzimet operative (602), janë realizuar, në vlerë 9,107,156 lekë, ose në masën 32% kundrejt planit fillestar, ku ky mosrealizim ka ardhur si pasojë e kalimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të shërbimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit të cilët udhëtojnë larg qendrës së banimit Bashkisë së Tiranës.

Shpenzime për (606) “*Transferta buxhetore*” janë realizuar në vlerën 4,228,776 lekë, ose në masën 122.2 % kundrejt panit fillestar duke pasur një tejkalim në vlerën 2,221,701 lekë.

Programi Arsimit Mesëm Shpenzimet për pagat (600) janë realizuar në vlerën 184,805,616 lekë ose në masën 72.9% kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 68,490,384 lekë, sigurimet shoqërore (601), janë realizuar në vlerën 29,938,510 lekë, në masën 74.4 % kundrejt planit fillestar dhe në një diferencë prej 10,294,490 lekë.

Shpenzimet operative (602), janë realizuar, në vlerë 120,000 lekë, ose në masën 2.63% kundrejt planit fillestar, ku ky mosrealizim ka ardhur si pasojë e vonësve të dhënies së vendimeve gjyqësore nga ana e gjykatës dhe si rezultat nuk është bërë pagesa për shkak të mos daljes së vendimit nga gjykata. Shpenzime për (606) “*Transferta buxhetore*” janë realizuar në vlerën 4,228,776 lekë, ose në masën 89 % kundrejt panit fillestar duke pasur mosrealizim në vlerën 527,224 lekë.

Viti 2017

Emetimi		600	601	602	606
		Paga	sig.shoq	Mallra dhe Shërb	Transferta Buxhetore
Planifikim Menaxhim Administrim	Plan	15,285,000	2,308,000	1,932,000	
	Fakt	12,424,243	2,075,255	1,151,599	0
	%	81.28389271	89.9157279	59.6065735	
Arsimi Bazë	Plan	808,303,000	130,368,000	8,069,000	15,944,000
	Fakt	736,274,542	123,507,580	14,442,358	12,728,871
	%	91.08892853	94.73765034	178.9857231	
Arsimi Mesëm	Plan	226,347,000	33,181,000	2,672,000	0
	Fakt	189,223,663	31,675,977	3,874,411	3,778,452
	%	83.59892687	95.4642024	145.0004117	
TOTALI	Plan	1,049,935,000	165,857,000	12,673,000	15,944,000
	Fakt	937,922,448	157,258,812	19,468,368	16,507,323
	%	89.33147747	94.81590286	153.6208317	103.5331347

Për Programin “*Planifikim, Menaxhim, Administrim*” Shpenzimet për pagat (600) janë realizuar në vlerën 12,424,243 lekë ose në masën 81% kundrejt planit fillestar sigurimet shoqërore (601), janë realizuar në masën 89.9 % kundrejt planit fillestar. Realizimi në këtë masë i pagave dhe sigurimeve vjen si rezultat i numrit të punonjësve me pak se organika e miratuar. Shpenzimet operative (602) janë realizuar në vlerën 1,151,599 lekë ose në masën 60 % kundrejt planifikimit fillestar, ku ky mosrealizim ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të shumës së planifikuar prej 502.000 lekë zëri energji elektrike, për arsye të një defekti në rrjet por është realizuar në vlerën 200.000 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Për programin “Arsimi Bazë” Shpenzimet për pagat (600) janë realizuar në vlerën 736,274,542 lekë ose në masën 91% kundrejt planit fillestar, sigurimet shoqërore (601), janë realizuar në masën 94 % kundrejt planit fillestar dhe në vlerë prej 123,507,580 lekë.

Shpenzimet operative (602), janë realizuar, në vlerë 14,442,358 lekë, ose në masën 145% kundrejt planit fillestar duke pasur një tejkalim në vlerën 1,202,411 lekë kjo për shkak të kalimit të shërbimit të transportit serish DAR-Qarkut Tiranë.

Shpenzime për (606) “Transferta buxhetore” janë realizuar në vlerën 3,778,452 mijë lekë, edhe pse nuk ka pasur asnjë parashikim për këtë zë në planifikimin buxhetor afatmesëm.

Arsimi i Mesëm” Shpenzimet për pagat (600) janë realizuar në vlerën 189,223,663 lekë ose në masën 83 % kundrejt planit fillestar, sigurimet shoqërore (601), janë realizuar në vlerën 31,675,977 lekë ose në masën 95 % kundrejt planit fillestar.

Shpenzimet operative (602), janë realizuan, në vlerë 3,874,411 lekë, ose në masën 145% kundrejt planit fillestar, ose me një tejkalim prej 1,202,411 lekë për shkak të kalimit të shërbimit të transportit serish, DAR Qarkut Tiranë.

Shpenzime për (606) “Transferta buxhetore” janë realizuar në vlerën 3,778,452 lekë, por nuk ka asnjë planifikim për këtë zë në PBA e hartuara nga institucioni.

Nga raporteve të monitorimit rezultoi:

Nga auditimi u konstatua se raporti i monitorimit për periudhën objekt auditimi si dhe raportet periodike që DAR- Qarku Tiranë i ka paraqitur në Ministrinë së Arsimit dhe Sportit, nuk janë të plotësuar me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në kundërshtim me kreun IV “Monitorimi”, të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, dt. 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016” si dhe udhëzimit nr 22 datë 17.11.2016 të Ministrisë së Financës i cili citon se “Raporti i monitorimit i përgatitur nga institucionet duhet të përmbajë:

- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli;

- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë;

- Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara;

Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre.

Mungon publikimi i raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të Drejtorisë Rajonale Arsimore- Qarku Tiranë.

b. Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave (plan, fakt dhe në %) dhe krahasimi me vitet e kaluara; kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Përputhshmëria ligjore e krijimit dhe përdorimit të fondit të veçantë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

- ***Organizimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësia e Administratës së Drejtorisë Rajonale Arsimore të Qarkut Tiranë.***



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Mbështetur në ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar si dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” është nxjerrë urdhri nr. 199, datë 01.12.2010 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”, i Kryeministrit, mbi bazën e të cilit është bërë struktura, organika, organizimi dhe i brendshëm i Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, të pasqyruar në Rregulloren e Brendshme me nr. 233 prot., datë 31.01.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë”, rregullore me të cilën institucioni ka funksionuar në vijimësi. Nga përmbajtja e rregullores së Brendshme, rezulton se janë evidentuar qëllimi, misioni dhe veprimtaria si dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë institucioni, si pjesë e administratës shtetërore, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Gjithashtu në këtë rregullore janë evidentuar detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, si detyrat dhe përgjegjësitë e titullarit, përgjegjësit të sektorit por nuk janë specifikuar të ndara detyrat e specialistit për sektorët e veçantë. Konstatohet se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar me ndryshimet që ka pësuar kuadri ligjor mbi arsimin parauniversitar si dhe ligji për statusin e nëpunësit civil.

- Respektimi i strukturës organike të miratuar.

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se për tre mujin e vitit 2015, vitin 2016, dhe vitin 2017, DARQT është organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 199, datë 01.12.2010, të Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”, si dhe shkresave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 9663/1 prot., datë 07.01.2015 “Dërgohet numri i miratuar i punonjësve për vitin 2015”, shkresës nr. 36/5 prot., datë 28.01.2016 “Dërgohet numri i miratuar i punonjësve për vitin 2016”, shkresës nr. 36/6 prot., datë 04.02.2017 “Dërgohet pakësimi dhe shtesa e numrit të punonjësve për vitin 2016”, shkresën nr. 450/23 prot., datë 19.01.2017 “Dërgohet detajimi i numrit të punonjësve për vitin 2017”.

Numri i punonjësve sipas niveleve arsimore respektivisht është të paraqitura në tabelën nr. 1

Tabela nr.1

Nr	Emërtimi	Punonjës 3/mujori, viti 2015	Punonjës viti 2016	Punonjës viti 2017
1	Arsimi 9	1302	1093	1093
2	Arsimi i mesëm	261	257	255
3	Arsimi profesional	0	0	0
4	Administrata e DARQT	20	20	20
5	Gjithsej	1583	1370	1368
6	Administrata me kontratë	1	1	1
7	Praktikantë (praktika profesionale)	61	61	67

Mbështetur në Urdhrin e Kryeministrit nr. 199, datë 01.12.2010, struktura organizative DARQT ka **20** vende pune të miratuara të paraqitura, në tabelën nr. 2,

Tabela nr.2

Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Tiranë (1)
I- Sekretar (1)
II- Sektori i kualifikimit dhe Cilësisë (4)
- Përgjegjës sektori, mësues (1)
- Specialist i shkencave shoqërore, mësues (1)
- Specialist i shkencave natyrore, mësues (2)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

III- Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (4)

-Përgjegjës Sektori, ekonomist (1)

- Specialist, Jurist (1)

- Specialist finance, ekonomist (2)

IV- Sektori i IT (4)

- Përgjegjës Sektori informaticien (1)

- Specialist, matematicien (2)

- Specialist ekonomist Statisticien/ Matematikë Informatike (1)

V- Sektori i Programim Zhvillimit (6)

- Përgjegjës sektori, mësues (1)

- Specialist Burimeve Njerëzore, Mësues (2)

- Specialist Buxheti , ekonomist (2)

- Specialist i Investimeve, inxhinier/ekonomist (1)

Struktura ofron vija të qarta të përgjegjësiave dhe të kalimit të informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga menaxherët e lartë deri tek specialistët.

- Mbi realizimin e fondit të pagave dhe krahasimi me vitet e kaluara.

Nga auditimi rezultoi se, në DARQT për vitin 2015 fondi i pagave është realizuar në masën 100%, për vitin 2016 në masën 99.10% dhe për vitin 2017 në masën 98.602%.

Institucioni për periudhën objekt auditimi nuk ka tejkaluar numrin e punonjësve të planifikuar për çdo vit kalendarik. Realizimi i fondit të pagave në vlerat e mësipërme për vitin 2016 dhe 2017 ka ardhur si rezultat i mosplotësisë së numrit të punonjësve, të cilët për arsye shëndetësore dhe janë paguar nga sigurimet shëndetësore në periudha të veçanta të vitit.

Mbi realizimin e numrit të punonjësve dhe fondin e pagave mijë/lekë

Tabela nr.3

Nr	VITI	Nr. Punonjsve		Fondi i pagave		% realizimit
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	
1	2015	1583	1583	253,452	253,452	100
2	2016	1370	1370	926,360	918,113	99.1
3	2017	1368	1368	951,179	937,922	98.6

Burimi: Të dhënat e tabelës janë marrë nga specialisti i financës dhe përpunuar nga audituesi.

Mbi realizimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi.

Tabela nr.4

Nr.	EMERTIMI	3/mujori Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	Pagat (600)	253,452	253,452	100	926,360	918,113	99.1	951,179	937,922	98.6
2	Sig. Shoqërore (601)	169,001	168,918	100	151,371	151,371	100	157,634	157,259	100
3	Fondi i veçantë	1,807	2,647	100	3,614	3,614	100	2,500	2,500	100
3/a	Bonus karburanti	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3/b	Shpërblim për punë të mirë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3/c	Shpërblim në fund të vitit	-	840	-	-	-	-	-	-	-
3/d	Për sëmundje	-	-	-	-	-	-	50	50	
3/e	Për fatkeqësi	180	180		280	280		140	140	
3/f	Për pension	1,627	1,627		3,334	3,334		2,310	2,310	
3/g	Për aktivitete	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: Të dhënat e tabelës janë marrë nga sepecialisti i financës dhe përpunuar nga audituesi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Nga auditimi i dokumenteve për pagat e punonjësve të DAR Qarku Tiranë, rezulton se llogaritjet janë bërë në përputhje me bazën ligjore VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil/ nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Lartë, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit” të ndryshuar.

Ndërsa, për llogaritjen e pagave të drejtuesve të shkollave dhe mësuesve të sistemit parauniversitar, është përdorur baza ligjore VKM Nr. 194, datë 22.04.1999 “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” ndryshuar me VKM nr. 351, datë 19.04.2017. Paga e personelit drejtues shkolle e mësues, në arsimin fillor e të mesëm, përbëhet nga paga e pozicionit, paga e grupit, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa për kualifikim, mbështetur në lidhjen nr. 1, bashkëngjitur VKM nr. 624, datë 24.7.2013 “Për një ndryshim në vendimin nr. 194, datë 22.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, si dhe lidhjes nr.1 bashkëlidhur VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”

Shtesa për kualifikim jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit, në përqindje, si vijon:

- Në masën 5 %, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së tretë;
- Në masën 10 %, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së dytë;
- Në masën 20 %, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së parë.

Lidhur me zbatimin e bazës ligjore të pagave, u audituan borderotë e muajve tetor 2015, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2016, shkurt, mars, prill, maj 2017 për administratën e DAR-it Qarku Tiranë dhe për shkollat e mesme të përgjithshme në varësi të saj. Përgatitja e borderove është mbështetur në listë prezencat mujore, të plotësuara nga drejtoritë e shkollave. Nga auditimi i këtyre dokumenteve rezultoi se pagesa është kryer edhe në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.44, datë 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimorë- edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.

-Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e DAR Qarku Tiranë, dhe personelin e shkollave të arsimit parauniversitar në varësi, janë bërë në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës në muaj dhe jo mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë, duke mos pasqyruar prezencën e mësuesve dhe punonjësve të shkollave çdo ditë gjatë muajit, për ditët që kanë punuar. Listë pagesat dhe përmbledhëset e pagave janë nënshkruar nga specialistët që llogarisin pagat, nga Përgjegjësi i Sektorit Mbështetës dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Qarkut Tiranë. Bashkëlidhur janë listë prezencat dhe urdhrat e brendshëm të drejtuesit të institucionit. Listë pagesat e punonjësve dhe ndarja e pagesave është bërë sipas bankave të nivelit të dytë. Çdo veprim u gjet i finalizuar me një pasqyrë përmbledhëse të pagave si dhe me numrin e punonjësve faktik mujor.

Libri i pagave, për periudhën objekt auditimi, nuk është plotësuar për punonjësit që janë në marrëdhënie pune, në të cilin duhet të shënohen për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave duke filluar nga paga bruto, shtesa e ndalesa deri në pagën neto.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Nga auditimi në lidhje me zbatimin e normave të punës mësimore edukative dhe numrit të nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, **rezultojnë gjithsej 111 mësues (nga 4261 mësues), që nuk kanë patur ngarkesë të plotë mësimore**, në përputhje me Udhëzimin nr. 21, datë 23.07.2010 si dhe Udhëzimin nr. 44, datë 16.10.2014, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

-Në vitin shkollor **2015-2016**, nga **1563 mësues gjithsej, rezultojnë 34 mësues me ngarkesë jo të plotë mësimore**, nga të cilët me -1orë/mësimore më pak se ngarkesa 24 mësues dhe -2 orë/mësimore më pak 10 mësues, gjithsej -44 orë/mësimore.

-Në vitin shkollor **2016-2017**, nga **1350 mësues gjithsej, rezultojnë 58 mësues me ngarkesë jo të plotë mësimore**, nga të cilët 40 mësues me -1orë/mësimore më pak dhe 18 mësues -2 orë/mësimore më pak se ngarkesa, gjithsej - 76 orë/mësimore.

-Për vitin shkollor **2017-2018**, nga **1348 mësues gjithsej, rezultojnë 19 mësues me ngarkesë jo të plotë mësimore** nga të cilët 12 mësues me -1 orë/mësimore më pak dhe 7 mësues me -2 orë mësimore, gjithsej -26 orë mësimore. (lista bashkëngjitur materialit)

- Rregullshmëria e kryerjes së pagesave për nxënësit që kryejnë praktikat profesionale.

Në zbatim të VKM nr. 197, datë 04.03.2015 “Për miratimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikave profesionale për vitin 2015”, VKM nr. 119, datë 17.02.2016 si dhe VKM nr.165, datë 01.03.2017. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, praktikantët kanë përfituar nga punëdhënësi pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të përlogaritur mbi pagën minimale 22,000 lekë për vitin 2015 dhe vitin 2016 si dhe 24,000 lekë për vitin 2017. Kjo pagesë është kryer në bazë të listë pjesëmarrjes në institucionin arsimor përkatës. Për vitin 2015, 2016, 2017 janë miratuar nga MAS për kryerjen e praktikës mësimore 67 praktikantë dhe kanë përfituar 67 praktikantë.

- Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.

Nga auditimi i kryer me zgjedhje, për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë zbatuar dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë, ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligji nr. 8770, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga auditimi u konstatua përputhshmëri midis vlerës në total të pagës bruto, kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare Sigurimet shoqërore për tremujorin e katërt të vitit 2015, për vitit 2016 dhe 2017 janë realizuar në masën 100%, të dhënat paraqiten në tabelën nr. 4.

- Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi etj.

Fondi i veçantë, për periudhën objekt auditimi me vlerë në total **7,921 lekë**, është përdorur në zbatim të VKM nr. 369, datë 13.06.2007 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 dhe VKM nr. 826, datë 05.12.2011, duke u përdorur pjesërisht kryesisht për rastet e veçanta si, për dalje në pension, nga ku rezulton se janë kryer pagesa në vlerën 7,271 mijë lekë, për sëmundje vlera 50 mijë lekë, për fatkeqësi në familje vlera 600 mijë lekë. Fondi i veçantë, është përdorur për shpërblimin e punonjësve në fund të viti ushtrimor 2015, për 21 mësues me vlerë 84,000 lekë, sipas urdhrit nr. 397, datë 31.12.2015 protokolluar me nr. 3502, të dhënat paraqiten në tabelën nr.4. Konstatohet se



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

tatimet mbi të ardhurat nga shpërblimi janë mbajtur në listë pagesën e muajit dhjetor 2015 dhe pagesa faktike për shpërblimin e mësuesve është kryer në listë pagesën e muajit shkurt 2016, si pasojë e bllokimit të fondit nga dega e thesarit. Urdhëri i shpenzimit për shpërblimin e fundvitit me nr. 329, datë 31.12.2015 vlera 840,000 lekë.

- Mbi rregullshmërinë në plotësimin e dosjeve të personelit.

Në lidhje me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuar me dokumentacionin e duhur konform legjislacionit në fuqi si CV, diplomë, listë notash, certifikatë personale, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, certifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi etj. Në DARQT, për periudhën objekt auditimi, janë depozituar vlerësimet e arritjeve vjetore individuale të punonjësve në zbatim të 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe VKM nr.116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”.

Dosjet personale të nëpunësve janë administruar duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumenteve. Dosjet nuk janë inventarizuar, administruar me indeks të veçantë, sipas kërkesave të Kapitullit V, Formatit Standard nr. 17, ku evidentohen shkresat e fashikujt në veçanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje.

Regjistri i personelit nuk është plotësuar sipas rubrikave të tij për të gjithë punonjësit ku të jenë pasqyruar regjistrimet për të gjitha emërimet, lëvizjet, largimet si për punonjësit në organikë edhe për arsimtarët.

- Proceset Gjyqësore.

Për periudhën objekt auditimi DARQT ka ekzekutuar 7 vendime gjyqësore **me vlerë 5,882,736 lekë** për ish punonjësit, që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna, Nga vendimet e ekzekutuara 2 i përkasin vitit 2016, 5 vendime i përkasin vitit 2017 ndërsa për tremujorin e katërt të vitit 2015 nuk ka vendime gjyqësore të ekzekutuara.

- ✓ **Për vitin 2016 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore 1,747,075 lekë, vlerë e cila është paguar nga fondi i akorduar nga MASR.**
- ✓ **Për vitin 2017 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore është 4,135,661 lekë, vlerë e cila është paguar nga fondi i akorduar nga MASR.**

Likuidimi i ish punonjësve që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna për vitin 2016 dhe 2017 është bërë në katër raste nëpërmjet zyrës përmbarimore dhe në tre raste vullnetarisht nga institucioni. Vlera e likuiduar për zyrën përmbarimore, bazuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë nr. 385/7, datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat” është në total 309,576 lekë.

Aktualisht DARQT, ka gjithsej një proces gjyqësor për largim nga puna i cili aktualisht është i ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Të gjitha proceset gjyqësore ndaj ish punonjësve për largim nga puna, institucioni i ka ezauruar të gjitha shkallët e gjyqimit.

III. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.

Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë e shërbime nga subjekti i audituar. Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike. Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra, punë e shërbime. Vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

i. Hartimi i regjistrave të prokurimit publik në DARQT

Regjistrat e parashikimeve për procedurat e prokurimeve publike për vitin 2015, 2016, 2017 me burime të financuara nga buxheti i shtetit janë miratuar sipas zërave, në fillim të vitit, me ndryshimet përkatëse. Shkresat dhe korrespondencat e miratimit të ndryshimeve janë bashkëlidhur procedurave përkatëse. Regjistrat e realizimeve për prokurimet publike të për vitin 2015, 2016 dhe 2017 janë hartuar e miratuar sipas zërave në fillim të vitit pasardhës, duke pasqyruar dhe ndryshimet respektive.

Nga auditimi i kryer në DARQT, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, konstatohet se janë hartuar regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve sipas periudhave objekt auditimit, konform VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kreu I, neni 4, si më poshtë vijon:

- *Me shkresën nr.692/1 prot, datë 30.01.2015, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka dërguar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2015 dhe nga ana tjetër, me shkresën nr. 44 prot., datë 28.04.2016, DAR ka dërguar në MAS realizimin e regjistrit të prokurimit për vitin 2015.*

Për vitin 2015, Autoriteti Kontraktor DARQT referuar shkresave të sipërcituara, nga periudha 30.09.2015 deri më 31.12.2015 ka parashikuar gjithsej 4 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël, të financuara nga buxheti i shtetit.

- *Me shkresën nr. 808/2 prot, datë 29.01.2016, MAS ka dërguar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2016.*

Autoriteti Kontraktor DARQT referuar shkresës së sipërcituar nga periudha Janar - Dhjetor 2016, ka parashikuar gjithsej 13 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël, 2 kërkesa për propozim, dhe 5 procedura shpenzimesh të drejtpërdrejta (për likuidim ujë, energji, post, telefoni etj), financiar nga buxheti i shtetit.

Me shkresën nr.7366 prot, datë 26.07.2016, MAS ka dërguar shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik të vitit 2016, sipas ndryshimeve të kërkuara nga autoritetet kontraktore, ku rezultojnë 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël, 1 kërkesë për propozim dhe 5 shpenzime të drejtpërdrejta.

- *Me shkresën nr. 19 prot, datë 09.01.2017, DAR i ka dërguar MAS realizimin e regjistrit të prokurimeve publike për periudhën Janar - Dhjetor 2016.*

Për vitin 2016 ky autoritet kontraktor, referuar shkresës së sipërcituar, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2016 ka zhvilluar gjithsej 18 procedura. Nga këto, 8 procedura prokurimi me vlerë të vogël, 9 procedura shpenzimesh të drejtpërdrejta dhe 1 procedurë prokurimi kërkesë për propozim.

- *Me shkresën nr.1688/1 prot, datë 20.02.2017, MAS ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për periudhën Janar- Dhjetor 2017.*

Për vitin 2017, autoriteti kontraktor DARQT ka parashikuar të zhvillojë gjithsej 16 procedura prokurimi. Nga këto, 8 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël, 7 procedura për shpenzime të drejtpërdrejta dhe 1 procedurë prokurimi të përqendruar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Nga ana e Drejtorit të DARQT, në zbatim të pikës 2 të Udhëzimit të APP nr. 3, *“Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij në fillim të çdo viti kalendarik ngrre komisionin e prokurimit me vlerë të vogël ose në rast mungese personeli, mund të caktojë njësinë e prokurimit për realizimin e këtyre procedurave të prokurimit”*. Për sa sipër, me urdhra të vçantë është mrgitur Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla, për periudhën objekt auditimi, si vijon:

Për v.2016:sipas urdhërit nr.11, datë 18.02.2016, me përbërje z. [REDAKTUAR]

Për v.2017: sipas urdhërit nr.11, datë 18.02.2016, me përbërje z. [REDAKTUAR]

ii. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar, konstatohet:

Prokurime të vitit 2016:

1. Me Urdhër Shpenzimin nr.69, datë 29.03.2016 është likuiduar operatori Agjencia e Abonimit të Shtypit “[REDAKTUAR]”, në vlerën 59,300.00 lekë. Fatura tatimore e shitjes është firmosur vetëm nga shitësi dhe mungon nënshkrimi i përfaqësuesit të autoritetit kontraktor(blerësi).

Nga auditimi i procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) dhe dokumentacionit bashkangjitur kësaj praktike të likuidimit, konstatohet se:

-Me Urdhër prokurimin nr.02, datë 21.03.2016 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për **“Abonim në shtypin ditor”**, me fond limit 60.000 lekë pa TVSH. Është mbajtur procesverbali i blerjes, bazuar në pika 8, të Udhëzimit të APP-së nr.3, datë 27.01.2015 *“Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”*, që specifikon se *“Kur vlera e përlllogaritur për mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor, brenda vitit kalendarik nuk është më e madhe se 100.000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor mund të kryejë prokurimin në rrugë shkresore sipas formularit nr.5, bashkëlidhur këtij udhëzimi”*. Është bërë testimi tregut dhe sipas ofertave të marra është shpallur fitues operatori **“Arben Trenova”**, me çmimin më të ulët, në vlerën 59.300 lekë pa tvsh. Më datë 24.03.2016 është lidhur kontrata ndërmjet palëve DARQT dhe operatorit fitues “[REDAKTUAR]” U auditua zbatimi i kontratës dhe nuk u konstatuan mangësi.

2. *Nga auditimi i procedurës së prokurimit në SPE dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikës së likuidimit, konstatohet se:*

- Me Urdhër Shpenzimin nr.87, datë 07.04.2016 është likuiduar operatori “[REDAKTUAR]” në vlerën 563,333 lekë pa tvsh, ose 676,000 lekë me tvsh për **blerje karburanti**.

-Me Urdhër Prokurimin nr. 03, datë 23.03.2016 ka filluar procedura e prokurimit me vlerë të vogël për **“Blerje karburanti”**, me fond limit 566.667 lekë pa TVSH/ 680.000 lekë me TVSH për 4,000 litra naftë. Konstatohet se, institucioni ka në inventarin e tij, mjetin tip **“Mitsubish Pajero”**, me targë TR 5775U (me naftë). Me urdhrin e titullarit të DARQT nr.25, datë 21.03.2016 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos për karburantin. Nga grupi i punës është bërë testimi i tregut si dhe përlllogaritja e fondit limit pa tvsh dhe me tvsh. Më datën 23.03.2016 është hedhur në sistem ftesa për ofertë dhe më datën 24.03.2016, ora 14.00, është zhvilluar tenderi online në adresën elektronike www.app.gov.al. Në këtë procedurë kanë paraqitur ofertat e tyre 5 operatorë ekonomikë. Po në këtë datë (24.03.2016), është mbajtur procesverbali nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i cili shpall fitues operatorin ekonomik të renditur i pari,D&J,me vlerën më të ulët të ofertës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Sipas ftesës për ofertë, operatori i shpallur fitues duhet të paraqitej brenda orarit zyrtar të ditës së parë të punës, nga dita e shpalljes së tij fitues në sistemin e APP-së. Rezulton se, më datë 25.03.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur procesverbal, ku ka vendosur të skualifikojë operatorin e parë, për shkak të mos paraqitjes dhe të ftojë operatorin ekonomik që është renditur i dyti, “██████████”. Për sa më sipër, me shkresën nr.541 prot, datë 25.03.2016, operatori i renditur i dyti, është njoftuar se është shpallur fitues. KVO më datë 29.03.2016, ka mbajtur procesverbalin nr.2, ku shpreh se operatori ekonomik i renditur i dyti, nuk është paraqitur dhe për këtë arsye fton operatorin ██████████, që është renditur i tretë. Me shkresën nr.570 prot., datë 29.03.2016, operatori i renditur i tretë është njoftuar që është shpallur fitues, por më datë 30.03.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sipas procesverbalit nr.3, vendos të skualifikojë operatorin e tretë për shkak të mos paraqitjes dhe të ftojë operatorin ekonomik të renditur i katërti, konkretisht “██████████”. Me shkresën nr.575 prot., datë 30.03.2016, operatori i renditur i katërti është njoftuar se është shpallur fitues, ndërsa me datë 31.03.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur procesverbalin, ku vendos të skualifikojë operatorin e katërt për shkak të mos paraqitjes dhe të ftojë operatorin ekonomik që është renditur i pesti, ██████████. Me shkresën nr.582 prot., datë 31.03.2016, operatori i renditur i pesti është njoftuar se është shpallur fitues, dhe në këtë datë operatori i renditur i pesti “██████████” është paraqitur dhe ka lidhur kontratën ndërmjet operatorit ekonomik fitues dhe DARQT. Më datë 01.04.2016 janë bërë hyrje në magazinë 4,000 litra naftë.

Konstatime:

1. Referuar urdhër shpenzimit nr.87, datë 07.04.2016, bashkëlidhur gjendet kontrata e lidhur më datë 31.03.2016, midis operatorit ekonomik fitues “██████████” përfaqësuar nga ██████████ dhe titullarit të autoritetit kontraktor znj ██████████

3. Me Urdhër Shpenzimin nr.113, datë 06.05.2016 është likuiduar operatori “██████████” në vlerën 630.050 lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit në SPE dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikës së likuidimit, konstatohet se:

-Me Urdhër Prokurimin nr.04, datë 07.04.2016 është filluar procedura e prokurimit me vlerë të vogël për “**Blerje shkumësi të bardhë**”, me fond limit 541.667 lekë pa TVSH/650,000 lekë me TVSH.

-Meqenëse operatorët ekonomikë që kishin paraqitur ofertat përmes sistemit elektronik dhe që sipas renditjes (vendi i parë) duhet të lidhnin kontratë, nuk u paraqitën, procedura e tenderimit është anuluar pasi është zhvilluar dy herë për mungesë konkurrence. Realizimi i saj është kryer në rrugë shkresore. Fitues është shpallur operatori ekonomik “██████████” me vlerë oferte 189 lekë/kg, ose $2778 \text{ kg} \times 189 = 525.042$ lekë pa tvsh, ose 630.050,40 lekë me TVSH. Referuar nenit 42, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, me urdhër të titullarit është ngritur komisioni për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të mallit dhe është mbajtur procesverbal për konstatimet përkatëse. Sipas udhëzimit të mësipërm, (neni 37), malli është bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr.02, datë 04.05.2016 dhe nënshkruar nga specialistja e financës që mbulon magazinën. Fatura tatimore e shitjes është firmosur rregullisht nga blerësi, transportuesi dhe shitësi. Procedura konsiderohet e rregullt.

4. Me Urdhër Shpenzimin nr.244, datë 28.10.2016 është likuiduar subjekti fizik “██████████”, në vlerën 946.200 lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit në SPE dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikës së likuidimit, konstatohet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

-Me Urdhër prokurimin nr.11, datë 16.09.2016 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për **“Blerje mjete sportive”**, me fond limit 799.834 lekë pa TVSH/959.801 lekë me TVSH. Në konkurrim kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike 37 operatorë ekonomikë. Procedura ka deshtuar dy here, pasi asnjë nga operatorët fitues nuk është paraqitur për të lidhur kontratë. Më datë 12.10.2016 është anuluar procedura.

Përfundimisht, më datë 21.10.2016 është bërë blerje e drejtpërdrejt dhe fitues është shpallur operatori “██████” me ofertën me vlerë totale 946.200. Më datë 24.10.2016 është ngritur komisioni, i cili ka bërë verifikimin dhe ka marrë në dorëzim mallin. Referuar Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, nen 37, në datën 24.10.2016 me fletëhyrjen nr.8 është marrë në dorëzim malli objekt i kontratës, i cili sipas planit të shpërndarjes janë shpërndarë në çdo shkollë 9-vjeçare e të mesme, në varësi të Drejtorisë Arsimore Rajonale Qarku Tiranë. Procedura konsiderohet e rregullt.

5. Me Urdhër Shpenzimin nr.249, datë 28.10.2016 është likuiduar subjekti ██████, në vlerën 237.360 lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit në SPE dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikës së likuidimit konstatohet se:

-Me Urdhër prokurimin nr.16, datë 18.10.2016 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël, për **“Riparim për automjetin tip Mitsubishi Pajero 2800 Turbo Diesel, viti i prodhimit 1995”**, me fond limit 247.567 pa TVSH/297.081 me TVSH, ku është shpallur fitues subjekti me çmimin më të ulët “██████”, në vlerën 197.800 lekë pa tvsh ose 237.360 me TVSH.

-Me urdhrin 78, datë 17.10.2016 është ngritur një grup pune për hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos së riparimit të automjetit. Grupi i punës ka mbajtur një procesverbal ku ka specifikuar nevojat për riparim të makinës. Në këtë procesverbal janë kërkuar 15 artikuj për servis. Grupi i punës ka mbajtur procesverbalin pa bërë paraprakisht një kontroll në servis për të identifikuar dëmet që ka makina dhe më pas pjesët që duhen zëvendësuar. ***Fatura tatimore e shitjes është firmosur vetëm nga shitësi dhe jo nga blerësi si dhe nga transportuesi. Situacioni i punimeve është firmosur vetëm nga Administratori I servisit z.██████ dhe nuk është konfirmuar me nënshkrim nga asnjë përfaqësues i subjektit DARQT.*** Në këtë rast është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 54, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011, “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj”.

Nga ana e DARQT për këtë çështje në observacionet e dërguara me shkresën nr. 372 prot, datë 29.02.2018 , “Dërgohen sqarimet për projektraportin e dërguar nga KLSH”, (prot në KLSH me nr 1307/4, datë 28.02.2018) ka bërë komente dhe shpjegime si më poshtë:

“Në lidhje me mosmbajtjen e një procesverbali në përfundim të servisit të bërë që konfirmon se punimet janë kryer, pjesët janë ndërruar dhe se mjete funksionon po ju dërgojmë një kopje të akt marrjes në dorëzim të automjetit me targë TR5775 U. Në lidhje mosfirmosjen e faturës tatimore nga ana jonë ju sqarojmë se kopja origjinale është firmosur pasi nuk mund të kryhen veprimet në thesar.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se këto dokumente duhet ti ishin vënë në dispozicion në kohë grupit të auditimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar me objeksionet, ky koment i institucionit arsimor merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

6. Me Urdhër Shpenzimin nr.310, datë 16.06.2016, është likuiduar operatori [REDAKTUAR], në vlerën 384,200 lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikës së likuidimit, konstatohet se:

-Me Urdhër prokurimin Nr. 17 Prot., date 25.11.2016 është filluar procedura e prokurimit me vlerë të vogël për **“Pajisje kancelari”**, me fond limit 367.270 lekë pa TVSH/440.724 lekë me TVSH.

-Është hedhur ftesa për ofertë Nr.2709 prot., datë 25.11.2016. Është mbajtur procesverbali më datë 02.12.2016, ku shpallet fitues I pari operator I renditur në listë . Ky operator nuk është paraqitur. Më datë 05.12.2016, është mbajtur procesverbal ku është njoftuar I dyti operator I renditur në listë “E.0 Qafmolla”. Më datë 06.12.2016, është ngritur urdhër nga titullari I DARQT për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të kancelarive. Është mbajtur procesverbali nga ky komision më datë 06.12.2016 ku konfirmon marrjen e artikujve. Referuar Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, neni 37, në datën 06.12.2016 me fletëhyrjen nr.9 është marrë në dorëzim malli objekt i kontratës, i cili sipas planit të shpërndarjes janë shpërndarë në çdo shkollë 9-vjeçare e të mesme, në varësi të Drejtorisë Arsimore Rajonale Qarku Tiranë. Procedura konsiderohet e rregullt.

Auditimi i procedurave të prokurimit të kryera gjatë vitit 2017:

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit në SPE dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikës likuidimit konstatohet se:

- Me Urdhër Shpenzimin nr.69, datë 17.03.2017 është likuiduar operatori “ [REDAKTUAR] Sh.a në vlerën 397.500 lekë pa tvsh, ose 477,000 lekë me tvsh.

-Me Urdhër Prokurimin nr.02, datë 27.02.2017 ka filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për **“Blerje karburanti”**, me fond limit 400,000 lekë pa TVSH/480.000 lekë me TVSH për 3,000 litra naftë. Konstatohet se, institucioni ka në inventarin e tij, mjetin tip ”Mitsubish Pajero”, me targë TR 5775U (me naftë). Me urdhrin nr. 09 prot., datë 23.02.2017 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos për karburantin. Më datë 03.03.2017, është lidhur kontrata midis operatorit fitues dhe autoritetit kontraktor. Në magazinë janë bërë hyrje **3,000 litra** naftë me Fletë Hyrjen Nr.1 datë 03.03.2017. Kjo procedurë konsiderohet e rregullt.

2. Prokurimi për shkumësin shkollor 2017

Nga auditimi i procedurës së prokurimit në SPE dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikës likuidimit konstatohet se:

- Me Urdhër Shpenzimin nr.131, datë 10.05.2017 është likuiduar operatori “ [REDAKTUAR] Sha në vlerën 673,200 lekë me tvsh.

-Me Urdhër Prokurimin nr.04, datë 30.03.2017 është filluar procedura e prokurimit me vlerë të vogël për **“Blerje shkumësi të bardhë”**, me fond limit 565.800 lekë pa TVSH/678,960 lekë me TVSH.

-Meqenëse operatorët ekonomikë që kishin paraqitur ofertat përmes sistemit elektronik dhe që sipas renditjes (vendi i parë) duhet të lidhnin kontratë, nuk janë paraqitur, procedura e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

tenderimit është anuluar më datë 02.05.2017. Pasi procedura është zhvilluar dy herë për mosparaqitje të operatorëve ekonomik ose tërheqje të tyre nga gara, realizimi i saj është kryer në rrugë shkresore. Fitues është shpallur operatori ekonomik “[REDAKTUAR]” me vlerë oferte 187 lekë/kg, pra $3,000 \text{ kg} \times 189 = 561,000$ lekë pa tvsh ose 673.200 lekë me TVSH. Më datë 08.05.2017 me urdhrin nr 26 të titullarit të DARQT është ngritur komisioni për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të shkumësit shkollor. Po në këtë datë është mbajtur procesverbal nga komisioni ku konstatohet marrja në dorëzim e shkumësit shkollor sipas specifikimeve dhe sasisë së kërkuar. Në datën 08.05.2017 me fletëhyrjen nr.3 është marrë në dorëzim malli objekt i kontratës, i cili sipas planit të shpërndarjes është ndarë në çdo shkollë 9 vjeçare dhe të mesme në varësi të Drejtorisë Arsimore Rajonale Qarku Tiranë.

3. Prokurimi për transportin e administratorëve të provimeve për maturën shtetërore 2017:

-Me Urdhër Shpenzimin nr.176, datë 06.07.2017 është likujduar operatori “[REDAKTUAR]” në vlerën 284.988 lekë me tvsh.

-Me Urdhër Prokurimin nr.07, datë 23.05.2017 është filluar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël për “Shërbimin e transportit të administratorëve të provimeve të Maturës Shtetërore nëpër shkollat në varësi të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë”, me fond limit 248.950 lekë pa TVSH/298.740 lekë me TVSH.

Më datë 23.05.2017 është hedhur në system ftesa për ofertë sipas specifikimeve teknike. Kanë paraqitur ofertën e tyre 4 operatorë ekonomikë. Operatori i parë fitues është tërhequr dhe si pasojë është shpallur fitues operatori i renditur i dyti, “[REDAKTUAR]” sh.p.k, i cili ka ofruar shërbimin e kërkuar. Ky operator ka kryer shërbimin e kërkuar për datat përkatëse. Kjo procedurë konsiderohet e rregullt.

iii. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tenderit “Shërbim interneti viti 2015 dhe viti 2016” konstatohet që:

1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prokurimit për “Shërbim Interneti për Shkollat në varësi të DARQT për vitin 2015”, u konstatua se lloji i procedurës është prokurim me vlerë të vogël, sipas përcaktimeve në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të vitit 2015, (i ndryshuar me shkresën e MAS nr.8035/7 prot datë 26.10.2015).

Nga titullari i AK është nxjerrë Urdhër prokurimi nr.14, datë 30.10.2015. Fondi limit 748.634 lekë pa tvsh, ose 898.361 lekë me tvsh. Komisioni i prokurimit ka shpallur fitues nëpërmjet sistemit, operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]”, me vlerë oferte 500.000 lekë pa tvsh, ose 600.00 lekë me tvsh. Janë kryer pagesat e likuidimeve për shumën 443.480 lekë. Pasqyrat në lidhje me furnizimin e shërbimit të Internetit janë mbajtur sipas shkollave që kanë përfutur këtë shërbim për muajin nëntor dhe dhjetor 2015. **Nuk u konstatuan parregullsi.**

2.Nga auditimi i dokumentacionit ligjor me objekt prokurimi “Shërbim Interneti për Shkollat në varësi të DARQT për vitin 2016”, fondi i planifikuar (me shtesat e ndryshimet) në regjistrin e parashikimeve të vitit 2016 për këtë procedurë, Me ndryshimet e bëra në regjistrin e parashikimeve është pakësuar fondi, nga 7.500.000 në 3.489.141 dhe është realizuar në vlerën 2.823.307 lekë pa tvsh, siç evidentohet në tabelën e mëposhtme :

Titulli

Institucioni	Prokurimi	Proced.prok	Regj/parash Fondi 2016	Shtesa/ndrysh Regj/parashik	Regj/Realiz 2016
DARQT	Shërbim Interneti	Kërkesë për propozim	7.500.00	3.489.141	2.823.307



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Burimi: DARQT

Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të vënë në dispozicion për këtë procedurë prokurimi konstatohet se është nxjerrë urdhër prokurimi ***në përputhje me kuadrin ligjor*** për prokurimin publik; urdhri për ngritjen e komisioneve si dhe monitorimin e kontratës. Nga komisionet e caktuara janë ndjekur procedurat ligjore për zhvillimin e procedurës deri në njoftimin dhe lidhjen e kontratës, si dhe janë likuiduar detyrimet e lindura për këtë shërbim.

Dokumentacioni ligjor i verifikuar për kryerjen e Procedurave të Prokurimit Publik me objekt “Shërbim Interneti për vitin 2016”, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Të dhëna për prokurimin	NJP dhe Komisionet	KVO
a	b	c
1.Urdhër prokurimi nr. 1 datë 02.03.2016 2. Urdhër nr.15 datë 29.02.2016 2.Fondi limit. 7.978.140 lekë pa tvsh ose 9.573.768 lekë me tvsh 3. Proced. prok. “Shërbim Interneti për vitin 2016” Lloji procedurës “ kërkesë për propozim ” 4. Data e zhvillimit 15.03.2016 5.Kontraktuesi subjekti ALBtelecom sha 6. Data e lidhjes kontratës 28.04.2016 Vlera e kontratës, shumëzimi i cmimit mujor të ofertuar me periudhën e furnizimit me internet, vlera mujore 360.513 lekë pa tvsh ose 432.616 me tvsh	Njësia Prokurimit [Redacted] [Redacted]. specialiste Finance Komis/hart specifik/teknike [Redacted] [Redacted]. Komis/menaxhimit kontratës [Redacted] [Redacted]	[Redacted] Kryetar 2. [Redacted] anëtar 3. [Redacted] anëtar

Me Urdhrin e titullarit të DARQT nr.15, datë 29.02.2016, është ngritur grupi punës për ***testimin e tregut mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos për shërbimin e internetit***. Ky grup pune përcakton vlerën limit të kontratës publike që është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit. Nga shqyrtimi i Procesverbalit nr.1, datë 02.03.2016, të mbajtur nga Njësia e Prokurimit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, grupi i punës ka pasqyruar vlerën totale të fondit limit të përlllogaritur, por nuk ka pasqyruar në procesverbal mënyrën se si është përlllogaritur fondi.

Gjatë verifikimit dokumentacionit ligjor për këtë procedurë prokurimi u konstatuan disa mangësi dhe parregullsi, si vijon:

1. Në dosjen e procedurës së prokurimit ndodhet **Procesverbali nr.1, datë 02.03.2016**, i mbajtur nga Njësia e Prokurimit, mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe **analizën e kostos** për shërbimin e internetit, mirëpo konstatohet se nuk pasqyrohet një përlllogaritje e detajuar e fondit limit. Referuar regjistrin të parashikimeve për këtë procedurë fillimisht janë pranuar ofertat financiare nga OE pjesëmarrës në procedurë që ofrojnë shërbimin e internetit për 10 muaj, më pas fondi limit nga DARQT është përlllogaritur për ofrimin e shërbimit për 9 muaj, ndërsa shërbimi i internetit është realizuar për 8 muaj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Nga ana e DARQT për këtë çështje në observacionet e dërguara me shkresën nr. 372 prot, datë 29.02.2018, “Dërgohen sqarimet për projektraportin e dërguar nga KLSH”, (prot në KLSH me nr 1307/4, datë 28.02.2018) ka bërë komente dhe shpjegime si më poshtë:

“Në faqen 34, pika 1 për përllogaritjen e fondit limit nga ana e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike dhe analizën e kostos ju sqarojmë që me Urdhërin nr.15, datë 29.02.2016 është ngritur grupi punës i cili ka bërë hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos sipas ofertave të marra nga operatorët ekonomik 1. [REDAKTUAR] 2. [REDAKTUAR] 3. [REDAKTUAR] e cila është finalizuar me procesverbalin e datës 29.02.2016, ku nga ana e grupit të punës pavarësisht se nuk është shkruar në këtë procesverbal, përllogaritja e detajuar por është shkruar nga eksperiencat e viteve të kaluara dhe të ofertave të marra nga operatorët ekonomik.

Ofertat financiare të marra nga operatorët ekonomik janë marrë për 10 muaj, por për arsye të afateve që duhet për të përfunduar procedurën e prokurimeve, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe të VKM nr.194, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përllogaritja është bërë për 9 muaj. Kurse realizimi për tetë muaj është bërë për arsye se pagesa do të fillojë nga momenti i konfigurimit të shërbimit të internetit për të gjitha shkollat e DAR Qarkut Tiranë.”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e nenit 59, të VKM nr. 914, datë 29/12/2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet që: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar me objeksionet, ky koment i institucionit arsimor nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

4. Nga auditimi i dokumentacionit ligjor u konstatua se Proces Verballi i printuar që është pjesë e dosjes i mbajtur nga KVO për vlerësimin e ofertave nuk është firmosur nga njëri prej anëtarëve të komisionit Z. [REDAKTUAR] i cili ka firmosur deklaratën e paanësisë si dhe raportin përmbledhës për zhvillimin e procedurës së tenderit, veprim në kundërshtim me pikën 5, të nenit 64, të VKM nr. 914, datë 29/12/2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik” në të cilën përcaktohet që:

“Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e KVO është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. ...”.

-Nga verifikimi në sistem, konstatohet se [REDAKTUAR] ka realizuar procedurat e prokurimit në rregull, sipas udhëzimit të APP-së.

Nga auditimi rezultoi:

Kontrata nr. 800, datë 28.04.2016 është lidhur ndërmjet përfaqësuesit Znj. E. M., Drejtor i Drejtorisë Arsimore Qarku Tiranë, me cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe “ALBtelecom” sha, e përfaqësuar nga [REDAKTUAR] Në cilësinë e operatorit ekonomik dhe si kontraktues. Me zhvillimin e tenderit, shpalljen fitues dhe lidhjen e kontratës, Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë urdhrin nr.35 datë 29.04.2016, dhe ka ngritur grupin e punës për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

menaxhimin e kontratës “Shërbim Interneti për vitin 2016 për DARQT dhe shkollat në varësi të institucionit”, i përbërë nga [REDAKTUAR]. Gjatë auditimit të dokumentacionit ligjor lidhur me *menaxhimin e kontratës*, konstatohet se janë administruar dokumentacionet e plota mbi dokumentimin e cilësisë së shërbimit të mbajtur nga grupi i punës. Konkretisht, me datën 31.05.2016 nga ana e [REDAKTUAR] janë njoftuar drejtuesit e shkollave mbi mungesat nga ana e tyre në trajnimin për raportimin e shkëputjeve /defekteve të internetit dhe mënyrën e raportimit, në kuadër të zbatimit të kontratës. Edhe me datën 16.06.2016 është nënvizuar se “*përveç raportimit mujor me google form, drejtuesit e shkollave duhet të raportojnë me email kur ndërpritet shërbimi i internetit, në ditën që kjo ndodh, pasi nëse njoftimet bëhen në fund të muajti, Albtelecom nuk e njeh mospagesën*”

Audituesit e KLSH konstatojnë se janë mbajtur procesverbalet për çdo muaj për këtë shërbim. Grupit të auditimit iu vu në dispozicion nga ana e përgjegjës të seksionit të shërbimeve, z. [REDAKTUAR] kopje e listave të shkollave që kanë marrë shërbimin e internetit, të konfirmuara /firmosura vetëm nga një anëtar i grupit të punës. Sa sipër, audituesit e KLSH-së, nënvizojnë se janë zbatuar detyrimet e kontratës dhe përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29/12/2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar

Referuar përmbajtjes së Kontratës nr. 800, datë 28.04.2016, në nenin 4 të saj përcaktohet “Çmimi i kontratës dhe kushtet e pagesës”, ku theksohet që “*Pagesa do të bëhet jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga momenti i marrjes në dorëzim të faturës tatimore nga Kontraktori tek DAR/ZA, pas plotësimit të dokumentacionit që vërteton kryerjen e shërbimit sipas kushteve dhe specifikimeve teknike të kësaj kontrate*”. Nga auditimi i realizimit të kontratës rezulton se janë kryer sipas urdhër pagesave të mëposhtme likuidimi i detyrimeve kontraktuale për punën e kryer si më poshtë:

Titulli?

Nr	Urdhër shpenzimi	datë	Shuma e	muaji
			Likujduar (me tvsh)	
1.	161	06.07.2016	365.296	Maj
2.	187	03.08.2016	432.616	Qershor
3.	207	13.09.2016	346.216	Korrik
4.	213	22.09.2016	402.376	Gusht
5.	246	27.10.2016	423.616	Shtator
6.	278	17.11.2016	432.616	Tetor
7.	308	15.12.2016	432.615	Nentor
8.	313	27.12.2016	432.615	dhjetor
	Totali 2016		3.267.966	

Sa më sipër arrihet në përfundimin që:

- 1) Nga DARQT, në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për sa i përket hartimit dhe miratimit të regjistrave të parashikimeve dhe regjistrave të realizimit të prokurimeve publike për vitet 2015-2017.
- 2) Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të audituara janë respektuar në përgjithësi kërkesat ligjore të parashikuara në legjislacionin përkatës.
- 3) Gjatë auditimit të dokumentacionit ligjor në procedurën e Prokurimit me objekt “Shërbim Interneti për vitin 2016”, janë konstatuar mangësi për testimin e tregut mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

c. Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006. Vlerësimi i posteve të aktivitetit dhe pasivitetit si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (*fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.*)

Saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe valutë.

Mbi inventarizimin e aktiveve në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr.783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” dhe VKM nr.248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njërive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001. Auditimi vlerëson se, veprimet dhe transaksionet janë regjistruar mbi bazën e dokumenteve justifikues që mbështesin regjistrimet kontabël si në mënyrë kronologjike, ashtu dhe sistematike, konform përcaktimeve të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njërive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njërive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”.

DAR Qark Tiranë është njësi shpenzuese me kontabilitet më vete. Ndonëse në organigramë, si pjesë e saj janë dhe Zyrat Arsimore Kamëz e Kavajë, ato në pikëpamjet e buxhetimit dhe mbajtjes së veprimtarisë kontabile, funksionojnë të pavarura nga DAR Qark.

Mbyllja e bilancit për vitin 2015 dhe 2016 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse. Veprimet për vitin 2015 e 2016 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi.

Llogaritë vjetore, bilanci kontabël si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga DAR, gjatë vitit ushtrimor 2015 dhe 2016, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit Tiranë. Kopje e bilancit dhe pasqyrave financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, të cilat janë konfirmuar me vulosjen e tyre, brenda datës 28 shkurt të vitit pasardhës. Bilanci është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore .

Për vitin 2015 dhe 2016 në bazë të të dhënave kontabile përkatëse janë përpiluar llogaritë e vitit ushtrimor (bilanci), si më poshtë:

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore për vitin 2015 dhe 2016 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (2016) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (2017):

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundërfirmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar Degës së Thesarit, si vijon:

-për vitin **2015** me shkresën nr. 118, datë 20.01.2016;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

-për vitin **2016** me shkresën Nr. 65, datë 18.01.2017.

Auditimi u bë me të zgjedhur për këto çështje:

i.ANALIZA E POSTEVE KRYESORE TE BILANCIT:

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2016 rezultoi:

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 totali i aktiveve të qëndrueshme është i barabartë me nënzërin “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara” në vlerën neto prej 12,4 milionë lekë në v.2015 dhe 10,6 milionë lekë për vitin 2016 duke i pasqyruar sipas zërave, si më poshtë:

Të dhënat në lekë

			v.2016	v.2015
2	A	AKTIVE TE QENDRUESHME	10,633,288	12,477,884
3	20, 230	I.Te pa trupezuara	0	0
4	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave		
5	202	Studime dhe kerkime		
6	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme		
7	209	Amortizimi i aktiveve qendrushme te pa trupezuara(-)		
8	230	Shpenzime per rritjen e aktiv.qendr.patruezuara		
9	21,23, 24,28	II.Akt.Qendr.te Trupezuara	10,633,288	12,477,884
10	210	Toka,troje,Terene		
11	211	Pyje,Kullota Plantacione		
12	212	Ndertime e Konstruksione	19,721,850	19,721,850
13	213	Rruge,rrjete,vepra ujore		
14	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune		
15	215	Mjete transporti	2,400,000	2,400,000
16	216	Rezerva shtetore		
17	217	Kafshe pune e prodhimi		
18	218	Inventar ekonomik	6,279,493	6,829,315
19	219	Amortizimi aktiv.Qendr.te trupezuara(-)	-17,768,055	-16,473,281
20	231	Shpenzime proces per rritjen e AQT		
21	232	Shpenzime proces per transferime kapitale		
24	25.26	III.Aktive Financiare	0	0

Burimi: Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme, DAR Tiranë Qark

- Zëri “**Ndertime e konstruksione**” (llog. 212) për vlerën 19,721 mijë lekë për të dy periudhat e auditimit është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me kartelën e inventarit kontabël.
- Zëri “**Mjete transporti**” (llog. 215) është për vlerën 2,400 mijë lekë, që i zbërthyer në mënyrë analitike përfshin vlerën e një mjeti autoveturë tip mitsubish në inventar të DAR Qark.
- Zëri “**Inventar ekonomik**” (llog. 218) për vlerën 6,279 mijë lekë për v.2016 nga 6,829 mijë lekë që ishte para një viti, vleftë kjo e zbërthyer në mënyrë analitike dhe e rakorduar me inventarët e kryer.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

- Zëri “Debitorë të ndryshëm” (llog. 468) evidentohet për vlerën zero lekë. Auditimi konstaton se në këtë llogari nuk janë pasqyruar detyrimet e lënë nga raporti i mëparshëm i auditimit të KLSH-së mbajtur në Prill 2011, ku 16 punonjës janë dhënë masa për shpërblim dëmi, nga sa përfituar padrejtësisht në vlerën **292,506 lekë**.

ii. ANALIZA E DEBI-KREDIVE:

ii/a- Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

“Kërkesat e arkëtimit mbi Debitorët” (Klasa 4) pasqyrohen në aktiv të bilancit, (formati nr. 1), për vlerën 87,062 mijë lekë për v.2016 dhe 88,250 mijë lekë në v.2015, ku e gjithë kjo vlerë është kontabilizuar tek “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, e cila në analizë në formatin nr. 2 përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen nga viti i mëparshëm si “Personeli e llogari të lidhura” (llog. 42) për 61,590 mijë lekë; “detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa” (llog. 431) për 4,428 mijë lekë si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore etj.

Në bilanc nuk janë evidentuar detyrime ndaj të tretëve për shërbime të kryera në vitin e mëparshëm.

Të dhënat në lekë

			v.2016	v.2015
20	Klasa 4	II.Detyrime afatshkurter	87,062,931	88,250,751
21	419	Kliente (Kreditore), parapagese pjesore		
22	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to		
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	61,590,308	62,239,745
24	431	Detyrime ndaj Shtetit per tatim-taksa	4,428,514	4,632,928
25	432	Tatime mbedhura nga shteti per llog.Pusht.Lokal		
26	433	Shteti fatkeqesi natyrore		
27	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor) Pulla takse		
28	435	Sigurime shoqerore	18,280,211	18,524,347
29	436	Sigurime shendetsore	2,536,216	2,570,167
30	437.438	Organizma te tjere shoqerore telef	75,682	63,364
31	44	Institucione te tjera publike	152,000	220,200
32	45	Marrdhenie me institucione brenda e jasht sistemit		
33	460	Huadhenes		
34	464	Detyrime per t'u paguar per blerjen e letr,vlere		
35	466	Kreditore per mjete ne ruajtje		
36	467	Kreditore te ndryshem (Banka Permbarimore)		

Burimi: Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme, DAR Tiranë Qark

ii-b. Kontabilizimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Janë likuiduar shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas 14 urdhër shpenzimeve të kaluara në thesar për vitin 2015 për 5 persona në shumën 6,222,721 lekë, 3 urdhër shpenzimeve për vitin 2016 për 2 persona në shumën 1,747,075 lekë dhe 16 urdhër shpenzimeve në vitin 2017 për 5 persona në shumën 4,264,861 lekë. **E gjithë shuma për**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

ekzekutimin këtij vendimi gjyqësor është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit duke qenë se i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, në shumën 12,234,657 lekë në total, ku përfshihen 368,200 lekë tarifa përmbartimore dhe shpenzime gjyqësore, si vijon:

Të dhënat në lekë

Pagesat e kryera për vendimet gjyqësore në vitin 2015

Nr	Urdhërshpenzimi nr, datë	Ilir Domi	Ndoc Dedaj	Vullnetar Hate	Pajtim Camo	Eqerem Shaba	Shtator	Dhjetor	Likujduar
1	60,13.03.15	476,850							476,850
2	61,12.03.15		474,600						474,600
3	62,12.03.15			393,020					393,020
4	98,21.04.15	479,925							479,925
5	99,21.04.15		474,600						474,600
6	100,21.04.15			392,020					392,020
7	113,05.05.15				334,227				334,227
8	147,dt24.06.15	950,625							
9	148,29.06.15		474,608						474,608
10	149,29.06.15			648,648					648,648
11	159, 06.06.17								0
12	163,8.06.17								0
13	166,19.06.17								0
14	188 dt 23.07.15					800,000			800,000
									0
	Totali i likujdimeve	1,907,400	1,423,808	1,433,688	334,227	800,000	0	0	5,899,123
	Tarifa përmbartimore+shp.gjyqësore	12,300		50,000		56,320	110,575	10,000	239,195
				85,403					85,403
	Diferenca	1,919,700	1,423,808	1,569,091	334,227	856,320	110,575	10,000	6,223,721

Burimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, DAR Tiranë Qark

Për vendimet gjyqësore në proces gjykimi, janë planifikuar fondet në Projekt Buxhetin Afatmesëm të periudhës 2016-2018 dhe PBA 2017-2019.

Të dhënat në lekë

Pagesat e kryera për vendimet gjyqësore në vitin 2016

Nr	Urdhërshpenzimi Nr. Datë	Jonuz Daci	Astrit Bardhi						Likujduar
1	88, 07.04.16	396,065							396,065
2	115, 12.05.16	350,625							350,625
3	307, 14.12.16		1,000,385						1,000,385
	Totali i likujdimeve	746,690	1,000,385	0	0	0	0	0	1,747,075
	Tarifa përmbartimore +shp.gjyqësore								0

Burimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, DAR Tiranë Qark

Të dhënat në lekë

Pagesat e kryera për vendimet gjyqësore në vitin 2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Nr	Urdhershpenzim nr. date	Selim Aga	Advije Fillolli	Reshit Agaj	Mirela Spahiu	Marsela Kolonjari	Likuiduar	Detyrimet v.gjyqesore
1	76,21.03.17	593,000					593,000	1,126,700
2	99,7.04.17		273,000				273,000	
3	100,07.04.17	533,700					533,700	
4	107,12.04.17			291,000			291,000	
5	108, 12.04.17				57,260		57,260	
6	127,04.05.17				57,260		57,260	
7	132, 10.05.17				57,260		57,260	
8	137,17.05.17		273,000				273,000	
9	138, 17.05.17				57,260		57,260	
10	159, 06.06.17				57,260		57,260	
11	163,8.06.17			291,000			291,000	
12	166,19.06.17				57,260		57,260	
13	189,12/07/17			291,000			291,000	
14	190,12/07/17		182,000				182,000	
	216,17.08.17			242,500			242,500	
15	260,11.10.17		91,000				91,000	
16	323,11.12.17					730,901	730,901	
	Totali likuidimeve i	1,126,700	819,000	1,115,500	343560	0	4,135,661	
	Tarifa permbarimore+ shp.gjyqesore			87200	42000		129,200	
	Total gjithsej	1,126,700	819,000	1,202,700	385,560	0	4,264,861	

Burimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, DAR Tiranë Qark

Si gjetje u konstatua:

Gjatë viteve që janë objekt auditimi, një pjesë e detyrimeve të lindura apo faturave të lëshuara për shpenzimet e kryera, janë likuiduar në periudha të vitit pasardhës. Vlera e detyrimit të mbetura pa u likuiduar, nuk është kontabilizuar si angazhim për tu paguar në bazë të parimit të të drejtave dhe detyrimeve të kontatuara. Vlerat e këtyre faturave janë likuiduar me urdhër shpenzimet përkatëse, por janë kontabilizuar dhe janë paraqitur si detyrim dhe në të njëjtën kohë edhe si likuidim i këtij detyrimeve në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Kështu, mund të përmendim:

Sa likuiduar në vitin 2016 detyrime të viti 2015 pa i paraqitur si detyrime në bilanc:

- Me urdhër-shpenzimin nr.14, datë 07.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e telefonisë celulare (operatori [REDACTED]) për detyrime të shtatorit 2015, në vleftën 63,364 lekë; Me urdhër-shpenzimin nr.21, datë 04.02.2016 janë likuiduar shpenzimet ndaj sh.a [REDACTED] për detyrime të muajit dhjetor 2015, në vleftën 2,280 lekë; Me urdhër-shpenzimin nr.22, datë 04.02.2016 janë likuiduar shpenzimet e telefonisë fikse (operatori [REDACTED]) për detyrime të muajit dhjetor 2015, në vleftën 4,074 lekë; Me urdhër-shpenzimin nr.23, datë 04.02.2016 janë likuiduar shpenzimet e energjisë elektrike të muajit dhjetor 2015, në vleftën 36,472 lekë, etj

Sa likuiduar në vitin 2017 detyrime të viti 2016 pa i paraqitur si detyrime në bilanc:

- Me urdhër-shpenzimin nr.14, datë 11.01.2017 janë likuiduar shpenzimet e telefonisë fikse (operatori [REDACTED]) për detyrime të shtatorit 2015, në vleftën 63,364 lekë; Me urdhër-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

shpenzimin nr.19, datë 23.01.2017 janë likuiduar shpenzimet e energjisë elektrike për detyrime të muajit dhjetor 2016, në vlef të 2,000 lekë; Me urdhër-shpenzimin nr.20, datë 23.01.2017 janë likuiduar shpenzimet ndaj [REDAKTUAR] për detyrime të muajit dhjetor 2016, në vlef të 1,560 lekë, etj.

Mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël nuk është mbështetur mbi bazën e parimit të kontabilitetit rrjedhës pra mbi **bazën e angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara** me qëllim që pasqyrat financiare të përmbushin objektivat e tyre, por vetëm në standarde të cilat aplikohen mbi bazën e parimit të kontabilitetit mbi baza monetare. Si rrjedhim efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (*ka ndodhur kur vlerat ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen*) dhe të regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera (vlerat e faturave, vendimeve gjyqësore që shlyhen në disa vite, kontratave të lidhura gjatë vitit ushtrimor me afat një vjeçar ose shume vjeçar) duhet të pasqyrohen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe të regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin, mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

ii-c. gjendja e librit shkollor jashtë katalogut.

Gjatë auditimit të llogarisë 35 “Mallra” (në aktivin e bilancit kontabël), konstatohet se një pjesë e tyre janë mallra stoqe. Llogaria për periudhën e audituar 2015 dhe 2016 paraqitet respektivisht me vlerën **3,455,707 lek** dhe **3.143.230 lekë**. Kjo vlerë përfaqëson libra stok, një **kontingjent prej 89 artikuj të regjistruar në v.2015 dhe 77 artikuj në v.2016, ose 31,427 copë librash shkollorë jashtë katalogut / libri shkollor stok, që përfaqëson përkatësisht:**

- Tekste të arsimit 9 vjeçar, 16.752 copë libra, me vlerë 1.670.555 lekë,
- Tekste të arsimit të mesëm, 14.675 copë libra, me vlerë 1.472.675 lekë.

Këto libra ndodhen gjendje në magazinë, që nga viti 2002, 2003, 2004 dhe 2005, duke mbetur stok **pasi janë jashtë curricul-ave (jashtë programit mësimor), e për pasojë nuk kanë vlera përdorimi**. Kështu, në strukturën e këtyre artikujve janë tekste shkollore dhe fletë pune si më poshtë:

-gjuhë shqipe 6, v.2003 dhe 2004, gjithsej 1,080 copë;
-lexim letrar 6, v.2003 dhe 2004, gjithsej 1,210 copë;
-matematikë 6, v.2003 dhe 2004, gjithsej 1,096 copë;
-fizikë 6, v.2003 dhe 2004, gjithsej 1,186 copë x 110 lekë/ copë;
-edukim muzikor, ed. shëndetësor, 2005;
-fletore pune për nx. klasat 1-6, v.2003, gjithsej 6,836 copë, me çmim 45-85 lekë/copë, etj.;
(Më hollësisht, gjendja e teksteve stok me datën 31.12.2015 paraqitet në aneksin nr.1 në fund të këtij dokumenti)

Aktualisht ky kontingjent tekstesh janë sistemuar në mjediset e DAR Qark Tiranë, për të cilat në disa raste të dëmtimeve dhe mykjes nga lagështira janë nxjerrë jashtë përdorimit . Megjithatë ka disa shkresa të DAR Qark në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, mbi mënyrën se si duhet vepruar me këtë kontingjent tekstesh, nuk ka një përgjigje shteruese nga kjo ministri.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Si gjetje u konstatua:

Krijimi i një nomenklature të tillë të librit shkollor stok 31,427 copë librash shkollor për v.2015 jashtë katalogut me vlerë 3,455,707 lekë vetëm DAR Qark, (por kjo situatë rezulton dhe në DAR Qytet ku stoku i librit në v.2015 është me vlerë 4,453,819 lekë, gjë që do të thotë se vetëm dy DAR e qytetit dhe qarkut arrin vlerën 7,9 milionë lekë), tregon për një proces të pa studiuar dhe për një shpenzim jo efektiv të fondeve të buxhetit për periudhat kur ata janë prodhuar.

Megjithëse kanë kaluar rreth 15 vite që janë furnizuar me këto tekste, pas ndryshimit të strukturave dhe programeve mësimore MASH nuk ka lëshuar udhëzim të posaçëm se si duhet vepruar për këto raste.

Nga ana e DARQT për këtë çështje në observacionet e dërguara me shkresën nr. 372 prot, datë 29.02.2018, “Dërgohen sqarimet për projektraportin e dërguar nga KLSH”, (prot në KLSH me nr 1307/4, datë 28.02.2018) ka bërë komente dhe shpjegime si më poshtë:

*“Faqe 41 për librin jashtë katalogut (stok) **problemi qëndron**, me rekomandimet që do të jepni ju dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë do të marrim masat e nevojshme. Për këtë problem me shkresën nr. nr. 328 prot., datë 12.02.2018 i jemi drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për të na ofruar ndihmen për gjendjen e librit stok për të cilin nuk kemi marrë akoma përgjigje.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë sekërkohet koordinim i veprimeve me MASR për analizimin e kësaj situatë, nxjerrjen e përgjegjësive dhe kryerjen e veprimeve të duhura për të përfutur nga këto vlera të inventareve.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar me objeksionet, ky koment i institucionit arsimor nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

iii. RAKORDIMET E PASQYRAVE TË BILANCIT FINANCIAR:

Auditimi u bë me të zgjedhur për këto llogari, formate e pasqyra financiare:

- -Auditimi për **barazimin e vlerës totale** të Pasivit me Aktivin:
 - Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve** të bilancit kontabël (formatet 1 dhe 2), në shumën 106,648,390 lekë në v.2015 dhe 103,031,702 lekë për v.2016;
 - Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 6 “**Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara**” për vlerën e tyre bruto (kolona 19), është e barabartë me 28,401,343 lekë, shumë e pasqyruar në formatin nr. 1 të Bilancit në zërin “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara” (me të njëjtat vlera, që po ti zbresësh amortizimin 17,768,055 lekë, jep vlerën neto të AQT prej 10,633,288 lekë për v.2016, duke rakorduar me totalin e klasës së II-të..

- Auditimi në aktivin dhe pasivin e bilancit për këto formate dhe llogari:
 1. Totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 3/1 e 3/2), në shumën 1,096,283,520 lekë;
 2. **Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë nga funksioni” në Formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” është e barabartë me llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit” në Pasivin e bilancit kontabël. Rezultati është zero, pasi është institucion buxhetor.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

3. **Llogaria 63** “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin nr. 3/1, për 584, 272 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 “Gjendja e inventarit” (kolona nr.28) në aktivin e bilancit. *Pra*, janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 584, 272 lekë.
4. **Llogaria 841** “Transferimi i ndryshimit të gjendjes” në Formatin nr. 3/2 “Të ardhura të ushtrimit”, rezulton e barabartë sa llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Formatin nr. 3/1 për 584, 272 lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

5. Auditimi i barazisë në vlera të **Formatit nr. 3/2 me Formatin nr. 3/1**, si:
Formati nr. 3/2 është i barabartë me Formatin nr. 3/1 nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 1,220,959,023 lekë në v.2015 dhe 1,096,283,520 lekë për v.2016.

Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

6. Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 4** “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet”:

Llogaria 230 “Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara” dhe llogaria 231 “Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuara” (në Formatin nr. 4) janë zero, po aq sa është dhe pasqyrimi i gjendjes në llogari në kolonat 20 dhe 21 në aktiv të bilancit, (barazi me vlerën zero).

Llogaria 232 “Shpenzime për transferimet kapitale” në Formatin nr. 4 rakordon me llogarinë 232 në aktivin e bilancit, barazi me vlerën zero, pasi nuk ka asnjë ndryshim në këto zëra të aktiveve.

Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

7. Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 5**, “Pasqyra e lëvizjes (CASH)” :

- Rubrika “Teprica në mbyllje të ushtrimit” tek Formatin nr. 5 është e njëjtë me tepricën e llogarive 512 “Llogari në bankë” dhe llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” në aktiv të bilancit kontabël, barazi me zero.
- Lëvizjet e pasqyruara në formatin nr.5, “Pasqyra e lëvizjet në “Cash””, rakordojnë me **situacionin faktik të pagesave dhe arkëtimeve**, të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë, si vijon:

- **Debia e disponibiliteteve te thesarit** në pasqyrën e lëvizjes së cash-it është 1,104,646,555 lekë, vlefte kjo e njëjtë me shumën e hedhur në evidencën e rakordimit (situacioni vjetor i shpenzimeve) të DAR me Degën e Thesarit Tiranë, që si plan vjetor shpenzimesh për v.2016 ka të njëjtën shumë.
- Kolona “**Shpenzimet e thesarit**” (**situacioni vjetor i shpenzimeve**) të DAR me Degën e Thesarit Tiranë, pasqyrohet për 1,096,887,068 lekë, po aq sa janë dhe krediti i “Disponibiliteteve në thesar” tek Pasqyra e lëvizjes së Cash-it (formati nr.4) dhe nuk u konstatua ndonjë mospërputhje.

8. U audituan të dhënat mbi vlerat bruto të aktiveve, sa pasqyruar në aktiv të bilancit (formati nr.1) dhe gjendjen e ndryshimit e AQT në vlerën bruto, (formati nr.6), sipas periudhave dhe nuk rezultoi ndonjë parregullsi.

	AQT (kolona nr.9 + amortizimi i akumuluar nga kolona 19).	Gjendja në fund të vitit e AQT, për vlerën e tyre bruto
--	---	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	-sipas Formularit nr.1 të Pasqyrave Financiare Vjetore-	-sipas Formularit nr. 6 të Pasqyrave Financiare Vjetore -
Viti 2015	12,477,884 + 16,473,281	
	28,951,165	28,951,165
Viti 2016	10,633,288 +17,468,055	
	28,401,343	28,401,343

Auditimi i llogaritjes së amortizimit:

“Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” (llog. nr. 219) prej **17,768,055 lekë për v.2016** është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9. “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” për **17,768,055 lekë** për v.2016 dhe **16,473,281 lekë** për v.2015; Amortizimi është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 “Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit”, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji aktual “Për tatimin mbi të ardhurat” ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur. Normat janë:

- 15 % për studime dhe kërkime;
- 1.3 % për ndërtesat dhe konstruksionet;
- 3% për inventarin ekonomik;
- 25% për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike;
- 5.8% për makineritë e pajisjet operationale, instrumente e vegla; dhe
- 13.8% për mjetet e transportit.

Bazuar në kreun II, të UMF nr. 14, datë 18.12.20016 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre, si dhe njësitë e menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, u kryen disa testime të artikujve të aktiveve të qendrueshme të trupëzuara, mbi aplikimin e rregullt të amortizimit vjetor. Nga testimi i kryer, nga grupi i auditimit rezulton se shumatat e llogaritura janë referuar sipas normave të miratuara. Më konkretisht, të dhënat paraqiten si vijon:

Tabela nr.2
Në lekë

Viti 2015

nr	emertimi	Vlera AQT 31.12.2015	Norma amortizimit	Totali i amortizimit
1	Ndertesa	19,721,850	0.01	197,219
2	Mjete transporti	2,400,000	0.13	312,000
3	Inventar ekonomik	3,007,540	0.03	90,226
4	Mjete kompjuterike	3,494,927	0.25	873,732
	Totali	28,624,317		1,473,176

Viti 2016



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Nr	Emertimi	Shuma 31.12.2016	Norma e amortizimit	Totali i amortizimit
1	Ndertesa	19,721,850	0.01	197,219
2	mjete transporti	2,400,000	0.13	312,000
3	Inventar ekonomik	2,966,692	0.03	89,001
4	mjete kompjuterike	3,312,801	0.25	828,200
	Shuma 1	28,401,343		1,426,420
	Paksimet			
	Inventar ekonomik	26,400	0.03	792
	mjete kompjuterike	35,727	0.25	8,932
	mjete kompjuterike	487,695	0.25	121,924
	Shuma e paksimeve			9,724
	Totali (sh1-pakësimet)=			131647.5

Konstatim:

Nga ana e Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme janë kryer llogaritjet e amortizimit, për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, objekti Zyrat e Qendrës Ekonomike e Magazina, në vlerën vjetore prej 197,219 lekë për v.2015 dhe për v.2016 lekë, objekte që efektivisht nuk ekzistojnë për periudhën objekt auditimi, dhe për rrjedhojë këto regjistrime denatyrojnë treguesit e shpenzimeve në bilancin kontabël të këtij institucioni.

Edhe shuma tjetër e amortizimit, për pjesën e rikontruksionit të kryer sipas një fondi të akorduar nga MAS, llogaritet për një objekt i cili nuk është në pronësi të DAR, sepse objektet shkollorë janë në administrim të pushtetit vendor.

- Në formatin nr. 9 për numrin e punonjësve dhe fondin e pagave janë të pasqyruara të gjitha lëvizjet në lidhje me rekrutimin e punonjësve si dhe fondi i pagave, shpërblime të tjera dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të cilat janë të barabarta me pasqyrën 3/1 me zërin paga e shpërblime të tjera personeli, me kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Kontributi për sigurimet shoqërore e shëndetësore për v.2016 është 151,092,98ë leke dhe rakordon në dy formatet.
- Auditimi në Formatin nr. 3/1 të llogarisë 606 “**Transferta për buxhete familjare e individë**” me rakordimin e shpenzimeve me Degën e Thesarit Tiranë. Në këtë llogari janë mbajtur vlerat e transferuara nga MF dhe ministria e linjës (MAS) për përdorimin për shpërblime të punonjësve gjatë momenteve që dalin në pension; punonjësve me sëmundje të rënda dhe të gjata, subvencionet e librave për nxënësit rom si dhe për nxënësit që kanë prindërit me ndihmë ekonomike dhe me sëmundje të rënda e të gjata.

Kjo llogari sipas rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë për v.2016 paraqet vlerën prej 16,446,477 lekë, kurse tek formati përkatës nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit”, kjo llogari është pasqyruar për të njëjtën vlerë dhe kaluar tek klasa 6, llog 603 “Subvencionet” (kolona 22 e Formatit 3/1 të bilancit), në vend që të pasqyrohej tek kolona nr. 38, llogaria 606 “transferime për buxhetet familjare e individuale”.

Sjellim në vëmendje se, në bazë të përcaktimeve të Manualit të klasifikimit buxhetor për shpenzimet të MF, (pjesa e klasifikimit Ekonomik), “Subvencionet konsiderohet si një mbështetje e Qeverisë për subjektet prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia e ndërmarrjes (publike ose private) dhe pavarësisht se përfituesi i përket një korporate, një sektori brenda ndërmarrjes, ose individit të angazhuar në aktivitete biznesi. Subvencionet janë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

pagesa vetëm për prodhuesit dhe jo për konsumatorin final. Subvencionet që institucionet qeveritare japin për ndërmarrjet bazohen në nivelin e tyre prodhues ose në vlerën e materialeve dhe shërbimeve që ato prodhojnë, shesin apo importojnë.

*Në subvencione **nuk përfshihen:***

- *pagesat që institucionet qeveritare bëjnë direkt për konsumatorët ose institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë konsumatorëve p.sh. mbështetje me grant për artistet, bursat për studentët, pagesat për familjet nevojtare, etj, të cilat trajtohen si transferta*
- *pagesat për ndërmarrjet për të financuar formimet e tyre kapitale ose për kompensuar ato për humbjen e aktiveve jo-financiare;*
- *transferrat e bera për institucione e tjera të qeverisë (transferta në nivele të tjera të qeverisë), të cilat konsiderohen grante.*

Subvencioni nuk terhiqet direkt nga përfituesi, por i transferohet përfituesit nga institucioni qeveritar që e jep atë, nepermjet dokumenteve të plotësuar dhe të paraqitura në Thesar”.

iv. Dokumentacioni mbështetës i veprimeve dhe transaksioneve financiare:

U audituan me zgjedhje tre katërmujorë në lidhje me dokumentacionin e bankës për periudhën nga 01.09.2015 deri më 31.12.2017. Urdhër shpenzimet janë shoqëruar me dokumentacionin justifikues, janë të kontabilizuara në ditarin e bankës dhe ekstrakti i bankës rakordon me situacionet mujore të rakorduara nga dega e thesarit. Në ditarin e bankës të çdo muaji ishin kryer artikujt kontabel të mbylljes ku ishin prerë fletë kontabilizimit e brendshme për pagesat e bankës, konformë ligjit mbi kontabilitetin.

U auditua likuidimi nga banka i detyrimeve DAR Qarku Tiranë ndaj [REDAKTUAR] nga ku rezultoi se këto pagesa kishin bashkangjitur faturën përkatëse për likuidimet e kryera por faturat e telekomit dhe abonimeve, por duhet të nënshkruhen nga një punonjës i caktuar duke kryer kështu dhe rakordimet për shumën e faturuar.

Dokumentacioni është regjistruar në mënyrë kronologjike. Mbajtja e regjistrimeve kronologjike është kryer nëpërmjet ditarëve të arkës, bankës, ditari i magazinës së mjeteve kryesore, i të ardhurave dhe i veprimeve të ndryshme. Është bërë r akordimi i vazhdueshëm me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet. Ditaret ishin regjistruar në centralizator ku dhe kanë rezultuar shifrat që janë hedhur në bilance.

Konstatime:

Llogaria 212 “Ndërtim dhe konstruksione” në Aktivët e Qëndrueshme të Trupëzuara (aktivi i bilancit) ka të regjistruar vlerën 19,721,850 lekë, e cila paraqet vlerën e ndërtesave të ish-subjektit “Qendra Ekonomike dhe garazh” me vlerë 12,064,250, (objekte që efektivisht nuk ekzistojnë për periudhën objekt auditimi dhe për rrjedhojë këto regjistrime denatyrojnë treguesit e vërtetësisë së të dhënave të bilancit kontabël të këtij institucioni) si dhe vlera 7,667,600 lekë që është rikonstruksioni i zyrave që DAR ka në përdorim që në vitin 2006.

Nga ana e DARQT për këtë çështje në observacionet e dërguara me shkresën nr. 372 prot, datë 29.02.2018 , “Dërgohen sqarimet për projektraportin e dërguar nga KLSH”, (prot në KLSH me nr 1307/4, datë 28.02.2018) ka bërë komente dhe shpjegime si më poshtë:

*“Për godinën (Objekti ish Zyrat Ekonomike e Magazina) **problemi qëndron**, me rekomandimet që do të jepni ju dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Rinisë do të marrim masat e nevojshme, mbështetur në rekomandimet, do të bëjmë sistemimet e nevojshme për të konsoliduar bilancin financiar. Me shkresën nr. 328 prot., datë 12.02.2018 i jemi drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për të na ofruar ndihmen e tyre në sistemim e aktiveve të qëndrueshme (Objekti ish Zyrat Ekonomike e Magazina) për të cilin nuk kemi marrë akoma përgjigje.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar me objeksionet, ky koment i institucionit arsimor nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

Në kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të DAR Qarku Tiranë , në llogarinë 212 “Ndërtime e rikonstruksione”, e cila ka dy nënlllogari që evidentojnë përkatësisht:

- I. Vlera e godinës së ish Qendrës Ekonomike dhe magazine e saj, e vendosur në rrugën “M.Shyri”, me vlerë 19,721,850 lekë, vlerë që nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga viti 2012 si dhe,
- II. Vlera e shpenzuar nga fondet e MAS në vitin 2006 për rikonstruksionin dhe përshtatjen e mjediseve aktuale të zyrave që ka DAR në përdorim, prej 7,667,000 lekë, objekt ky i shkollës “██████ Tiranë.

Nga shqyrtimi i praktikave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH rezulton kjo situatë, si më poshtë vijon:

- I. Me shkresën nr. 2967 prot, datë **14.04.2015**, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ██████ me objekt “ Plotësim dokumentacioni për pasqyrat financiare të v.2014”, nënvizon se ***në aktiv të bilancit në llogarinë 212 keni vendosur vlerën kontabile të ndërtesës, e cila nuk është e shoqëruar me certifikatë pronësie***. Në këtë shkresë kërkohet vërtetimi i lëshuar nga zyra e hipotekës për asetet në pronësi të institucionit.
- II. Drejtori i DAR Qark znj. ██████ me shkresën nr. 878 prot, datë **15.4.2015** i ka kthyer përgjigje Drejtorisë së Shërbimeve Juridike në MAS, ku shprehet ndër të tjera se, ***“vlera e vendosur në kontabilitet në shumën 12,064,250 lekë i përket zyrave të ish qendrës ekonomike dhe magazinës pranë rrugës “Myslim Shyri”, të cilat janë lënë nga ana jonë në process privatizimi”***. Edhe në shkresën e datës 16.4.2015 për ZRPP Tiranë, drejtori i DAR Qark ██████ shprehet se, ***“Në bazë të shkresave të lëshuara ky objekt është lëshuar për procedurë privatizimi që nga viti 2007. Nuk kemi asnjë lloj dokumentacioni se çfarë është bërë me këtë objekt”***.
- III. Për vlerën e ndërtesave të ish Qendra Ekonomike DAR Qarku Tiranë I ka dërguar shkresë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me nr 869/1 ,Prot datë 16.04.2015 ku kjo e fundit ka dërguar shkresë me nr 13347/1, datë 13.05.2015 ku kërkon një fragment nga harta ku të përcaktohet pozicioni i kësaj pasurie. DAR Qarkut Tiranë i ka ridërguar një shkresë po Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me nr. 1408, Prot datë 20.05.2015 ku janë dërguar materiale si më poshtë:
 - Zyrë teknike dhe projekte
 - Magazinë
 - Magazinë
 - Zyrë specialistësh,
 - Zyrë specialistësh

ku është cituar se këto objekte nuk ekzistojnë më por janë kthyer në shesh ndërtimi dhe po ndërtohet një pallat. Përgjigje nuk është kthyer.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Me gjithë korrespondencën zyrtare të sipër cituar ky objekt vazhdon të jetë në kontabilitetin e DAR Qarku Tiranë megjithëse nuk është në përdorim të saj.

- IV. ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. 13347/1 prot, datë **13.5.2015** në vijim të interesimit të DAR për ndërtesat e referuar më lartë, i ka kërkuar kësaj të fundit një informacion dhe fragmentin e hartës ku pozicionohet kjo pasuri. Këtë informacion DAR ia ka nisur së bashku me shënimin se ***”pozicioni i këtyre objekteve njëkatëshe,... sipas zonës së përcaktuar në hartë, si më poshtë: Zyra teknike dhe e projekteve, magazinë, magazinë, zyrë specialistësh, zyraë specialistësh”.*** Këto objekte sot nuk janë më, është shesh, ku një pjesë është marrë kur është ndërtuar një pallat i ri i veshur me tulla të kuqe”.
- V. Kjo gjendje i është prezantuar Drejtorisë së Financës së MAS dhe me shkresën nr. 986 prot, datë **30.4.2015**, “Dërgim informacioni mbi objektet që janë për privatizim”, ku në pikën nr.1 evidentohet vlera e objektit ndërtesë në ish-Qendra Ekonomike, “ për të cilën nuk kemi të dhëna hipotekore dhe që janë lënë që në vitin 2006 nga ana jonë. Është bërë kërkesë për hipotekim që në vitin 2006”.
- VI. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme me shkresën nr. 13347/5 prot, datë **02.06.2015** u ka kthyer përgjigje MAS dhe DAR-it Qark Tiranë, (në përgjigje të letrës nr. 1408, datë 26.5.2015), përmes së cilës kërkohej informacion mbi ndërtesën e ish “Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Magazina”. Regjistruerja e ZVRPP [REDAKTUAR] duke vlerësuar fragmentin e hartës së vijëzuar bashkëlidhur praktikës, shpreh se:
- pasuria me nr. 6/347, vol.28, faqe 245 , truall me sipërfaqe 945 m2, është në pronësi të 17 bashkëpronarëve [REDAKTUAR] etj. Në seksionin “D” ka shënimin ***“Mbi këtë truall është privatizuar objekti nr. 6/396 vol.33, fq 14. (ish magazinat e shkollës) dhe në skesionin “E” vihet kufizimi “pasuria vihet në favour të shoqërisë “[REDAKTUAR] k për ndërtimin e një godine shumë katëshe”.***
 - pasuria me nr. 6/105, vol.15, faqe 30, ZK 8380, truall me sipërfaqe 1727 m2, është e afishuar në bashkëpronësi të 12 bashkëpronarëve [REDAKTUAR] etj. Në seksionin “E” ka shënimin ***“Ndërtim pa leje (pallat i ri)”.***
- VII. Nëpërmjet shkresës nr.1534 prot, datë **10.06.2015**, kjo drejtori i pergjigjet Drejtorisë së Financës së MAS dhe përfundon me shprehjen ***“kërkojmë nga ana juaj konfirmimin zyrtar për heqjen e kësaj vlere nga aktivi i bilancit”.***
- VIII. Pas insistimit të grupit ta auditimit mbi origjinien dhe destinacionin e kësaj prone, na u vunë në dispozicion dhe këto praktika zyrtare:
- Shkresa nr. 2529/1 prot, datë **16.4.2007** nënshkruar nga ish-Drejtori DAR Qark [REDAKTUAR] për Drejtorinë Ekonoimike të MASH me lëndë “Prononcim për privatizim”, nder të tjera nënvizon se, “ju informojmë se objekti Magazinat e DAR të Qarkut Tiranë janë jashtë funksionit dhe nga ana jonë nuk përdoren. Për sa sipër, ju vejmë në dispozicion ambinetet e magazinës dhe zyrave ekonomike të DAR për privatizim sipas ligjit”. Ky dokument është shoqëruar me nje relacion teknik rreth gjendjes së këtij objekti, në rrugën “Myslim Shyri”, (nënshkruar nga ing.[REDAKTUAR]), ku theksohet se gjendja e objektit është shumë e dëmtuar dhe mjaft e amortizuar ndër vite. Këto objekte ***“aktualisht janë jashtë përdorimit dhe nuk mund të përdoren, pasi paraqesin rrezikshmëri dhe kushte të papërshtatshme për ty shfrytëzuar”.***
 - Shkresa nr. 294/1 prot, datë **16.2.2010** nënshkruar nga ish-Sekreati i Përgjithshëm i MASH [REDAKTUAR], me lëndë “Kërkesë për dhënie informacioni”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

për DAR Tiranë, ku thuhet se “METE i ka kërkuar MASH prononcimin për arësye privatizimit të objektit në të cilin është ndërtuar administrata e shkollës (ish-magazinë) sipas planvendosjes në praktikën bashkëlidhur, në lidhje me varësinë administrative të këtij objekti”, duke i kërkuar informacion nëse ky objekt është nën varësinë e tyre administrative. Bashkëlidhur asaj shkresë është dërguar dhe shkresa që ish-Ministri i METE i drejtonte ish-Ministrit të MASH z. [REDAKTUAR] dhe për dijeni z. [REDAKTUAR], ku nënvizohet se:

“trashëgimtarët e familjes [REDAKTUAR] kërkojnë privatizimin me të drejtën e parablerjes së këtij objekti, ndaj kërkohet pronocimi për përfshirjen e këtij objekti në procesin e privatizimit. Nëse institucioni juaj shprehet dakord për privatizimin e objektit të mësipërm të dërgoni emrin dhe numrin e kontaktit”.

Kjo praktikë ka bashkëlidhur Vendimin e Komisionit të kthimit dhe Kompensimit të pronave të Rajonit nr.2 Tiranë, me nr. 350, datë 23.11.1995, në të cilin përfshihet dhe “trualli i zënë nga magazina që shërben për kopështet e cerdhet me sipërfaqe 175 m²”

IX. Me shkresën nr. 5860 prot, datë **07.06.2016**, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, z. [REDAKTUAR] me objekt “ Plotësim dokumnetacioni për pasqyrat financiare të v.2015”, nënvizon të njëtin konstatim si në vitin 2015 se ***në aktiv të bilancit në llogarinë 212 keni vendosur vlerën kontabile të ndërtesës, e cila nuk është e shoqëruar me certifikatë pronësie.*** Në këtë shkresë kërkohet vërtetimi i lëshuar nga zyra e hipotekës për asetet në pronësi të institucionit.

X. Shkresa nr.2510 prot, datë **10.11.2017**, DAR informon Drejtorinë e Financës së Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) në lidhje me statusin e objektit të DARQ Tiranë, ku evidentohet fakti se ky institucion e zhvillon veprimtarinë në ambientet e shkollës speciale [REDAKTUAR]G”.

XI. Me shkresën nr.69 prot, datë **10.01.2018**, Drejtori i DARQT znj. [REDAKTUAR]M. i është drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP) me kërkesën për vendimet e komisionit të kthimit të pronave. Ndër të tjera, në këtë shkresë thuhet se :

“Për heqjen e vlerës së objektit ish-Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Magazina e saj nga aktivi i bilancit, kemi një shkresë nga ZVRPP-ja nr. 13347/3, datë 02.06.2015, ku jepet se këto objekte prekin disa pasuri”... Në kthimin e përgjigjes, drejtori i Agjencisë së Trajtimit të Pronës, znj. [REDAKTUAR] ka dërguar bashkëlidhur shkresës nr. 330/1 prot, datë 18.01.2018 “Kthim përgjigje”, një informacion me 176 fletë, për të cilat duhen kryer vlerësimet dhe trajtimet e nevojshme përfundimtare.

Konstatim:

Në vitin 2006 kur ky në institucion është transferuar dhe vendosur në mjediset e shkollës speciale „Luigj Gurakuqi“, vlera e rikonstruksionit është kontabilizuar si Aktiv i Qëndrushëm i Trupëzuar, në llogarinë 219 „Ndërtesa“.

Ky veprim kontabilizimi nuk është i drejtë sepse, në fakt ky objekt nuk është në pronësi të DAR Qark, por në bazë të përcaktimeve të pikave 2/b dhe c të Aneksit nr. 1, që shoqëron VKM nr. 204, datë 26.03.21998 „Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit vendor“, i ndryshuar, pushteti lokal është kompetent, administron dhe përgjigjet për objektet arsimore.

U audituan veprimet e mbylljes së bilancit për vitin **2015 e 2016** dhe në përgjithësi është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

pasyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe plotësimi i tij është bërë në **mënyrë manuale**, në programin excel, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse. Veprimet janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, i ndryshuar.

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për 6 mujorin e parë 2016 dhe 6 mujori i dytë i vitit 2017. Fletë dalje dhe fletë hyrjet e aktiveve janë **të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime**. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i cmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Çdo fletë dalje është e pajisur me urdhër dorëzimi ose me **plan shpërndarje** përkatëse, të nënshkruar nga nëpunësi zbatues. Kontabilizimet e fletë daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga një specialiste e Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste tjetër e këtij sektori. Theksojmë se **autorizimet për tërheqje malli** janë bërë në emër të magazinieres, në një kohë që duhet bërë në emër të përfituesit, pra kush do ta nënshkruaj fletë daljen si marrës malli atëherë për atë duhet plotësuar edhe autorizimi përkatës.

U konstatuan (1) një rast, ku fletëdalja e magazinës nr.05 dtë 09.10.2017, në vlerën 994,2 lekë, për llogari të **shkollës 9-vjecare Ahmetaq** dhe që ka si terheqës të [REDAKTUAR] nuk rezulton të jetë nënshkruar nga marrësi i mallit si dhe tre kopjet e fletëdaljes janë bashklidhur. Në këtë fletëdalje janë evidentuar artikujt rregjistra shkolle klasa 1, klasa 3, unik, klasa 6 etj.

Për periudhën e kohës objekt auditimi, njësia shpenzuese (DARQT) ka kryer rregullisht regjistrimin dhe dokumentimin e veprimeve kontabile në **ditarin e bankës**, dhe ka transferur shumat e ditarëve në pasqyrat e bilancit të vitit 2015 dhe 2016. Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konformë rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Dokumentacioni është kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe sistematike në ditarin e bankës. Konfermat e bankës janë kuadruar për çdo muaj dhe janë nënshkruar e vulosur nga Dega e Thesarit Tiranë.

i) Gjatë vitit 2016, njësia shpenzuese (DARQT) ka plotësuar urdhër shpenzimi me vlerën **971,074** lekë, duke i xhiruar nëpërmjet bankës, për llogari të kompanisë “[REDAKTUAR]”, shumën **119,606** lekë për operatorin [REDAKTUAR] (sipas një vendimi gjyqësor), shumën **7,665** lekë për operatorin Plus për v.2016 (si dhe shuma 203,886 lekë për v.2015), për sa ndaluar më parë nga pagat e punonjësve DARQT, Arsimit Bazë dhe Arsimit të Mesëm, shpenzime për sa përdorur për biseda telefonike nëpërmjet numrave celularëve të kontraktuar me këto operatorë.

Duke e parë në kompleks këto veprime të kryera nga buxheti i shtetit, kjo njësi shpenzuese harxhohen kohë dhe shpenzime, si urdhër shpenzime, fuqi punonjëse dhe kontabilizim të tyre private në dokumentet shtetërore, pra si përfundim ka një kosto më vete, që duhet përballuar nga buxheti i shtetit, pa përmendur punën shtesë të punonjësve të sektorit të financës si dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

për shtesat e vështirësive që mund ti krijohen në rakordimet me këtë kompani për këto veprime private. Cilësojmë se fillimisht ka pasur kontratë mes kompanive përkatëse dhe DARQT me një afat njëvjeçar, ku ky afat ka përfunduar. Përdorimi celularëve dhe përballimi i shpenzimeve për kompanitë e ndryshme, janë veprime private e personale dhe duhet të ndiqen nga çdo person më vete direkt duke bërë pagesat përkatëse, përse është rënë dakord.

ii) Gjatë vitit 2016, DARQT nëpërmjet urdhër shpenzimeve, ka kryer transaksione në shumën **953,900 lekë**, për llogari të [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për kuotat përkatëse të ndaluar në pagat e punonjësve dhe mësuesve të shkollave. Këto ndalesa janë kryer nga paga e punonjësve, bazuar në pikën 13.15 të kontratës kolektive dhe deklarimin e tyre me shkrim për zbritje nga paga për kuota sindikale.

Ndalesat dhe xhirimi ka si mbështetje Kontratën Kolektive të Punës (nr. 10389 prot, datë 16/12/2015), të nënshkruar me datën 16 dhjetor 2015 mes [REDAKTUAR] dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës [REDAKTUAR].

Në këtë rast, DARQT dhe sektori përkatës që mbulon çështjet e financës, janë bazuar në nenin 117/2 të Kodit të Punës, zbresin nga listëpagesat e mësuesve kuotizacionin sindikal dhe e xhirojnë në llogaritë e [REDAKTUAR] në masën një apo disa mujore, sipas kërkesës me shkrim të secilës sindikate qendrore.

Duke i parë në kompleks këto veprime të kryera nga DAR, kjo njësi shpenzuese bën *shpenzime shtesë, si urdhër shpenzime, fuqi punonjëse dhe kontabilizim të tyre (privatisht) në dokumentet shtetërore, pra si përfundim ka një kosto më vete, që duhet përballuar nga buxheti i shtetit, pa përmendur këtu punën e mundimshme shtesë të punonjësve të sektorit të financës si dhe për shtesat e vështirësive, që mund ti krijohen në rakordimet me bankën dhe sindikatat për këto veprime që bëhen për llogari të të tretëve.*

Pagesat e kuotizacioneve sindikale në fund të fundit janë veprime personale dhe duhet të ndiqen nga çdo person vetë direkt nëpërmjet sindikatave, në një kohë që këto punonjës dhe arsimtar janë në të kundërt janë të detyruar të paguajnë për llogari të buxhetit të DARQT edhe një shpenzim plotësues për kryerjet e këtyre veprimeve.

Sipas nenit 117, pika 2 të Kodit të Punës “... mund të zbresë nga paga kuotizacionet sindikale” duke cilësuar se edhe mund të shfuqizohet në çdo kohë.

iii) U konstatua parregullsi se, gjatë periudhës objekt auditimi janë kryer pagesa për riparim automjeti në vitin 2015 dhe në vitin 2016, pa u shoqëruar me dokumentacion të nënshkruar rregullisht, që të konfirmojë kryerjen e shërbimit.

Sa sipër është vepruar në kundërshtim me paragrafin nr. 36, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30/ 2011, ku përcaktohet se:

*“Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një **prove ligjore ose administrative**”.*

v. INVENTARIZIMI I PRONËS SHTETËRORE:

Inventarizimi i v.2015:

Në janar të vitit 2016 kanë dalë tre urdhëra të Drejtorit të DAR Qark, [REDAKTUAR], të lidhura me procesin e inventarizimit dhe administrimit të aktiveve të DAR, si vijon:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

me urdhërin nr. 2, nr. 13/1 prot, datë 05.01.2016, është ngritur Komisioni i inventarizimit të materialeve në magazinë” i përbërë nga [REDAKTUAR]
me urdhërin nr.3, nr.13/2 prot, datë 05.01.2016, është ngritur Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve në magazinë”, i përbërë nga [REDAKTUAR]
me urdhërin nr. 4, nr.13/3 prot, datë 05.01.2016, është ngritur Komisioni për asgjesimin e materialeve të magazinës së Drejtorisë Rajonale”, i përbërë nga [REDAKTUAR]

Të tre këto urdhëra mbajnë si referencë ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 “Për ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” dhe VKM nr.70, datë 11.3.1985.

Nga komisioni i inventarizimit janë nënshkruar rregullisht inventaret e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike të mallrave e materialeve dhe ato kontabile.

Me datën 08.01.2016 është hartuar procesverbali për nxjerrjen jashtë përdorimit në shumën 929,253 leke, e ndarë në materiale (librit st ok) në vlerën 312,477 lekë si dhe të inventarit ekonomik për 316,776 lekë. Procesverbali është nënshkruar nga komisioni [REDAKTUAR], dhe nuk është nënshkruar nga anëtari [REDAKTUAR]. Ky procesverbal është konfirmuar dhe nga Përgj.Sekt. Shërb. Përgjithshme [REDAKTUAR] dhe Drejtori [REDAKTUAR]

Procesverbali i asgjesimit të artikujve më sipër, është mbatjur në të njëjtën datë me atë të nxjerrjes nga përdorimi, me 8.1.2016, për 929,253 leke, dhe është nënshkruar nga [REDAKTUAR], por nuk është nënshkruar nga Kryetari [REDAKTUAR]. Ky procesverbal është konfirmuar dhe nga Përgj.Sekt. Shërb.Përgjithshme [REDAKTUAR] dhe Drejtori [REDAKTUAR]

Inventarizimi i v.2016:

Në dhjetor të vitit 2016 kanë dalë tre urdhëra të Drejtorit të DAR Qark znj. [REDAKTUAR], të lidhura me administrimin e aktiveve të DAR, si vijon:

me nr.3, nr.2866 prot, datë 28.12.2016, është ngritur Komisioni i inventarizimit të materialeve në magazinën e DAR”, i përbërë nga [REDAKTUAR]
me nr.2, nr. 2866 prot, datë 28.12.2016, është ngritur Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve në magazinë”, i përbërë nga [REDAKTUAR]
me nr. 13/3 prot, datë 05.01.2016, është ngritur Komisioni për asgjesimin e materialeve të magazinës së Drejtorisë Rajonale”, i përbërë nga [REDAKTUAR]

Të tre këto urdhëra mbajnë si referencës ligjore ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 “Për ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” dhe VKM nr.70, datë 11.3.1985.

Nga komisioni i inventarizimit i v.2016 janë nënshkruar rregullisht inventaret e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike të mallrave e materialeve dhe ato kontabile.

Me datën 08.01.2017 është hartuar procesverbali për nxjerrjen jashtë përdorimit në shumën 998,136 lekë, e ndarë në materiale (dëftesa shkollore, libri shkollor dhe fletore pune) në vlerën 466,273 lekë si dhe të inventarit ekonomik (flesh,laptop, karrike etj) për 531,863 lekë. Procesverbali është nënshkruar nga komisioni [REDAKTUAR], dhe nuk është nënshkruar nga anëtari S. [REDAKTUAR] Ky procesverbal është konfirmuar dhe nga Përgj.Sekt. Shërb.Përgjithshme [REDAKTUAR] dhe Drejtori [REDAKTUAR]



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Procesverbali i asgjësimit të artikujve më sipër, është mbajtur në të njëjtën datë me atë të nxjerrjes nga përdorimi, me 08.1.2017, për 998,136 leke, dhe është nënshkruar nga A. [REDAKTUAR], por nuk është nënshkruar nga Kryetari [REDAKTUAR]. Materialet e nxjerrja nga përdorimi, sipas inventarit i janë nënshtruar procesit të shtypjes, copëtimit dhe deformimit të gjendjes fillestare, duke i kthyer në mbeturinë. Ky procesverbal është konfirmuar nga Përgj.Sekt. Shërb. Përgjithshme [REDAKTUAR] dhe Drejtori [REDAKTUAR].

Konstatime:

1. Referencat e vëna në këto urdhëra administrative mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi, janë dispozita të shfuqizuara, përkatësisht me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. Ky aspekt tregon se nuk zbatohen sic duhet dispozitat e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.
2. Të dy PV janë nënshkruar dhe nga Drejtori DAR dhe përgjegjesi i sektorit shërbimeve të brendshme, që nuk janë pjesë e këtyre komisioneve.
3. Dokumentacioni i magazinës, në kushtet e mungesës në strukturë të këtij pozicioni) i është ngarkuar ekonomistes së pagave dhe mbahet në rregull. Fletëhyrjet dhe fletëdaljet ndjekin kronologjinë e numrit dhe të dates. Në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit lëvizja e aktiveve nuk është shoqëruar me dokumentacion të rregullt. Kështu, nuk janë prerë fletëdalje për mallrat dhe materialet e dala jashtë përdorimit, (pasi rikujt e inventarit shkarkohen menjëherë sapo u kalojnë përdorusve), duke shkelur kërkesat e pikës 34, të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik*”, që përcakton se, “*Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi*”. Mungon procesi i rakordimit periodik për magazinën dhe mbajtja e librit të magazinës është zëvendësuar me ditarin e kontabilizimit.
4. Procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit për dalje jashtë përdorimit, si dhe asgjësimi janë kryer dy herë rradhazi nga i njëjti komision, veprime këto në kundërshtim me paragrafin nr. 84, të UMF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, që shpreh se, “*Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me rradhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision*”.
5. Inventarizimi ka përfshirë vetëm gjendjen e aktiveve në magazinë dhe inventarin e zyrave dhe jo gjendjen e AQT “Ndërtesa”, në kundërshtim me paragrafin nr. 74 të UMF nr 30/ 2011 që përcakton se, “*Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës*”.
6. Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2015 dhe 2016 **nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë**, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e DAR-it, për vitin 2016, në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

inventarizimit, t'ia dorëzoje për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues”. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, spo mallrave e materialeve.

7. Procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, sic përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr.30, që përcakton se *“ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përftimi bëhet vlerësimi i aktivevevafatgjata dhe aftashkurtëra materiale”*, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast.
8. Nuk ka gjetur zbatim paragrafi nr.100, i UMF nr. 30/2010 i ndryshuar, për numrin e personave në komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit: *“Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari dhe anëtarë përcaktohen nga kryetari, në vartësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafet 111 deri 118 të këtij udhëzimi”*.
9. Procesverbalet e inventarizimit dhe asgjësimit nuk janë nënshkruar nga gjithë anëtarët, në shkelje të paragrafit nr.110, të UMF nr.30/2011, *“Procesverbali për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve”*, ku nënvizohet se: *“Hartohet nga komisioni për nxjerrjen nga përdorimi në tre kopje, ku përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për cdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit”*. Konkretisht, nuk janë nënshkruar në të dy vitet nga një anëtar i Komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe ai i asgjësimit.

vi. RAPORTET E MONITORIMIT:

Është hartuar raporti i monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 dhe 2017 i cili është dërguar në Ministrinë e Arsimit shkresën nr. 325, dt.27.2.2017. Raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016, që janë paraqitur në Ministrinë e Financave, ndër të tjera edhe për programin *“Planifikim, menaxhim, administrim”* të cilat **nuk janë të plotësuar me një informacionin më të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit**. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre.

- Raportet e monitorimit të buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të DAR dhe nuk shfaqen as në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit apo Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive, në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Sa më lart është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 1, dt. 15.01.2016 udhëzim plotësues *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”* dhe UMF nr. 15881/1, dt. 18.11.2016 *“Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në NJQQ”*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në përgjithësi ka një sistem funksional të kontabilitetit në institucionin e audituar. Krahës këtij opinioni, kërkohet një vëmendje e shtuar për korrigjimin e mangësive të referuar më lartë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

d. Vlerësim nëse punësimet janë mbështetur në kriteret e përcaktuara dhe eksperiencën e nevojshme. Si janë zbatuar procedurat e portalit “*Mësues për Shqipërinë*” dhe dispozitat ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave; sistemi i listë-pagesave, pagesat për mbingarkesat mësimore, etj.

Në funksion të realizimit të auditimit, për zbatimin e akteve nënligjore të lëshuara nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në menaxhimin e punonjësve mësimorë, u grumbullua informacioni statistikor nga DARQT, i plotësuar nga Komisionet e Vlerësimit, si dhe u vlerësua dokumentacioni i administruar mbi procedurat e realizuara, në zbatim të udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”. Për sa sipër, u realizuan takime me drejtuesit e DAR dhe Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit, punonjës të Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë, specialistë të Burimeve Njerëzore, apo anëtarë të grupeve teknike që asistojnë Komisionet e Vlerësimit.

Nga auditimi i këtij procesi rezulton si më poshtë:

- **Kuadri ligjor dhe aktet nënligjore për punësimin:**

Në Drejtorinë Arsimore Rajonale janë administruar procedurat për emërimet nga puna të mësuesve, referuar kritereve të përcaktuara në kuadrin dhe dispozitat nënligjore në fuqi, për ushtrimin e profesionit të mësuesit, si:

- ✓ Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzimit të MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.
- ✓ Urdhri i MAS-it nr. 363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesve në institucionet publike të arsimit parauniversitar”;
- ✓ Udhëzimi nr. 21, datë 23.07.2010, i MASH-it “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, si dhe
- ✓ akte e shkresa për procedurat e shpalljes në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

- **Numri i institucioneve arsimore dhe stafi pedagogjik e ndihmës:**

Në DAR-në Tiranë, në periudhën objekt auditimi, numri i institucioneve arsimore ka variuar nga 69 deri në 64 institucione arsimore, të cilat sipas viteve referojnë këto të dhëna:

Në vitin shkollor 2015 – 2016 :

Institucione arsimore gjithësej	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i Mesëm	Mesme të Bashkuara
69	51	5	13

Në vitin shkollor 2016-2017 :



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Institucione arsimore Gjithsej	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i mesëm	Mesme të bashkuara
66	48	6	12

Në vitin shkollor 2017-2018:

Institucione arsimore Gjithsej	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i mesëm	Mesme të bashkuara
64	46	6	12

- **Ngritja e Komisioneve të Vlerësimit dhe Grupeve Teknike që asistojnë procesin e emërimeve nga portali:**

Në zbatim të përcaktimeve të Kreut 5, të Udhëzimit të MAS, nr.38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, në DAR Qarku Tiranë janë ngritur dhe kanë funksionuar Komisioni i Vlerësimit dhe Grupi Teknik, të cilët kanë vepruar sipas detyrimeve që rrjedhin nga udhëzimi i mësipërm.

✓ Komisioni i Vlerësimit (KV) është ngritur nga drejtori i institucionit [REDACTED] me Urdhërin nr. 75 (nr. 2508 prot), datë 28.10.2015 me 8 anëtarë, me këtë përbërje:

1. M. M, Kryetar, përfaqësues i Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë,
2. R. S., anëtar, mësues i profilit matematikë,
3. Z. Sh., anëtar, mësues i profilit gjuhë-letërsi,
4. [REDACTED] anëtar, mësues i profilit gjuhë e huaj (frengjisht),
5. [REDACTED] anëtar, mësues i ciklit fillor,
6. [REDACTED] anëtar, Përfaqësues i Këshillit të Prindërve,
7. [REDACTED] anëtar, Përfaqësues i Këshillit të Prindërve,
8. [REDACTED] anëtar, punonjës psiko-sociale.

✓ Me Urdhërin nr. 75 (nr. 2508/1prot), datë 28.10.2015, është ngritur Grupi Teknik (GT) që asiston Komisionin e Vlerësimit, me këtë përbërje:

1. [REDACTED] Përgj. i Sektorit të programeve të Zhvillimit,
2. [REDACTED], anëtar, specialist në Sektorin TIS,
3. [REDACTED] specialiste e kuadrit, në sektorin e Programeve të Zhvillimit.

Për arsye të largimit, transferimit apo mosmartjes pjesë në komisione, të një pjese të anëtarëve të komisioneve dhe grupeve teknike, nga ana e DARQT janë bërë zëvendësime e plotësime me anëtarë të rinj, përkatsisht:

✓ me Urdhër të drejtorit të institucionit, nr.37, datë 07.11.2017, z. [REDACTED] është zëvendësuar nga z. [REDACTED], mësues i profilit biologji-kimi.

✓ me Urdhër të drejtorit të institucionit, nr.77, datë 21.12.2017, znj. [REDACTED] është zëvendësuar nga znj. [REDACTED], (punonjës social). Njëkohësisht për mospjesëmarrje, dy anëtarët e Këshillit të Prindërve janë zëvendësuar nga përfaqësuesit e prindërve [REDACTED] dhe [REDACTED].

[REDACTED] me Urdhër të drejtorit të institucionit, nr.78 (nr.3134 prot), datë 26.12.2017 është ngritur Komisioni Teknik i portalit 2017, me përbërje [REDACTED]



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Sa më lartë, konstatohet se kanë gjetur zbatim kërkesat e pikave nr. 2 dhe 3, të Kreut V “Ngritja e komisionit të vlerësimit dhe përgjegjësitë”, të Udhëzimit të MAS nr. 38/2015.

- **Zbatimi i procedurave të njoftimit të pozicioneve të lira të punës nga DARQT:**

Për periudhën objekt auditimit, në faqen zyrtare të institucionit janë pasqyruar dhe aksesohen vetëm këto njoftime në lidhje me funksionimin e portalit të punësimit “Mësues për Shqipërinë”:

1. Me shkresën e drejtorit të DAR znj. [REDAKTUAR] nr.1209 prot, datë 14.10.2014 janë njoftuar shpalljen e konkurimit për 6 pozicionet e lira të punësimit për postin e *drejtorit të institucionit arsimor publik (drejtor shkolle)*, nga të cilat 1 në shkollën 9 vjecare Katundi i Ri Tiranë, 1 në Gjimnazin Katundi i Ri si dhe 4 pozicione në shkollat e mesme të bashkuara. Procedurat janë referuar sipas Udhëzimit të MASH nr.57, datë 12.11.2013 dhe data e konkurimit është caktuar 27.10.2014.
2. Me shkresën e drejtorit të DAR znj. [REDAKTUAR] nr.183 prot, datë 12.01.2015 është njoftuar hapja e konkurimit për pozicionin e punësimit për *Zv/drejtor të institucionit arsimor publik*, shkolla e mesme e bashkuar Vaqarr, për të konkuruar më datën 02.02.2015.
3. Me shkresën nr.1623 prot, datë 23.06.2015 është njoftuar hapja e konkurimit për pozicionin e punësimit për *drejtor të institucionit arsimor publik*, për 19 shkolla.
4. Me shkresën nr.1756 prot, datë 03.07.2015 është shpallu faza e dyte e zgjedhjes së *drejtuesve* të 5 shkollave të mesme dhe 14 shkollave 9 vjecare.
5. Me shkresën nr.150/1 prot, datë 25.06.2015 është njoftuar pozicioni i punësimit (vakant) në profilin *mësues matematike*, shkolla “[REDAKTUAR]”, Yzberisht.
6. Me shkresën nr.1181 prot, datë 20.06.2016 është njoftuar hapja e konkurimit për pozicionin e punësimit për 6 *drejtore të institucionit arsimor publik*,
7. Me shkresën nr.1463 prot, datë 29.05.2017 është njoftuar faza e intervistës për 3 pozicione drejtues të shkollave.
8. Me shkresën nr.1531 prot, qershor 2017, është njoftuar hapja e konkurimit për pozicionin e punësimit *për psikolog*.
9. Me shkresën nr.98 prot, datë 14.11.2017 është njoftuar hapja e pozicionit të punësimit për *Zv/drejtor të institucionit arsimor publik*, Vaqarr.
10. Me shkresën nr.202 prot, datë 13.11.2017 është njoftuar hapja e konkurimit për pozicionin e punësimit për *Zv/drejtor të institucionit arsimor publik*, shkolla “[REDAKTUAR]”, Katund i Ri.

Sa sipër, janë shpallur (publikuar) në ëëbsiten zyrtar të DAR, në 8 (tetë) raste njoftimet për pozicionin e drejtuesit ose zv/drejtuesit të institucionve arsimore dhe vetëm në 2 (dy) raste janë shpallur pozicioni për mësues matematike dhe psikolog.

Konstatimi:

Nga DARQT dhe Komisioni i Vlerësimit, nuk është administruar dhe shpallur lista e pozicioneve të lira të përhershme/ përkohshme, të krijuar në përfundim të vitit mësimor.

Konkurrimi në portal i arsimtarëve sipas profileve:

I. Në portalin 2015-2016, (për të cilin regjistrimet e aplikantëve janë deri më datën 12.12.2015), kanë aplikuar me dosje dhe janë vlerësuar **229 kandidatë**, të ndarë sipas profileve:

1.Arsimi Fillor, 35

2.Arsimi Parashkollor, 22



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

- 3.Biologji, 18
- 4.Edukim Fizik, 11
- 5.Fizikë, 3
- 6.Gjeografi, 25
- 7.Gjuhë angleze, 12
- 8.Gjuhë shqipe dhe letërsi, 54
- 9.Histori, 23
- 10.Kimi, 6
- 11.Matematikë, 10
- 12.Edukim muzikor, 2
- 13Shkenca Shoqërore, 4

II. Në portalin 2016-2017, (për të cilin testimi i aplikantëve është kryer më 21.01.2017), kanë aplikuar me dosje dhe janë vlerësuar 358 kandidatë, si më poshtë:

- 1.Arsimi Fillor, 51
- 2.Arsimi Parashkollor, 19
- 3.Biologji, 29
- 4.Edukim Fizik, 9
- 5.Fizikë, 15
- 6.Gjeografi, 32
- 7.Gjuhë angleze, 21
- 8.Gjuhë shqipe dhe letërsi, 79
- 9.Histori, 34
- 10.Kimi, 16
- 11.Matematikë, 34
- 12.Gjuhë frëngë, 8
- 13.Gjuhë italiane, 4
- 14.TIK, 1
- 15.Edukim muzikor, 3
- 16.Shkenca Shoqërore, 2
17. Ars.special 1

III. Në portalin 2017-2018, ka fluar procesi i regjistrimit e aplikantëve deri në datën 22.12.2017), për të cilët vijnë fazat e testimit dhe vlerësimit përfundimtar.

Nga ana e KV dhe GT janë kryer vlerësimet e dosjes së çdo kandidati, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim, është aplikuar renditja e kandidatëve për çdo profil/lëndë, mbi bazën e vlerësimit të dosjes si dhe mbi bazën e vlerësimit të testimit “Mësues për Shqipërinë”, duke i evidentuara këto të dhëna në një database, ku është dhe **renditja e përgjithshme** për çdo profil/lëndë të kandidatëve në nivel të njësisë arsimore vendore, të cilat janë shpallur të renditura në faqen zyrtare *ëeb* të drejtorisë arsimore vendore. Nga ana e Komisionit të Vlerësimit janë realizuar procedurat e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve në mbështetje të shtojcës 3.1, të Udhëzimit të MAS nr.38, datë 06.10.2015.

Sipas Komisioni i Vlerësimit, pretendohet se asnjë kandidat nuk është ankimuar për mosveprim të komisioneve dhe grupeve teknike, si për vlerësimin e dosjeve, ashtu dhe për rankimin e rezultateve. ***Nga auditimi rezultoi se, disa kandidatë kanë paraqitur ankesa zyrtare mbi vlerësimet e komisionit të testimit, pikët për dosjen, apo kërkesë për***



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

rishikim dhe rivlerësim të pikëve të dosjes apo vlerësimit sipas portalit, për vitin 2015-2016 si vijon:

1. [REDACTED] ankesa e prot me nr. 49, datë 08.01.2016; (me shkresën nr. 61 prot, datë 11.01.2016 i është dërguar për kompetencë Institutit të Zhvillimi te Arsimit, sipas nenit 20/ b të Udhëzimit të MAS me nr. 40, datë 09.10.2015, psi ankesa lidhej me pikët e testit.
2. [REDACTED], ankesa e prot me nr. 24, datë 06.01.2016; (me shkresën nr. 61 prot, datë 11.01.2016 i është dërguar për kompetencë Institutit të Zhvillimi te Arsimit, sipas nenit 20/ b të Udhëzimit të MAS me nr. 40, datë 09.10.2015, psi ankesa lidhej me pikët e testit.
3. [REDACTED], ankesa e prot me nr.18, datë 06.01.2016; (me shkresën nr. 61 prot, datë 11.01.2016 i është dërguar për kompetencë Institutit të Zhvillimi te Arsimit, sipas nenit 20/ b të Udhëzimit të Mas me nr. 40, datë 09.10.2015, psi ankesa lidhej me pikët e testit.
4. [REDACTED] ankesa e prot me nr. 15, datë 05.01.2016; Nga shqyrtimi i dosjes, kandidati është rivlerësuar, nga 20,9 pikë, në 21,9 pikë. Korrigjimi ka shënimin “korrigjoi [REDACTED]”. **Në dosje nuk ka përgjigje për ankuesen dhe konfirmim nga anëtarët e tjerë të komisionit të vlerësimit.**
5. [REDACTED] ankesa e prot me nr. 27, datë 07.01.2016; (me shkresën nr. 61 prot, datë 11.01.2016 i është dërguar për kompetencë Institutit të Zhvillimi te Arsimit, sipas nenit 20/ b të Udhëzimit të MAS me nr. 40, datë 09.10.2015, psi ankesa lidhej me pikët e testit.
6. [REDACTED], ankesa e prot me nr. 91, datë 15.01.2016 (kërkon rivlerësim dhe rishikim të pikëzimit përdosjen personale); Nga shqyrtimi i dosjes së vlerësimit, kandidati është vlerësuar me 6,9 pikë. **Në dosje nuk ka rillogaritje dhe as përgjigje për ankuesen.**
7. [REDACTED], ankesa e prot me nr. 54, datë 11.01.2016, (në këtë rast ankuesja pretendon se është regjistruar rregullisht në portal dhe kur ka vajtur për testimin e portalit, nuk i figuron emri);

Nga verifikimet e kryera në regjistrin e protokollit të institucionit, nuk gjenden në asnjë rast, gjurmë të përgjigjeve me shkrim për ankuesit si korrespondenca zyrtare me institucionin.

- ✓ Në 16 raste kandidatët kanë një numër të barabartë pikësh, nga këto 4 raste në portalin 2015-2016 dhe 12 raste në portalin 2016-2017, për të cilët MAS nuk ka parashikuar e dhënë asnjë instruksion udhëzues mbi mënyrën e renditjes së kandidatëve për këto raste. Konkreisht:

Për portalin 2015-2016:

91	TRQ-0027	TRQ	[REDACTED]	[REDACTED]	Gjeografi	I45807001U	53.7
100	TRQ-0108	TRQ	[REDACTED]	[REDACTED]	Gjeografi	I30603050K	53.7

7	TRQ-0125	[REDACTED]	[REDACTED]	I9622002N	AFillor	46.3
30	TRQ-0239	[REDACTED]	[REDACTED]	I15810065O	AFillor	46.3



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Për portalin 2016-2017:

13	17T03003	■	■	I15910035T	Arsim Fillor	62
14	17T03366	■	■	H35811055N	Arsim Fillor	62

38	17T03060	■	■	I26117059K	Arsim Fillor	43.3
39	17T03064	■	■	024651027	Arsim Fillor	43.3

12	17T03370	■	■	I75203078V	ZA Pogradec	Matematikë	51.2
13	15T03186	■	■	I75715013U	DAR Tiranë Qytet	Matematikë	51.2

49	17T03133	■	■	H45919161P	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	54
50	17T03460	■	■	I65501096R	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	54

70	17T03094	■	■	032320241	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	41.2
71	17T03647	■	■	I05531043K	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	41.2

12	17T03072	■	■	G70328230L	Gjeografi	53.6
13	17T03106	■	■	J06101003H	Gjeografi	53.6

✓ Grupi i auditimit, nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit nuk gjeti gjurmë të njoftimit/ shpalljes për fillimin e procedurave të aplikimit në portalin “Mësues për Shqipërinë” për vitet 2015, 2016 dhe 2017, përmes së cilës mësuesit të informohen mbi afatet kohore të aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit dhe dosjeve, si dhe mbi hapat që duhet të ndjekin deri në përfundim të procesit, sic ka ndodhur me shkresën me nr. 390 prot, datë 15.01.2018 e Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, për plotësimin e formularit, pjesëmarrjen në testim dhe afatet e aplikimit online (16-31.1.2018) në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

✓ U konstatua se, nuk u gjetën dokumente shkresore të Komisionit të Vlerësimit, lidhur me miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve sipas lëndëve/ profileve pjesëmarrës në konkurrimin në Portalin “Mësues për Shqipërinë”;

• Konkurrimi dhe punësimet nga portali:

Për punësimet e kandidatëve nga portali, Komisioni i Vlerësimit (KV) dispononte dosjet e secilit kandidat, tabelën me të dhënat e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, listën e renditjes së përgjithshme të kandidatëve pjesëmarrës në testimin “Mësues për Shqipërinë”, procesverbalet e mbledhjes së komisionit, deklaratat e pranimit / refuzimit të vendit të punës. Nga ana e DAR nuk u paraqit dokument shkresor lidhur me ankimet e kandidatëve për rezultatet e vlerësimit të dosjeve.

1. Për punësimet nga portali, rezulton se :

a. Në portalin **2015** kanë konkurruar **229 kandidatë**, nga të cilët :

- Janë punësuar **47** mësues definitiv dhe **21** mësues me kontratë provizore.
- Kanë refuzuar të punësohen në shkollat e ofruara **15** mësues kandidatë, refuzuar për arsye largësie, ose u janë ofruar pozicione zëvendësues, punësuar në një institucion tjetër para ditës së përzgjedhjes së vendeve vakante, etj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Nr.	Portali 2015-2016	Kandidatë pjesëmarrës në konkurrim	Nga këto: punësuar		Refuzuar pozicionin e ofruar
			Pozicion vakant (definitive)	Pozicion i përkohshëm zëvendësues	
1.	Shkenca Shoqërore	4	0	0	0
2.	Edukim muzikor	2	1	0	0
3.	Matematikë	10	6	1	1
4.	Kimi	6	1	0	0
5.	Histori	23	0	1	0
6.	Gjuhë shqipe dhe letërsi	54	2	3	1
7.	Gjuhë italiane	1	0	0	0
8.	Gjuhë gjermane	1	0	0	0
9.	Gjuhë frëngë	2	0	0	0
10.	Gjuhë angleze	12	6	3	0
11.	Gjeografi	25	0	1	4
12.	Fizikë	3	2	1	0
13.	Edukim Fizik	11	3	1	3
14.	Biologji	18	0	2	1
15.	Arsimi Parashkollor	22	9	3	3
16.	Arsimi fillor	35	17	5	2
Totali		229	47	21	15

Shënim: Shuma e punësimeve dhe refuzimeve nuk perputhet me totalin e konkurreseve pasi ka raste që kandidatët konkurrues nuk janë trajtuar ende, kanë terhequr dosjen, janë skualifikuar, kanë kaluar në pozicionin e zv/drejtorit të shkollës, vënë shënimin “s’përgjigjet në telefon”, larguar në SHBA, punësuar në DAR Qytet, etj.

b. Në portalin **2016** kanë konkurruar **358 kandidatë**, nga të cilët:

- Janë punësuar **51** mësues definitiv dhe **28** mësues me kontratë provizore.
- Kanë refuzuar të punësohen 49 mësues kandidatë, për të njëjtat arsye si në vitin e mëparshëm, etj.

Nr.	Portali 2016-2017	Kandidatë pjesëmarrës në konkurrim	Nga këto: punësuar		Refuzuar pozicionin e ofruar
			Pozicion vakant (definitive)	Pozicion i përkohshëm zëvendësues	
1.	Arsimi Fillor	51	17	5	21
2.	Arsimi Parashkollor	19	9	4	1
3.	Biologji	29	0	1	1
4.	Edukim Fizik	9	7	0	1
5.	Fizikë	15	3	0	5
6.	Gjeografi	32	0	0	0
7.	Gjuhë angleze	21	7	5	3
8.	Gjuhë shqipe dhe letërsi	79	1	3	0
9.	Histori	34	0	1	2



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

10.	Kimi	16	1	1	2
11.	Matematikë	34	4	4	12
12.	Gjuhë frëngë	8	0	4	1
13.	Gjuhë italiane	4	1	0	1
14.	TIK	1	0	0	0
15.	Edukim muzikor	3	0	0	0
16.	Shkenca Shoqërore	2	0	0	0
17.	Ars.special	1	1	0	0
	Totali	358	51	28	49

Në zbatim të kreut 10 të Udhëzimit Nr. 38, në DAR QT, janë realizuar emërimet nga drejtuesit e institucioneve shkollore për mësuesit që kanë qenë kontraktuar në vende pune të përhershme dhe me ngarkesë të plotë mësimore dhe që plotësonin kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke marrë dhe miratimin e këshillave të prindërve dhe të shërbimit psiko-social.

Sistemi i punësimit të mësuesve, për zonat urbane dhe ato të cilat kapen nga transporti, është mbështetur kryesisht në listat e mësuesve të portalit, ndërsa për zonat e thella janë realizuar rilidhje të kontratave të mëparshme.

Konstatime:

- Në Portalin “Mësues për Shqipërinë”, konkurrimi 2015-2016 dhe 2016-2017 kanë konkurruar **587** aplikantë gjithsej dhe janë sistemuar në vende vakante /definitive **98** kandidatë, ndërsa në pozicione provizore **49** kandidatë. Pra, konstatohet se vetëm **16,6 %** e kandidatëve që kanë konkurruar nëpërmjet këtyre dy portaleve janë sistemuar me kontratë punësimi definitive, (ose vetëm **25 %** janë punësuar nga pozicioni definitiv dhe zëvendësues).

Nr.	Portali	Kandidatë pjesëmarrës në konkurrim	Nga këto: punësuar	
			Pozicion vakant (definitive)	Pozicion i përkohshëm zëvendësues
1.	2015-2016	229	47	21
2.	2016-2017	358	51	28
	Totali	587	98	49

- Në Portalin “Mësues për Shqipërinë” 2015 dhe 2016 janë sistemuar në vende vakante të gjithë kandidatët e profileve *Arsim Special*, përkatësisht 1 kandidat në portalin e vitit 2016-2017.
- Asnjëri nga kandidatët e profileve *Shkenca Shoqërore, Gjuha Frënge, Gjuha Gjermane, Gjuha Italiane*, të listuar në portalin 2015-2016 dhe kandidatët e profileve *Gjeografi, TIK, Edukim Muzikor e Shkenca Shoqërore* të listuar në portalin 2016-2017, nuk ka arritur të emërohet nëpërmjet DAR Qark Tiranë. Referuar të dhënave në tabelën e përgjithshme të renditjes së kandidatëve pjesëmarrës në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

portale, u evidentua se numrin më të lartë të kandidatëve, që janë punësuar, e përbëjnë ato të profilit *Arsimi Fillor, Gjuha Angleze, Matematikë, etj.*

7. Nga auditimit vërehet se nuk ka **një regjistrim të këtyre procedurave** për rastet e njoftimit të kandidatëve, si për **marrjen e konfirmimit**, (apo refuzimit me shkrim për mospranim të vendeve apo pozicioneve të punësimit të ofruara), ose të rregjistrimit dhe printimit për përgjigjet me SMS për **refuzimin e vendeve të ofruara**. Këto veprime bien ndesh me kërkesat e Kreut III, pika 3 të udhëzimit të MS nr. 38, që pëcakton se “Komisioni dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat. Janë sipas viteve raste të shumta të refuzimeve (mospranimit) për mundësitë e ofruara kandidatëve të rankuar më lartë, meqenëse kjo lidhej me largësinë e madhe të shkollave apo me ofrimin e nje pozicioni punësimi të përkohshëm (si zëvendësues për raport leje lindje, etj).
8. Auditimi vëren dobësi dhe problematika në **mënyrën e njoftimit të kandidatëve të rankuar, për ti ftuar në zgjedhjen e pozicionit të punësimit**. Udhëzimi i MAS nuk përcakton rregulla e kriteret mbi mënyrën e njoftimit dhe dokumentimin e rasteve kur subjektet nuk përgjigjen, apo ka mungesë aksesit. Në këto raste Komisioni ka vijuar me njoftimin e kandidatëve të rradhës, duke u shprehur se “*nuk ekziston numri i telefonit*”, “*nuk përgjigjet abonenti*”, etj. Në 18 raste gjithsej, (nga këto 5 raste të lidhura me portalin 2015-2016 dhe 13 raste për kandidatët e portalit 2016-2017), është vënë shënimi që, “*nuk përgjigjet në telefon*”, “*fikur telefoni*”, “*nuk ekziston numri i telefonit*”, etj, duke e konsideruar të përfunduar detyrimin për njoftimin e tyre dhe ka vijuar me emërimin e kandidatëve, që listohen më poshtë në renditjen e fituesve.

Kështu, mund të përmendim:

Portali 2015-2016

176	TRQ-0184	■	■	H45307059L	GJSHL	73.7	674145798	nuk përgjigjet ne telefon
-----	----------	---	---	------------	-------	------	-----------	---------------------------

126	TRQ-0195	■	■	I45222010H	GJA	37.2		S'ka numer
-----	----------	---	---	------------	-----	------	--	------------

41	TRQ-0075	■	■	I95320089L	APSH	40.2	695572555	Nuk ekziston numri i telefonit
----	----------	---	---	------------	------	------	-----------	--------------------------------

21	TRQ-0212	■	■	H95420134N	AF	63.6	693586151	nuk përgjigjet ne telefon
----	----------	---	---	------------	----	------	-----------	---------------------------

7	TRQ-0125	■	■	I9622002N	AF	46.3	693760575	nuk përgjigjet ne telefon
---	----------	---	---	-----------	----	------	-----------	---------------------------

Portali 2016-2017

Nr.	Nr. Rendor në databasen e portalit	Kodi i kandidatit	Shënimi nga Komisioni i Vlerësimit
1.	28 databasa kryesore	17T03003	Nuk ekziston telefoni
2.	30	17T03090	Nuk hap telefonin
3.	36	17T03721	Nuk hap telefonin
4.	50	15T03219	Nuk hap telefonin
5.	64	15T02947	Fikur telefoni
6.	67	17T03443	Nuk përgjigjet në telefon
7.	82	17T02961	Nuk ekziston telefoni
8.	9 Ars.Parashk	17T03085	Nuk përgjigjet në telefon
9.	17 Ars.Parashk	17T04420	Nuk ekziston nr. telefonit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

10.	9 Fizikë	17T03933	Nuk përgjigjet, nr nuk ekziston
11.	29 Ars.Fillor	17T03065	Nuk ekziston nr. telefonit
12.	9 Ars.Fillor	TRQ0211	Nuk përgjigjet në telefon
13.	31 Ars.Fillor	17T03113	Nuk telefonit nuk është i saktë

1. Dosjet e personelit për arsimtarët në DARQT përmbajnë vetëm informatat që janë dorëzuar në kuadër të konkurimit nëpërmjet portalit, **mungon fleta prezantuese e dosjes dhe një pjesë e këtyre dokumenteve janë fotokopje të panoterizuara**. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, (lidhja nr.1, pikat 4 dhe 5), si dhe përcaktimet e Udhëzimit të ministrit të MASH nr. 38, datë 6.10.2015 dhe pika 1 e 2 e kreut III, të Udhëzimit të MAS nr. 12, datë 27.4.2015, “Për mbledhjen, përpunimin, dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbajtjen e dosjes së tyre personale” dhe shtojcat nr. 1 e 2.

2. Auditimi konstaton se:

Pavarësisht faktit që, janë zhvilluar disa portale për rekrutimin dhe plotësimin e pozicioneve të punësimit (2014, 2015-2016, 2016-2017 dhe tani është në proces portali 2017-2018), rezulton se, ende në disa shkolla të zonave të thella malore, japin mësim 17 mësues pa arsim përkatës dhe 14 mësues jashtë profilit. Këto vende pune, nga DAR-ja nuk rezultojnë të dokumentuara të shpallur si vende pune të lira, por pretendohet se asnjë nga mësuesit e portalit, nuk kanë pranuar të shkojnë të punojnë në këto pozicione të largëta. Për KV dhe zyrtarët e DARQT problematikë ngelet mospranimi i vendeve vakant në shkollat të cilat gjenden jashtë zonave urbane si në Killojkë, Njësia administrative Zall-Bastar.

Analizuar sipas shkollave dhe profilin paraqitet kjo situatë e punësimit të mësuesve jashtë profilin apo pa arsimin përkatës:

institucioni	Numri gjithësej i punonjësve mësimorë në sistem	Numri i mësuesve me arsimin përkatës	Numri i mësuesve me arsimin përkatës që mbulojnë mbi 90% të normës mësimore	Numri i mësuesve me arsimin përkatës që mbulojnë 50%-90% të normës mësimore	Numri i mësuesve me arsimin përkatës që mbulojnë deri 50% të normës mësimore	Numri i mësuesve pa arsimin përkatës	Numri i mësuesve jashtë profilin
DARQT	1336	1319	1220	75	10	17	14

Konstatohet se:

Pas verifikimit të dosjeve personale të mësuesve dhe shpërndarjes së ngarkesës mësimore të shkolle, rezultoi se jashtë profilin ishin 14 (katërmëdhjetë) mësues, të cilët për arsye objektive japin lëndë të tjera mësimore. Më konkretisht, nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore, rezulton se:

- Në 5 (pesë) raste, (në shkollat 9-vj.Bastar i Mesëm, 9-vj.Zall-Dajt (vartëse Selitë), M.B Shëngjergj (vartëse Fag), 9-vj.Koçaj (vartëse Vrap) klasa kolektive, 9-vj.Picar (vartëse Kuç), profili Matematikë-Fizikë, u është shpërndarë dhe realizohet nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

mësues të profilit të profilit “**Biologji-Kimi**”, “**Histori-Gjeografi**” dhe “**Arsim fillor**”,

- Në **5 (pesë) raste**, (në shkollat 9-vj.Bastar i Mesëm, 9-vj.Zall-Dajt (vartëse Selitë), M.B Shëngjergj (vartëse Fag), 9-vj.Koçaj (vartëse Vrap) klasa kolektive, 9-vj.Picar (vartëse Kuç), profili **Matematikë-Fizikë**, u është shpërndarë dhe realizohet nga mësues të profilit të profilit “**Biologji-Kimi**”, “**Histori-Gjeografi**” dhe “**Arsim fillor**”,
- Në **1 (një) rast**, (në shkollën 9-vj.Bërxull), profili/lënda e **Anglishtes**, i është shpërndarë dhe realizohet nga mësues të të profilit “**Gjuhë-Letërsi**”, me bazë të mesme anglisht.
- Në **5 (pesë) raste**, (në shkollat 9-vj.Zall-Dajt, 9-vj.Vilëz (vartëse Mal-Gjepal), M.B Szall Bastar, 9-vj.Lagje e Re (vartëse Pinet), 9-vj.Shesh, profili **Arsimi Fillor**, u është shpërndarë dhe realizohet përkatësisht nga mësues të profilit “**Histori**”, “**Biologji-Kimi**”, “**Histori-Gjeografi**” dhe “**Gjuhë-Letërsi**”.
- Në **1 (një) rast**, (në shkollën 9-vj.Vilëz), mësuesi i **Gjeografisë**, jep lëndën e **Edukimit Fizik**, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 21, date 23.7.2010 “Për ngarkesën mësimore dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 38 të MAS, gjë që ka sjellë mos shpalljen të lirë të një vendi pune për profilin e mësipërm.

Në mënyrë të përmbledhur në bazë të shkollave, gjendja e **mësuesve jashtë profilit** paraqitet si vijon:

Nr.	Shkolla	Profili qe duhet	Zevendesuar me
1.	9-vj.Bastar i Mesëm	Matematike-Fizike	Bio-kimi
2.	9-vj.Zall-Dajt (vartëse Selite)	Matematike-Fizike	Hist-Gjeografi
3.	9-vj.Zall-Dajt	A.Fillor	Histori
4.	9-vj.Vilez (vartëse Mal-Gjepal)	A.Fillor	Histori
5.	9-vj.Vilëz	Ed.Fizik	Gjeografi
6.	M.B.Zall-Bastar	A.Fillor	Bio-kimi
7.	M.B.Shengjergj (vartëse Fag)	Matematike-Fizike	A.Fillor
8.	9-vj.Bërxull	Anglisht	UT GJ-Letersi + mesem Anglisht
9.	9-vj.Koçaj (vartëse Vrap) klasa kolektive	Matematike-Fizike	A.Fillor
10.	9-vj.Koçaj (vartëse Vrap) klasa kolektive	Gjuhe-Letersi	Gjeografi
11.	9-vj.Lagje e Re (vartëse Pinet)	A.Fillor	Hist-Gjeografi
12.	9-vj.Shesh	A.Fillor	Gjuhe-Letersi
13.	9-vj.Prush (vartëse Allgiate)	Gjuhe-Letersi	Ed.Qytetare
14.	9-vj.Picar (vartëse Kuç)	Matematike-Fizike	H-Gjeografi

Burimi : *DARQT*

Konstatohet se, në **5 (pesë) shkolla të juridiksionit të DARQT**, paguhen **17 (shtatëmbëdhjetë) mësues** që janë jashtë profilit të kërkuar dhe kryesisht janë me arsim të mesëm pedagogjik. Më konkretisht:

- Në **3 (tre) raste**, (përkthësisht në shkollat 9-vj.Bastar i Mesëm), profili **Gjuhë-Letërsi**, mbulohet nga një arsimtar i mesëm që ka kryer studimet e larta për Gjuhë-Letersi, po është **pa licencë**. Në të njëjtën shkollë, një arsimtar i ciklit të ulët, është **pa licencë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Edhe në shkollën 9-vj.Zall-Dajt (vartëse Selitë), profili **gjeografi**, mbulohet nga një arsimtar që ka kryer studimet e larta, por është **pa licencë**.

- Në **10 (dhjetë) raste**, (shkolla 9-vj.Bastar i Mesëm (vartëse Bastar Murrize), 9-vj.Zall-Dajt (vartëse Mojsit), 9-vj.Zall-Dajt (vartëse Shupal), 9-vj.Vilez (vartëse Mal-Vilez), 9-vj.Vilez (vartëse Mner I Eperm), M.B.Zall-Bastar(vartëse Shyqyrk), etj.profilet **Anglisht** dhe **Arsimi Fillor**, mbulohen nga kuadro që ka kryer vetëm **studimet e mesme**, (e mesme pedagogjike, anglisht, apo bujqësore)
- Në **1 (një) rast**, (shkolla 9-vj.Vilëz), lënda /profili **Fizikë**, mbulohet nga një person që ka kryer studimet në **Akademinë Ushtarake**;
- Në **1 (një) rast**, (shkolla 9-vj.Vilëz), lënda /profili **Biologji-Kimi**, mbulohet nga një person që ka kryer studimet në **ILB, dega Agronomi**;
- Në **1 (një) rast**, (shkolla 9-vj.Vilëz, vartëse Mner i Epërm), profili **Arsimi Fillor**, mbulohet nga një person që ka kryer studimet në **Universiteti Vitrina, (i paakredituar dhe i është hequr licensa me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 06.08.2014).**

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të MAS me nr. 21, datë 23.07.2010 “Për ngarkesën mësimore dhe numrin e nxënësve në klasë në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar dhe Udhëzimin e MAS nr.38/ 2015.

Në mënyrë të përmblodhur në bazë të shkollave, gjendja e mësuesve **pa arsim përkatës** paraqitet si vijon:

Nr	Shkolla	Profili	Nr mësuesve	Arsimi	Kualifikimi
1.	9-vj.Bastar i Mesëm (vartëse Bastar Murrize)	Gjuhe Letersi	1	Mesem Pedagogjik	II
2.	9-vj.Bastar i Mesëm (vartëse Bastar Murrize)	Anglisht	1	Mesem Anglisht	IV
3.	9-vj.Zall-Dajt (vartëse Mojsit)	Mat-Fizike	1	Mesem Pedagogjik	IV
4.	9-vj.Zall-Dajt (vartëse Selite)	Histori	1	Histori (Pa license)	
5.	9-vj.Zall-Dajt (vartëse Shupal)	A.Fillor	1	Mesem Pedagogjik	II
6.	9-vj.Vilez	Fizike	1	Ak.Ushtarake	
7.	9-vj.Vilez (vartëse Mal-Vilez)	A.Fillor	1	mesme bujqësor	
8.	9-vj.Vilez	Bio-Kimi	1	ILP Agronomi	
9.	9-vj.Vilez (vartëse Mner I Eperm)	Anglisht	1	Mesem Anglisht	III
10.	9-vj.Vilez (vartëse Mner I Eperm)	A.Fillor	1	U.Vitrina	P.A
11.	M.B.Zall-Bastar	Gjuhe Letersi	1	UT GJ-L (Pa license)	
12.	M.B.Zall-Bastar	Fizike	1	Fizike master shkencor	
13.	M.B.Zall-Bastar(vartëse Shyqyrk)	A.Fillor	1	Mesem Pedagogjik	II
14.	M.B.Zall-Bastar (vartëse Maricaj)	A.Fillor	1	Mesem Pedagogjik	III



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

15.	M.B.Shengjergj	Anglisht	1	Perkthyes Gjuhes Angleze jo master Profesional	
16.	M.B.Shengjergj	Anglisht	1	mesem Anglisht	II
17.	M.B.Shengjergj (vartese Shenmeri+Burimas)	Anglisht	1	mesem Anglisht	IV

KV nuk disponon procesverbalin e mbledhjes së komisionit për vlerësimin e dosjes së tyre, por disponon procesverbal për njoftimin e zgjedhjes së vendit të lirë të punës si dhe deklaratën e kandidatit për pranimin e tij. Gjithashtu, u konstatua se në DARQT, pas zgjedhjes së vendit të lirë të punës nga kandidatët për mësues, nuk ka në protokoll / shkresë përcjellëse për dokumentet drejtuar institucionit arsimor. Format i vlerësimeve (Shtojca-3) dhe procesverbali i komandimit të mësuesve në detyrë janë nënshkruar vetëm ngë një pjesë e komisionit (5 ose 6 anëtarë) dhe mungojnë njoftimet për përfaqësuesve vendorë të sindikatave nënshkruar të kontratës kolektive të punës, për pjesëmarrje në mbledhje dhe për monitorimin e të gjithë procesit të konkurrimit dhe të emërimeve.

- **Komisioni i Vlerësimit nuk ka bërë raportimet 3-mujore në MAS mbi monitorimin e punësimeve të kandidatëve pjesëmarrës në portal, siç përcaktohet në Kreun 5, pika 5/g, të udhëzimit nr. 38. të MAS si dhe nuk ka asnjë raport, sipas cilësimeve të gërmës “g” të Kreu V, pika 5, mbi “Monitorimin e punësimeve sipas renditjes së përgjithshme të kandidatëve dhe raportimin në MAS, çdo tre muaj.**

2. Në DARQT, u evidentua se në **106 raste të lëvizjeve paralele**, të ndara sipas periudhave:

- ✓ Në 59 raste janë kryer gjatë muajve shtator (2015-2017, objekt auditimi);
- ✓ Në 28 raste janë kryer gjatë muajve tetor (2015-2017, objekt auditimi);
- ✓ Në 16 raste janë kryer gjatë muajve nëntor (2015-2017, objekt auditimi);
- ✓ Në 3 raste janë kryer gjatë muajve dhjetor (2015-2017, objekt auditimi);

Nga ana e drejtuesve të DARQT lëvizjet paralele janë kryer gjatë muajit shtator deri në dhjetor, për:

- Në **9 raste** janë realizuar për sistemimin e arsimtarëve në profil ose për sistemim të normës mësimore.
- Në **47 raste** janë imponuar nga rënia e numrit të nxënësve në klasa/ shkolla. Shkollat që krijojnë më shumë probleme të rënies së numrit të nxënësve dhe që kanë pasur më shumë kërkesa për lëvizje paralele janë **shkollat vartese, me klasa kolektive, por dhe në shkollat qendër** vihet re një tendencë e rënies së vazhdueshme të numrit të nxënësve këto vitet e fundit. *(Kjo situatë ka detyruar kryerjen e lëvizjeve paralele në muajt në vazhdim).*
- Në **50 raste**, për trajtimin e kërkesave të mësuesve, *(per arsye shendetesore, distanca e largët e qendrës arsimore me vendbanimin apo vjetërsinë në punë të punonjësit që ka bërë kërkesë)*, të cilat kanë qenë të shpërndara gjatë vitit shkollor e në mënyrë të vazhdueshme (nga momenti që është krijuar një vend i lirë sipas profilit përkatës të kërkuar, janë kryer lëvizjet paralele të arsimtarëve, etj.

Lëvizjet paralele, viti shkollor 2015 -2016:

Nr	Periudha	Numër rastesh transferimi	Arsyeja e transferimit
1	Shtator	11	Rënie e numrit të nxënësve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

2	Shtator	8	Sipas kërkesave
3	Tetor	4	Rënie e numrit të nxënësve
4	Tetor	2	Sipas kërkesave
5	Nentor	2	Sipas kërkesave
6	Dhjetor	1	Sipas kërkesave
Gjithsej 2015-2016:		28	

Lëvizjet paralele, viti shkollor 2016 -2017:

Nr	Periudha	Numër rastesh transferimi	Arsyeja e transferimit
1	Shtator	9	Rënie e numrit të nxenesve
2	Shtator	8	Sipas kërkesave
3	Shtator	3	Sistemim në profil
4	Tetor	6	Rënie e numrit të nxenesve
5	Tetor	3	Sipas kërkesave
6	Tetor	1	Sistemim në profil
7	Nentor	2	Sipas kërkesave
8	Dhjetor	1	Sipas kërkesave
9	Dhjetor	1	Sistemim ngarkese mesimore
Gjithsej 2016-2017		34	

Lëvizjet paralele, viti shkollor 2017-2018 paraqiten në tabelë:

Nr	Periudha	Numër rastesh transferimi	Arsyeja e transferimit
1	Shtator	6	Rënie e numrit të nxenesve
2	Shtator	12	Sipas kërkesave
3	Shtator	2	Përngarkese mesimore
4	Tetor	8	Rënie e numrit të nxenesve
5	Tetor	3	Sipas kërkesave
6	Tetor	1	Sistemim në Profil
7	Nentor	3	Rënie e numrit të nxenesve
8	Nentor	8	Sipas kërkesave
9	Nentor	1	Sistemim në Profil
Gjithsej 2017-2018		44	

Të gjitha lëvizjet / transferimet janë realizuar nga drejtuesit e institucioneve arsimore, në kohë dhe periudha të ndryshme, kryesisht në fillim deri në mes të vitit mësimor.

Sa më sipër, DARQT dhe Komisioni i Vlerësimit kanë lejuar institucionet arsimore të kryejnë transferimet e punonjësve mësimorë edhe gjatë vitit, ndryshe sa përcakton Udhëzimit të MAS nr. 38/2015,

Duke analizuar në tërësi e tij, Udhëzimin nr. 38/ 2015, konstatohen disa probleme në funksionimin e tij dhe disa aspekte që mund të përmiresohen. Konstatohen këto probleme / aspekte për përmirësim të dispozitivit të emërimeve në arsim, si vijon:

- I. Në kreun 2, pika 2** të Udhëzimit të MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, ku trajtohet dokumentacioni që duhet të përmbajë dosjet e aplikimit për mësues, përcaktohet që:

”Dosja e aplikimit për mësues përmban:

- a. Curriculum Vitae sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi,*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

- b. Raport mjeko-ligjor (i tremuajve të fundit dhe **i detyrueshëm**),
- c. Deklaratë për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi,
- d. Vërtetim të qendrës së banimit (**i detyrueshëm**),
- e. Fotokopje të librezës së punës,
- f. Fotokopje të diplomës dhe vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli I+II dhe DIND), të noterizuar (**i detyrueshëm**),
- g. Fotokopje të licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit.
- h. Fotokopje e certifikatave të trajnimeve (paraqiten kopje të certifikatave të akredituara nga MAS dhe ato jashtë vendit),
- i. Fotokopje e dëshmive të shkallëve të kualifikimit,
- j. Fotokopje të noterizuar të dëshmive të kualifikimeve shkencore, (gradë ose titull akademik/ shkencor),
- k. Fotokopje të dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja, të noterizuar,
- l. Botime, kumtesa dhe publikime në fushën e edukimit. Kopje të faqes së parë, ku identifikohet titulli dhe njësia publikuese,
- m. Deklaratë nga kandidati për autorizimin e njësisë arsimore vendore që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura (sipas shtojcës 2).

Pra, në tre raste për aplikantët **kërkohen dokumenta fotokopje të pa vërtetuara nga noteri**. Konkretisht, në pikën “e” shkruhet: Fotokopje e librezës së punës, në pikën “g” Fotokopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, në pikën “i”, Fotokopje e dëshmisë së kualifikimit.

II. Në kreun 2, pika 3, ku bëhet fjalë për **dokumentet e detyrueshëm** të cilat sjellin dhe **skualifikimin** nëse së paku njëri prej tyre mungon, janë parashikuar këto dokumenta:

- b.Raport mjeko-ligjor;
- d.Vërtetim i qendrës së banimit;
- f.Fotokopje të diplomës dhe shtojcave.

III. Në kreun 4, pika 7, “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesve”, të Udhëzimit të MAS nr.38, datë 06.10.2015 përcaktohet se, “Kandidati nuk mund të refuzojë më shumë se tri vende pune të lira në tri njoftime të njëpasnjëshme të komisionit”.

IV. Në kreun 7, pika 1, Shqyrtimi i kërkesave për lëvizje paralele, lëvizje paralele të detyrueshme dhe ulje në detyrë”, është vendosur që: “Të gjithë mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, bëjnë kërkesë në njësinë arsimore vendore për lëvizje paralele të detyrueshme brenda **muajit maj**...”

V. Në kreun 7, pika 3 shkruhet: “Komisioni i Vlerësimit në njësinë arsimore vendore, brenda muajit gusht, bën vlerësimin e dosjeve”.

II. Në kreun 2, pika 3, ku mbëhet fjalë për dokumentet e detyrueshëm të cilat sjellin dhe skualifikimin nëse mungon janë parashikuar këto dokumenta: b.Raport mjeko ligjor; d.vërtetim i qendrës së banimit; f.Fotokopje të diplomës dhe shtojcave.

III. Në kreun 4, pika 7, “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesve” po të udhëzimit të MAS nr.38, datë 06.10.2015 “ Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar ” shkruhet: Kandidati nuk mund



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

të refuzojë më shumë se tri vende pune të lira në tri njoftime të njëpasnjëshme të komisionit.

- IV. Në kreun 7, pika 1,” Shqyrtimi i kërkesave për lëvizje paralele, lëvizje paralele të detyrueshme dhe ulje në detyrë” shkruhet: Të gjithë mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, bëjnë kërkesë në njësinë arsimore vendore për lëvizje paralele të detyrueshme brenda muajit maj. Në kreun 7, pika 3 shkruhet: Komisioni i Vlerësimit në njësinë arsimore vendore, brenda **muajit gusht**, bën vlerësimin e dosjeve.

Nga ana e DARQT për këtë çështje në observacionet e dërguara me shkresën nr. 372 prot, datë 29.02.2018 , “Dërgohen sqarimet për projektraportin e dërguar nga KLSH”, (prot në KLSH me nr 1307/4, datë 28.02.2018) ka bërë komente dhe shpjegime si më poshtë:

1. Në faqe 54 në lidhje me portalin “Mësues për Shqipërinë” ju sqarojmë se **shqetësimet të ngritura nga ju qëndrojnë** por veprimet tona janë të kufizuara për arsye të kopetencave që ka MASR .Për sa themi për publikimin nga portali nuk është detyrë e DAR Qarku Tiranë por e MASR. Mos dokumentimi i telefonatave për lajmërimin e punonjësve që janë renditur në portal dhe që janë lajmëruar për të filluar punë si mësues **është mungesë** por në vijim do të ngrejmë komision të posacëm që të bëjë dokumentimin e komunikimeve të mësuesve që refuzojnë dhe kërkojmë nga ju që ta merni në konsideratë në Raportin Përfundimtar pasi në kushtet tona ne kemi shkolla në zona të thella që janë në kufi me Burrelin, Krujën, Elbasanin dhe Kavajën.

2. Po kështu **jemi dakort me konstatimet** mësues jashtë profilit, ju sqarojmë se distancat e largeta, mungesat për arsimin përkatës për mbarëvajtjen sa më të mirë të procesit mësimor na kanë detyruar të mbajmë dhe këtë kategori mësuesish. Kjo kategori mësuesish është mbajtur në punë me kontratë provizore sipas përcaktimeve të nenit 80, të “Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar” ku shprehimisht citohet: Mësuesi jo në profilin përkatës

1) Në mungesë të mësuesve-aplikantë me arsimin përkatës, shqyrtohen për t’u pranuar mësues jo në profilin përkatës.

2) Mësuesi jo në profilin përkatës: a) punon me kontratë pune me afat; b) emërohet dhe largohet nga drejtori i shkollës pas pëlqimit nga këshilli i mësuesve.

3) Drejtori e largon nga shkolla mësuesin jo në profilin përkatës kur për vendin e tij aplikon një mësues në profilin përkatës.

3. Komisioni i vlerësimit në zbatim të rekomandimit në faqe 18 ka plotësuar dokumentacionin që ka të bëjë me aspektet e punës së komisionit duke evidentuar refuzimet dhe mundësitë e ofruar kandidatëve të rankuar në renditjen e portalit “Mësues për Shqipërinë”. Megjithatë theksojmë faktin se, njoftimet e bëra sipas rekomandimit tuaj, mësuesve që janë në radhë në listë pritje, me email në 97% të raste ,adresat e tyre nuk janë funksionale. Komisioni ka vepruar duke komunikuar me telefon dhe sms por një pjesë e konsiderueshme nuk paraqiten për të deklaruar refuzimin e vëndit të ofruar, kjo për shkak të largësisë të kandidatëve pasi vëndbanimi i tyre është jashtë Tiranës. Theksojmë se një pjesë e adresave të email dhe telefonave janë jashtë shërbimit. Nënvizojmë faktin se është zbatuar me korektësi merita sipas rankimit përfundimtar dhe nuk ka patur asnjë kontestim në të gjitha portalet.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar me objeksionet, grupi i auditimit nënvizon se një pjesë e mosveprimeve lidhen me MASr dhe udhëzimin përkatës , por nga ana tjetër mjaft



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

aspekte ngarkojnë me përgjegjesi Komsionin e vlerësimit të DARQT, ndaj ky koment i institucionit arsimor nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

PËRFUNDIME :

1. DARQT ka administruar procedurat për emërimet dhe largimet e tyre bazuar në kërkesat e Udhëzimit të MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”. Siç theksohet dhe në “Raportin e Arritjeve Shtator 2013 -Dhjetor 2016”, i Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA), **“Testimi kombëtar “Mësues për Shqipërinë” shërbeu për të lehtësuar procesin e zëvendësimit të mësuesve pa arsimin e duhur, me mësues me arsimin përkatës, të rekrutuar mbi bazën e meritës, konkurrencës dhe transparencës. Ky proces u realizua në dhjetor të viteve 2014 dhe 2015”**.
2. Në DARQT, sistemi i punësimit të mësuesve për zonat urbane dhe ato të cilat kapen nga transporti është mbështetur kryesisht në listat e mësuesve të portalit, ndërsa për **zonat e thella janë realizuar rilidhje të kontratave të mëparshme**.
3. DARQT, ndonëse ka realizuar punësimet e **16,6 %** e kandidatëve që kanë konkurruar nëpërmjet këtyre dy portaleve janë sistemuar me kontratë punësimi definitive, (ose **25 %** janë punësuar nga pozicioni definitiv dhe zëvendësues) për **2 portalet** e kryera (2015-2016 dhe 2016-2017), ende **ka një numër të lartë të kandidatëve të pasistemuar**.
4. Në DARQT, për periudhën janar-dhjetor 2016 rezultojnë **31 punonjës gjithsej**, naga të cilët, **17** prej tyre janë pa arsimin përkatës dhe **14** janë mësues jashtë profili.
5. Praktika e procedurave për lëvizjet paralele në nivel qarku, **nuk** është bërë vetëm në mbyllje të vitit shkollor, siç përcaktohet në Udhëzimin nr. 38/2015.
6. Komisionet e vlerësimit nuk kanë administruar si duhet shpalljen e listës së pozicioneve të lira të përhershëm/përkohshëm, të krijuar gjatë vitit dhe në përfundim të vitit mësimor, siç përcaktohet në Kreun 9, pika 1 të udhëzimit nr. 38; kërkesat për lëvizje paralele apo plotësimin e vendeve të punës me mësues jashtë portalit, si dhe kërkesat nga shkollat për krijimin e vendeve të lira.
7. Komisioni i Vlerësimit nuk ka bërë monitorimin e punësimeve në vijimësi në DAR/ZA-në përkatëse, si dhe raportimet 3-mujore në MAS, siç përcaktohet në Kreun 5, pika 5/g, të udhëzimit nr. 38, të MAS.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në përgjithësi ka një sistem funksional të konkurimit dhe emërimeve, por kërkohet një vëmendje e shtuar për korrigjimin e mangësive dhe parregullsive të referuar më lartë.

IV. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi e komunikimi, monitorimi.

Përmbushja e qëllimeve, objektivave të njësisë publike dhe caktimi i nëpunësit autorizues. Hartimi i politikave, miratimi dhe monitorimi i objektivave të njësisë publike, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arrijtjen e objektivave. Miratimi i rregullave specifike mbi procedurat për ruajtjen, mbrojtjen e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nëse është hartuar vetëvlerësimi, nëse është hartuar dhe depozituar te Ministri i Financave deklarata vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon, duke respektuar afatet në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

U shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

1. Strukturat përgjegjëse të DAR Qark, kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin për MFK-në, (miratuar me urdhërin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010) dhe Manualin e ri, (miratuar me urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016) si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Politikat institucionale janë bazuar në Strategjinë e zhvillimit të Arsimit.

2. Nga ana e Drejtorit të DAR Qark, **nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për v.2015**, në cilësinë e një Komiteti që duhet të evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, duk vepruar në kundërshtim me përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit “Për MFK”. *Më konkretisht:*

Manuali i MFK, ka përcaktuar se:

Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të veprojë si një komitet, ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut. Ai duhet të këshillojë Nëpunësin Autorizues mbi përmbajtjen e raportit vjetor për efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut.

Gjithashtu, pika 4.2.9 e Manualit (faqe 84) nënvizon se: “Çdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë....Grupi për Menaxhimin Strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë.

Edhe në kreun II, pika 2.2.6 të Manualit të ri të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, nënvizohet se:

“GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike”.

Kjo gjendje është **korigjuar** me Urdhërin e Drejtorit të DARQT nr. 21, datë 10.03.2016, me përbërje [REDAKTUAR]. Intervistuar nga ekipi i auditimit, anëtarët e GMS shprehen se ka diskutuar mbi ecurinë e shpenzimit të fondeve Nuk ka produkte të dokumentuara të veprimtarisë së GMS për periudhën objekt auditimi.

3. Nga auditimi i kryer në lidhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet e politikave vijuese të dala në zbatim të tij, konstatohet se ekzistojnë disa mangësi:

DAR ushtron veprimtarinë mbështetur në nenin 30 “Njësitë arsimore vendore”, të **ligjit nr. 69/2012**, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”) si dhe **Rregulloren**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

e brendshme e organizimit dhe funksionimit të DAR, në fuqi për periudhën objekt auditimi dhe aktualisht. *Konkretisht:* Rregullorja e brendshme e funksionimit të DAR QARK Tiranë, është miratuar me Urdhërin e Drejtorit të DARQ **nr. 233, datë 31.1.2014** dhe trajtohen misioni, veprimtaria, kompetencat, organizimi i strukturave, e drejta e emërimit dhe largimit nga puna të punonjësve, funksionet dhe detyrat e titullarit dhe specilaistëve, komunikimi i dokumentacionit, etj.

Sipas Vendimit nr. **66, datë 3.2.2010**, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Drejtorive Rajonale dhe Zyrave Arsimore”, në pikën 7 të tij, përcaktohet se, **“Ministri i Arsimit dhe Shkencës, miraton rregulloret e brendshme të funksionimit të drejtorive arsimore rajonale dhe të zyrave arsimore”**.

Në zbatim të këtij përcaktimi, është miratuar nga ministri një rregullore tip, me nr.311/1 prot., datë 18.1.2011, “Rregullore për funksionimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Zyrës Arsimore”, e cila u është dërguar drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore, nëpërmjet Udhëzimit nr.3, datë 18.1.2011, të Ministrit, “Për rregulloren e funksionimit të Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Zyrës Arsimore”. Në nenin 26 të këtij akti rregullator, është përcaktuar se, **“Drejtori i DAR-it miraton rregulloren e brendshme të DAR-it dhe të ZA-së përkatëse”**.

Mbi këtë bazë, është hartuar dhe miratuar nga titullari i institucionit të audituar, rregullorja e brendshme, ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore për çdo sektor, sipas strukturës dhe organikës së institucionit, në përputhje me misionin dhe objektivat e tij. Por, konstatohet se, në këtë akt, **nuk janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në fushën e manxhimit të financave, kontrollit të brendshëm financiar publik, dispozitave në fushën e shërbimit civil, etj.** Duke analizuar përmbajtjen e ligjit që rregullon fushën e arsimit parauniversitar, si dhe rregulloren e brendshme të institucionit, konstatohet se Drejtoria Arsimore, funksionon mbi bazën e akteve ligjore e nënligjore si dhe të strukturave, të cilat **nuk janë sjellë në koherencë me legjislacionin e shërbimit civil dhe ligjin organik që rregullon funksionimin e tyre, ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.**

Konstatime:

3.1. Këto akte nuk janë në koherencë me dispozitat ligjore që normojnë kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar publik, pasi rregullorja nuk është rishikuar pas miratimit të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015.

3.2. Në nenin 26, të Rregullores Tip, miratuar nga Ministri MASH me Urdhërin nr. 3, datë 18.01.2011, “Rregullore e brendshme e DAR-it dhe e ZA-së”, nënvizohet se:

“Drejtori i DAR-it miraton Rregulloren e Brendshme të DAR-it dhe të ZA-së përkatëse”.

Ky përcaktim është në kundërshtim dhe tejkalim të përcaktimeve të pikës nr.7, të VKM nr. **66, datë 3.2.2010**, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Drejtorive Rajonale dhe Zyrave Arsimore”, që shpreh se,

“Ministri i Arsimit dhe Shkencës, miraton rregulloret e brendshme të funksionimit të drejtorive arsimore rajonale dhe të zyrave arsimore”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk ngarkon Ministrin për miratimin e rregullores tip dhe nuk ngarkon drejtorët e DAR-it të miratojnë rregulloret e juridiksionit të tyre, por ka vendosur miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të çdo DAR dhe ZA nga Ministri përgjegjës për arsimin. Nga ana tjetër, rregullorja tip është e v.2011 dhe nuk është përditësuar.

3.3. Këto akte nuk janë të harmonizuara midis tyre. Kjo sepse, Rregullorja është hartuar në bazë dhe në detyrim të ligjit nr. 7592, datë 21.06.1995, që është dispozitë e shfuqizuar nga ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

3.4. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të DARQ Tiranë, nuk ka të inkuadruar parimet bazë të etikës. Në ëeb të këtij institucioni është vendosur Kodi i Etikës për mësuesit në arsimin parauniversitar publik e privat, i miratuar me urdhërin e ish-Ministrit të MASH me nr. 6222, dtë 12.11.2012. Institucioni ka hartuar Kodin e Etikës për punonjësit e DARQT, (miratar me urdhërin e drejtorit nr. 260, datë 27.01.2015) për punonjësit e Drejtorisë Arsimore Vendore, në bazë të detyrimeve të nenit 20, të ligjit 10296/2010, i ndryshuar, që përcakton se:

“Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

2. Mjedisi i kontrollit përmban:

a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; ...etj”

4. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ) për DARQT, si vijon:

Caktimi i nëpunësit autorizues dhe zbatues është kryer për çdo vit. Me shkresën nr. 974 prot, datë 29.10.2013 i është dërguar Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit) dhe Degës së Thesarit Tiranë, caktimi i NA () dhe caktimi i NZ dhe këto informacione i janë dërguar Degës së Thesarit Tiranë.

Në funksion të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, (neni 12), nëpunësi zbatues, është niveli menaxherial në vartësi direkte të drejtorit të institucionit. Në funksionet e tij, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Aktualisht kryen funksionet e përcaktuara më sipër dhe është në vartësi direkte të Drejtorit të Arsimit. Sa më sipër, janë përmbushur kërkesat e Nenit 12/1, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar,

5. Nga ana e institucionit janë përgatitur Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm për vitin 2015 (dërguar mASR me shkresn nr. 149 prot, datë 29.01.2016, ndërsa për vitin 2016 nuk u dorëzua një praktikë e tillë. Për v.2017 afati i plotësimit dhe dërgimit të tyre sipas Manualit të MFK është deri me datën 28 shkurt 2018. Këto akte janë nënshkruar nga drejtori i DARQT dhe i janë dërguar Ministrisë së Arsimit.

Për vitin 2015:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Në përgjigje të shkresës së MAS, nr.10667/1 prot, datë 31.12.2015, nga ana e DAR është dërguar pyetësori i vetëvlerësimit mbi gjendjen e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në DARQT me nr. 195 prot, datë 29.01.2016. ***Janë hartuar deklarata mbi sistemin dhe raportit përkatës për cilësinë kontrolleve të brendshme për vitin.***

Për vitin 2016:

Është hartuar pyetësori i vetëvlerësimit për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në përgjigje të shkresës së MAS, nr.12414/1 prot, datë 30.12.2016, dhe me shkresën nr.149 prot, datë 27.01.2017 i është përcjellë Drejtorisë së Financës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, krahas Deklaratës së nëpunësit autorizues për cilësinë e sistemit të kontrollit, në bazë të përgjegjësisë të kreut III, pika 3.3 e Manualit PMFK dhe cilësimeve të nenit 18 të ligjit nr.10296.

Për vitin 2017:

Është hartuar pyetësori i vetëvlerësimit për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në përgjigje të shkresës së dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i MAS.

Nga misioni i auditimit vërehet se Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm është dorëzuar brenda afatit ligjor, përcaktuar në nenin 18, të ligjit dhe pikat nr. 4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se “*deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave*”

Raporti mbi sistemet e kontrollit të brendshëm është i paplotë dhe nuk ka respektuar strukturën e parashikuar sipas manualit të MFK dhe detyrimet e pikës nr. 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr .28, datë 15.11.2008, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Nga analiza e hollësishme e këtij dokumenti vërejmë se:

-Ky raport është përgatitur nga ana e NA, në koordinim me hallkat e tjera të këtij institucioni.
-Raporti ka sintetizuar arritjet dhe mangësitë e konstatuara në procesin e MFK duke listuar dhe disa rekomandime për përmirësim gjatë periudhave të ardhshme.
- Nga analiza e rubrikave të plotësuara të Pyetësorit sipas komponentëve mbi MFK, vlerësojmë se vlerësimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm (SKB) & Menaxhimit Financiar (Mf) janë kryer me pikë (1-3), por për vitin **2015 dhe 2016, nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e pikës nr. 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pasi Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka të përfshira gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe nuk referon një plan veprimi për të ardhmen, sikundër parashikohet në këtë udhëzim:**

“ Raporti duhet të strukturohet sipas formatit të përshkruar në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi, i cili përbëhet nga:

- (a) Përmbledhja ekzekutive;*
- (b) Vlerësimi i sistemit ekzistues të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë;*
- (c) Gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe i jDAR Qark Tiranëtëm;*
- (ç) Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan-veprimin për të ardhmen;*
- (d) Rekomandime të përgjithshme për Ministrinë e Financave, lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.”*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Grupi i auditimit të KLSH u fokusua në realizimin e objektivave të institucionit dhe përdorimin me efektivitet të fondeve të tij, për të gjithë komponentët si “mjedisi i kontrollit”, “menaxhimi i riskut”, “aktivitetet e kontrollit”, “informimi dhe komunikimi” dhe “monitorimi”. Nga shqyrtimi i **plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit** kanë rezultuar disa mangësi, pasi nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e kapitullit V, të Manualit për MFK. Analiza e të dhënave të pyetësorëve tregon se, nëpunësi autorizues dhe zbatues janë mjaftuar vetëm me vendosjen e pikëve sipas kriterëve të vetëvlerësimit (numrat nga 1-3 për çdo çështje), **pa i shoqëruar shumicën e rubrikave të pyetësorit me përgjigjet ose komentet respektive**, siç cilësohet në Kapitullin III, Hapi III, kreu “Procesi i Implementimit të MFK” dhe kreun V, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010, i ndryshuar.

6. Nga auditimi i detyrimeve që burojnë në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të DAR Qark Tiranë, (parashikuar në pikën 8, neni 8, të ligjit nr.10296), konstatohet se, kanë gjetur zbatim detyrimet që lidhen me:

-hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të Institucionit, të planeve vjetore dhe plan-veprimet për arritjen e objektivave;

-miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

-miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësi të tyre;

Njësia nuk ka funksionin e auditimit të brendshëm dhe këto shërbime janë kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të MAS. Auditimi i fundit i Ministrisë, është realizuar sipas programit nr. 11296/1 prot, datë 11.11.2016, ndërsa përfundimet janë dërguar nga Ministri i Arsimit me shkresën nr. 11296/3 prot, datë 06.02.2017. Ky angazhim ka përfshirë periudhën 30.08.2014 deri më 31.10.2016.

▪ ***Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të buxhetit rezultoi se:***

Procedurat e buxhetimit kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në dispozitat ligjore të buxhetit të shtetit. Treguesit e detajuar buxhetorë të hartuar nga DAR Qark Tiranë janë diskutuar e analizuar në MASH dhe MF. Procedurat për hartimin e projekt-buxhetit i janë referuar akteve ligjore për hartimin dhe zbatimin e buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrit të Financave. *Nga auditimi u konstatua se:*

- Nga institucioni për periudhën objekt auditimi është dërguar vetëm faza e dytë e Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm, duke mos dorëzuar në MAS fazën e I të planifikimit të buxhetit afatmesëm, në kundërshtim me Kapitullin III, të udhëzimit të MoF nr. 23, datë 22.11.2016 “Për përgatitjen e programve buxhetore afatmesëm”.

- Raporti i monitorimit për periudhën objekt auditimi si dhe raportet periodike që DARQT i ka dorëzuar MAS, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, në kundërshtim me kreun IV “Monitorimi” të Udhëzimit plotësues të MoF nr. 1, dt. 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

▪ ***Nga analiza e sistemit të kontrolleve të kontabilitetit rezultoi:***

Janë hartuar rregullat bazë për organizmin kontabël dhe administrimin e pasurisë. Veprimet financiare janë autorizuar sipas rregulloreve dhe janë regjistruar e dokumentuar rast pas rasti.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël nuk është mbështetur në parimin e kontabilitetit rrjedhës, pra mbi bazën e angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara. Procedurat e inventarizimit dhe vleresimit për dalje jashtë përdorimit si dhe asgjësimi janë kryer dy herë rradhazi nga i njëjti komision, në kundërshtim me *paragrafin* nr. 84, të Udhëzimit të MoF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

7. Audituesit e KLSH-së konstatojnë se janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e **Regjistrit të Risqeve**, monitorimin e kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Në institucionin e DAR Qark është hartuar regjistri i riskut ku janë evidentuar risqet para kontrollit dhe përfshin zotëruesit e këtyre risqeve, si Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektorin e TIK, Sektorin e Programim Zhvillimit.

Konstatohet se:

1. *Ky dokument është hartuar për vitin 2015, (me nr. 195 prot, datë 29.01.2016) dhe nuk është përditësuar.*
2. *Nuk janë pjesë e këtij rregjistri aktivitetet që realizon Sektori i Kurrikulës dhe Cilësisë, për kërcënimin e objektivave themelore të këtij sektori, (përfshij mangësitë dhe parregullsitë në zbatimin e kërkesave të portalit “Mësues për Shqipërinë).*
3. *Nuk parashikohet niveli i ri i risqeve pas aplikimit të kontroleve, referuar programit buxhetor afatmesëm, etj.*

9. Për periudhën objekt auditimi, **nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve**, detyrimi i **neneve 8 (pika 8/a), 10 dhe 21 (pika 2)**, të ligjit nr. 10296. Në mënyrë më të detajuar, përgjegjshmëria e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, rregullohet nga kjo dispozitë ligjore si më poshtë vijon:

“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

- a) *hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;*
- b) *ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;*

Neni 21. Menaxhimi i riskut:

2. *Për t’i zbatuar veprimtaritë e partruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*

si dhe përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 të Manualit të MFK, miratuar me urdherin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016:

“Çdo NjQQ dhe NjQV duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut që përditësohet rregullisht (çdo tre vjet) ose kur në mjedisin e riskut ndodhin ndryshime të rëndësishme. Strategjia duhet të përgatitet nga NA në cilësinë e KR. Titullari i njësisë miraton strategjinë e menaxhimit të riskut. NA analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

8. Grupi i auditimi konstaton se në institucion nuk ka dhomë të serverave, administrimi i të dhënave kryhet nga Sektori i TIK. **Sistemi i teknologjisë së informacionit** siguron një procedurë për hedhjen e të dhënave (data base) në një sistem rezervë, automatik e të sinkronizuar (backup). Kjo realizohet përmes një procedure të posaçme backup i jashtëm dhe njëjohësisht dokumentet ruhen në “google drive”, gjë që mundëson ruajtjen e një kopje të informacionit. Nga ana e institucionit zbatohet rregullorja specifike: rregullorja për përdorimin e postës elektronike dhe rregullorja e përdorimit të internetit në DAR, (trajtuar në nenet 20 “Komunikimi elektronik” dhe 33 “Detyrat e sektorit të TIK”, të Rregullores aktuale të organizimit dhe funksionimit të DARQT. Përsa i takon mbrojtjes së informacionit të përdoruesve dhe kontrollit periodik të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar, institucioni zbaton udhëzimet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për këtë qëllim. Nga DARQT është hartuar Rregullorja për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit, miratuar nga Drejtori i DAR, znj. [REDAKTUAR]

9. Nga ana e DARQ zbatohen rregullat dhe **procedurat për mbrojtjen e aktiveve**, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa “ç”, të ligjit nr. 10296/2010. Në pajtim me detyrimet e pikës nr. 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, titullari i njësisë publike ka miratuar rregullat dhe procedurat për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. Konstatohet se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, është hartuar regjistri i aseteve, detyrim nga pika nr. 26, kreu III, e Udhëzimit të MoF nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të kreut IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, janë iniciuar procedurat e **inventarizimit të pasurisë** dhe të drejtave e detyrimeve 1 herë në vit, sipas urdhrave të veçantë të Drejtorit të DAR, trajtuar tek kapitulli mbi kontabilitetin dhe bilancin kontabël vjetor.

10. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 16, të ligjit nr.10296/2010, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik për **përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit**, ku shprehimisht përcaktohet:

“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”.

Nga ana tjetër, u verifikuar zbatimi i kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016), mbi **përgatitja e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës**. Këto manuale garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Auditimi i KLSH-së vëren se, ka një **moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së përshtatshëm të proceseve të punës**. Jo vetëm kaq, por përshtatshmi i procesit të punës **konfundohej me përshtatshmin e pozicionit të punës**. Për të bërë të mundur që çdo institucion të përgatisë manualin e proceseve të punës. struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave ka



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

përgatitur dhe një format standard për të asistuar institucionet për ta realizuar këtë proces në vazhdimësi.

Nga auditimi u verifikua respektimi i kërkesave ligjore në **hartimin e formularit të përshkrimit të punës**, në mbështetje të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, si dhe pikës nr. 4.1.1., kreu IV, të Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike (DAP) nr. 2, datë 7.4.2014, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në pikën 14, të Kreut IV, “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”, të VKM-së nr.142, datë 12.3.2014, të ndryshuar, përcaktohet se: **“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”**. Nga sa më sipër, me fillimin e efekteve juridike të legjislacionit të ri të shërbimit civil, DARQT, si institucion i administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil, ka hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas afateve të përcaktuara në aktin nënligjor. Formulari i përshkrimit të punës është nënshkruar nga punonjësi dhe drejtuesi i DAR-it, por nuk është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MASH.

Konstatohet se:

1. Në nenin 27, “Përshkrimi i vendeve të punës”, të Rregullores së Brendshme tip, miratuar nga Ministri MASH me nr. 311/1, datë 18.1.2011, është përcaktuar se:

“Drejtori i DAR-it/ përgjegjësi i ZA-së miratojnë përshkrimin e vendit të punës për secilin punonjës. Në përshkrimin e vendit të punës së përgjegjësit të sektorit parashikohet që në një pjesë të kohës kryen detyra si specialisti sektorit”.

Konstatohet se, këto përcaktime të Rregullores së brendshme **nuk përputhen me kërkesat e pikës 18, germa “c”, kreu IV, të VKM nr. 142/2014** “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, sipas së cilës, **përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë. Konkretisht:**

“Përshkrimi i punës miratohet nga:

- a) sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për Kryeministrinë dhe institucionet në varësi të Kryeministrit;*
- b) sekretari i Përgjithshëm i institucionit të pavarur, për institucionet e pavarura;*
- c) sekretari i Përgjithshëm i ministrisë, për ministrinë dhe institucionet në varësi të ministrit;*
- ç) sekretari i Përgjithshëm apo pozicioni ekuivalent me të, për njësitë e qeverisjes vendore.”*

Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe KB:

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

a. Vendosja e objektivave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Për periudhën objekt auditimi, DAR Qark Tiranë ka funksionuar në bazë të ligjit për sistemin arsimor parauniversitar. Në nenin 4, “Misioni i DAR-it dhe i ZA-së”, të Rregullores së organizimit dhe funksionimit, ka përcaktuar deklaratën e misionit të njësisë në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Deklarata e misionit, është hartuar në përputhje me nenin 3 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin e arsimit parauniversitar në RSH”, të ndryshuar dhe jepet përmes këtij formulimi:

“DAR-i ka për mision mbështetjen e shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në territorin që ka nën juridiksionin e saj. ZA-ja ka për mision mbështetjen e shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në territorin që administron”.

Sa sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e Manualit të MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010, (i ndryshuar), ka përcaktuar në kapitullin e III, detyrimet në lidhje me Deklaratën e misionit dhe vizionit.

b. Etika personale dhe profesionale.

Njësia buxhetore në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, ka hartuar rregulloren (“Kodi i Etikës për DARQT”), miratuar me urdhërin e drejtorit znj.E.Metani, me nr. 260, datë 27.01.2015. Sa sipër, institucioni disponon procedura të shkruara për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

c. Struktura organizative.

Për periudhën e audituar (shtator 2005-dhjetor 2017), si bazë ka shërbyer Urdhëri i Kryeministrit nr. 199, datë 01.12.2010, për miratimin e strukturave organizative me 20 punonjës.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me dispozitat e ligjit për shërbimin civil, ndërsa personeli mbështetës në bazë të kodit të punës. Në bazë të ligjit për kodin e punës dhe dispozitave të tjera ligjore si, ligji për buxhetin e shtetit, ligji për arsiminparauniversitar dhe aktet e dala në zbatim të tij, ligji për prokurimin publik, kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, etj., lejon menaxherin e institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave, të ndërmarrë hapat e duhura. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga eprorët, apo drejtuesi i DARQT.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, janë përcaktuar përgjegjësitë për çdo zyrë dhe punonjës.


Konstatohet se, pjesë e organigramës së miratuar për DARQT janë ZA Kamëz dhe Kavajë, pas ndryshimit të kryer më VKM nr. 66, datë 03.02.2010. Në fakt, ato nuk janë pjesë e procesit të buxhetimit, kontabilizimit dhe deklaratave financiare vjetore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Organigrama e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë



Manuali i MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010, ka përcaktuar në kreun II, faqe 21 në lidhje me strukturat organike ka vendosur si parakushte :

- Një *procedure transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve*;
- *Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent*;
- Një *sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur*;
- Një *sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt*;

Njësia ka programin buxhetor, drejtues i të cilit është Titullari i institucionit, që është dhe nëpunësi autorizues. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit. **Për kryerjen e aktivitetit normal, institucionit i nevojiten disa ndryshime në organikë, duke shtuar pozicionet e magazinierit, detyrë të cilën e kryejnë punonjës të tjerë, dhe të arshivistit, pasi disponohet një numër i madh dokumentesh arkivore.**

Nga ana e kësaj njësie publike për vitin 2015 - 2017, rezulton të jenë kryer **vlerësime vjetore dhe periodike (6-mujore) të punës për punonjësit**, lidhur me detyrat që ata kryejnë, në në përputhje me përcaktimet e rregullores tip të DAR/ZA dhe VKM nr.109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil” dhe udhëzimit të DAP për vlerësimin e performancës së punonjësve.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale njësia **nuk disponon plane të trajnimeve (sidomos në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit), dhe mungon një data-base mbi trainimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik**, për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e pikas nr. 3/1 , nënçështja “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore”, të Kapitullit III të Manualit të MFK 2016, (fq. 26). Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime të stafit në drejtim të njësive njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimit të fondeve publike së njësisë menaxhuese. Moskryerja e trainimeve për punonjësit e DAR dhe Drejtorët e shkollave të arsimit parauniversitar, janë veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe në shkelje të Standardit Nr.1 të dokumentit “Standardet e Drejtorit”, lëshuar nga instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës [REDAKTUAR], me nr. 4296, datë 27.08.2013. Në këtë dokument shprehimisht përcaktohet se, “*Standardi nr.1 merret me aspektet themlore të organizimit dhe menxhimit të institucionit. Drejtori duhet të jetë i njohur me teoritë kryesore të drejtimit dhe menaxhimit të cilat lidhen direkt me punën e tij dhe duhet të jetë i përditësuar me praktikën e sukseshmë vendase e të huaja*”

Detyrime për trainimin e stafit dhe drejtorëve të shkollave mbi aspektet e menaxhimit financiar bëhet i domosdoshëm, për faktin se ato autorizojnë pagesat e mësuesve për orët mësimore sipas normës së miratuar dhe ato mbinormë, shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve, subvencionimin e teksteve shkollore për kategoritë vulnerabël, etj.

Gjatë vitit 2016, referuar të dhënave të raportit të analizës vjetore të DARQT, rezultojnë të jenë janë zhvilluar trajnime në institucione të specializuara (IZA) të 857 punonjësve arsimorë mbi implementimin e kurrikulës së re. Gjithashtu, në lidhje me implementimin e sistemit për digjitalizimin e të dhënave për sistemin arsimor parauniversitar (Sokrates), janë trainuar 132 koordinatorë, etj.

2.Vlerësimi i riskut (a bën njësi vlerësim risku, a është i plotë dhe përditësohet, a është i bazuar në analizë etj).

- Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezultojnë se në institucionin e DAR Qark Tiranë, janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontrolleve ekzistuese dhe nevojave për kontrolle të reja, ***por nuk janë hartuar për çdo zotërues e sektor, nuk është përditësuar regjistri i risqeve, nuk është caktuar koordinatori i risqeve dhe mungon një strategji me planin e veprimit për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.***

Auditimi konstaton se:

Vlerësimi i riskut është një **proces pak i zhvilluar** në metodologjitë e zbatuara në praktikë nga audituesit. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë sporadike dhe jo praktika të zakonshme të punës. Nga ana tjetër, për natyrën e veçantë të këtij subjekti publik, koncepti i “Menaxhimit të Riskut” dhe vendosjes së kontrolleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e DAR Qark Tiranë.

3.Aktivitetet e kontrollit: (a janë ndarë si duhet detyrat, a ka funksione të pajtueshme që kryhen nga i njëjti person, a dokumentohen si duhet plotë, të sakta e të kuptueshme transaksionet, a ka rregulla se si ruhen asetet, si përdoren si nxirren jashtë përdorimit, etj).

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësi lidhur me menaxhimin e aktiveve.Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi dhe pa mbivendosur detyrat. U konstatua se ekzistojnë dhe zbatohen procedurat përkatëse të shpallura mbi administrimin material të aktiveve, inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, etj.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Në DARQT proceset kryesore të punës operacionale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren për organizimin dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

funksionimin e institucionit. Nëpunësi autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor afatmesëm. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë.

Njësia ka një strukturë të posaçme të IT, (Sektori të Teknologjisë Informacionit dhe Komunikimit), e ngarkuar me mirëmbajtjen dhe kontrollimin e sistemit të IT.

Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit excel dhe nuk ka ndonjë soft financiar, që të përodret nga sektori i shërbimeve të përgjithëshme.

Janë miratuar në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 ”Për Arkivat” si të “Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, rregullat për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivor të fondkrijuesit, etj.

4. Informacioni dhe Komunikimi (a ka rregulla të shkruara ku bazohet komunikimi brenda njësisë, si zbatohen ato).

Drejtuesi i DAR, shefat e sektorëve dhe NZ i njësisë zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar. Titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithëshme, ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme tek nëpunësi autorizues, me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë është i mirë, ky kontroll u kushton vëmendje të veçantë shpenzimeve administrative, prokurimeve me fonde publike, ndjekjes së çështjeve të deleguara, etj.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë.

Në këtë institucion sistemi i IT-së, afron informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi dhe të strukturave të veçanta të saj, duke plotësuar nevojat e domosdoshme të punonjësve nëpërmjet komunikimit online, sigurimin e informacioneve në ëeb-site, etj.

Sistemi i IT-së, është i pajisur me një sistem rezervë (back-up) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ripërfitimin e tyre, në rast aksidenti. Institucioni komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

5. Monitorimi (a ka një sistem të monitorimit të përditshëm të të gjitha operacioneve të punës, a janë të specifikuara se cili autoritet është i ngarkuar për monitorimin dhe kujt i raporton).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Në DAR Qark Tiranë është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e zyrave që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike (me përjashtim të analizave vjetore) që institucioni i ka paraqitur në MARS, nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, gjithashtu edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, nëpërmjet lidhjes së vendosur në faqet zyrtare të DARQT dhe MASR.

Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut VI, paragrafi 257, nënpika 63 “Raportet e monitorimit”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku shprehimisht përcaktohet që:

“Raportet e monitorimit të buxhetit të publikohen në faqen zyrtare të çdo ministrie të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive.

Në DAR Qark Tiranë, titullari i njësisë informohet vazhdimisht nga drejtuesit dhe përgjegjësit e zyrave mbi aktivitetin e strukturave që ata drejojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve periodike (javore, mujore dhe tremujore), me shkrim, apo verbalisht.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në përgjithësi ka një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në institucionin e DARQT, por për përmirësimin e punës në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për korrigjimin e mangësive të referuar më lartë.

V. Auditim, mbi zbatimin e procedurave dhe kuadrit rregullativ për subvencionimin e librit shkollor.

- Çelja dhe likuidimi i fondeve për subvencionin e librit shkollor.

Drejtoria Arsimore Rajonale Qarku Tiranë, me NIPT –K51713043R, është subjekt në vartësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, ka mbledhur kërkesat për subvencion të librit nga shkollat në administrim të saj, ka bërë detajimin sipas programeve buxhetore dhe zyrtarisht ka kërkuar çeljen e fondeve për kompesimin e çmimit të tekseve shkollore të arsimit parauniversitar, sipas programeve buxhetore, artikulli 606 “transfertë për individët” për arsimin bazë, arsimin e mesëm dhe komunitetin rom.

Me shkresën nr.2703, datë 05.11.2015, shkresën nr 2058, datë 26.10.2016, shkresën nr.2374 datë 27.10.2017, Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit sot Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, ku argumenton kërkesën për subvencionim të librit shkollor sipas numrit të nxënësve përfitues për çdo shkollë dhe për çdo klasë të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm, për vitin 2015 kanë përfituar 3584 nxënës, për vitin 2016 kanë përfituar 3,741 nxënës, për vitin 2017 kanë përfituar 3,873 nxënës. Në numrin e nxënësve përfshihen edhe nxënësit e komunitetit rom të shkollave Yzberisht dhe Picallë, Vorë, Qesarakë, Ferraj, Ibë, Tufinë si dhe një nxënës, përfitues si fëmijë i policëve të rënë në detyrë .

Viti shkollor 2015-2016



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

- Për 2971 nxënës të 65 shkollave të arsimit bazë.....vlëra 7,893,888 lekë.
- Për 613 nxënës të 18 shkollave të arsimit të mesëm..... vlëra 2,770,511 lekë.

Viti shkollor 2016-2017

- Për 3.086 nxënës të 65 shkollave të arsimit bazë.....vlëra 9,012,101 lekë.
- Për 655. nxënës të 18 shkollave të arsimit të mesëm.....vlëra 3,820,476 lekë.

Viti shkollor 2017-2018

- Për 3,262 nxënës të 65 shkollave të arsimit bazë.....vlëra 10,549,321 lekë.
- Për 611 nxënës të 18 shkollave të arsimit të mesëm.....vlëra 3,458,052 lekë.

Llogaritja e fondit është bazuar në aktet përkatëse në fuqi:

VKM nr. 107, datë 10.02.2010 “Për botimi, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar” i ndryshuar, VKM Nr. 707 datë 26.08.2015.

Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave nr. 51, datë 20.09.2013 “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”, ndryshuar me udhëzimi nr. 35, datë 14.09.2015.

Pas celjes së fondeve, me urdhër të brendshëm të DARQT nr. 379, datë 13.11.2015, nr. 98, datë 09.12.2016, nr. 68, datë 09.11.2017 është urdhëruar transferi për pagesën e subvencionit të librit shkollor për nxënësit e arsimit parauniversitar për llogari të subjektit “Posta Shqiptare” sh.a Tiranë me vlerën 10,664,399 lekë për vitin 2015, me vlerë 12,668,205 lekë për vitin 2016, me vlerë 13,597,007 lekë për vitin 2017.

DARQT ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 2896, datë 18.11.2015, nr.2753 datë 05.12.2016, nr.1605, datë 09.11.2017 me subjektin “██████ Tiranë, e cila ka realizuar shërbimin financiar për rimbursimin e faturave të teksteve shkollore, sipas listave me emrat e përfituesve dhe shumën e kompesimit për çdo përfitues.

Me shkresën nr.3202, datë 07.12.2015, nr. 2869, datë 29.12.2016, nr. 2916, datë 19.12.2017, DARQT ka dërguar zyrtarisht pranë subjektit “██████ Tiranë, fondin e kompensimit sipas shkollave si dhe listat emërore të nxënësve përfitues për çdo shkollë.

Transferimi i fondit të subvencionit për **vitin 2015** është bërë sipas urdhër shpenzimit:

- Urdhër shpenzimi nr. 277, datë 25.11.2015vlëra 10,664,399 lekë.
 - Për arsimin e mesëm.....vlëra 2,770,511 lekë.
 - Për arsimin bazë.....vlëra 7,893,888 lekë.

Transferimi i fondit të subvencionit për **vitin 2016** është bërë sipas urdhër shpenzimit:

- Urdhër shpenzimi nr. 294 , datë 12.12.2016vlëra 12,668,205 lekë.
 - Për arsimin e mesëm.....vlëra 8.847.729 lekë.
 - Për arsimin bazë.....vlëra 3.820.476 lekë.

Transferimi i fondit të subvencionit për **vitin 2017** është bërë sipas urdhër shpenzimit:

- Urdhër shpenzimi nr. 288, datë 09.11.2017vlëra 13.597.007 lekë.
 - Për arsimin e mesëm.....vlëra 10.138.955 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Për arsimin bazë.....vlëra 3.458.052 lekë.

Subjekti “Posta Shqiptare” ka realizuar procesin e shpërndarjes së subvencionit të librit shkollor për vitin 2015, 2016, dhe është në process për vitin 2017. Në mbyllje të këtij procesi, me shkresën nr. 746, datë 22.04.2016, nr. 1079/1, datë 24.04.2017, ka njoftuar Drejtorinë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, për fondet e xhiruara, pagesat e kryera nga 18 zyrat postare dhe shumat që do ti rikthehen DARQT ku rezulton se:

Për vitin shkollor 2015-2016

Nga 43 nxënës përfitues të subvencionit, nuk janë tërhequr fondet për kompensimin të çmimit të blerjes së librit shkollor, në shumën 100,416 lekë. Shumat e patërhequra janë arkëtuar dhe derdhur në degën e thesarit për llogari të DARQT.

Për vitin shkollor 2016-2017

Nga 22 nxënës përfitues të subvencionit, nuk janë tërhequr fondet për kompensimin të çmimit të blerjes së librit shkollor, në shumën 42.227 lekë. Shumat e patërhequra janë arkëtuar dhe derdhur në degën e thesarit për llogari të DARQT.

Për vitin shkollor 2017-2018, nuk ka ardhur ende përgjigja nga subjekti “██████” për përfundimin e shpërndarjes së fondit të kompensimit të çmimit të blerjes së librit shkollor.

Për fondet e përdorura për subvencionimin e librit shkollor për vitin 2015, 2016 është mbajtur akt rakordimi nga DARQT, në lidhje me përdorimi e fondit të subvencionit si dhe të detyrimeve për të rikthyer vlerat e patërhequra nga subjekti “██████” sh.a Tiranë. Aktrakordimi është mbajtur nga përfaqësuesit e DARQT dhe subjektit “██████”, bashkëlidhur fatura tatimore e shitjes e plotësuar në të gjitha ekstraktet, lista me vlerat përkatëse të pa shpërndara nga filialet e postes si dhe shkresa përcjellëse me informacionin përkatës për MAS.

Nuk rezultojnë diferenca midis listë pagesave për çdo shkollë dhe përmbledhëses së hartuar nga DARQT.

Dokumentimi i llogaritjeve dhe pagesave për subvencionin e librit shkollor për kategoritë e nxënësve përfitues.

U auditua dokumentacioni i plotë për nxënësit përfitues përkatësisht:

- Për shkollën 9 vjeçare “Ndreq” për 59 nxënës;
- Për shkollën 9 vjeçare “Petrelë” për 39 nxënës;
- Për shkollën 9 vjeçare “Mangull” për 32 nxënës;
- Për shkollën 9 vjeçare “Shkallë” për 30 nxënës;
- Për shkollën 9 vjeçare “Vorë” për 77 nxënës;
- Për shkollën 9 vjeçare “Gropaj” për 43 nxënës;
- Për shkollën 9 vjeçare “Bërshull” për 55 nxënës;
- Për shkollën 9 vjeçare “Lundër” për 37 nxënës;
- Për shkollën 9 vjeçare “Yzberisht, Vorë, Mëzez Fushë dhe Picallë” për dokumentimin e dosjeve të nxënësve përfitues të komunitetit rom/egjiptian. nxënës;

Nga auditimi i dokumentacionit sa më sipër, konstatohet se:

Listat emërore të përfituesve të subvencionit janë dërguar elektronikisht nga drejtorët e shkollave tek sektori i financës në DARQT. Dokumentacioni justifikues është dërguar në sektorin e financës nëpërmjet protokollit. Listat emërore të shkollave për pagesat janë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

protokolluar nga shkollat, janë nënshkruar dhe vulosur nga drejtorët e shkollave sipas klasave dhe numrit të faturave tatimore të lëshuara nga shitësi

- Bashkëlidhur listave emërore të drejtorive të shkollave, referuar kategorive të përfituesve, është dokumentacioni justifikues si më poshtë:

Certifikata familjare, për fëmijët në ngarkim, për kryefamiliarët me pension pleqërie, etj.

Vërtetimet e shkollave.

Dokumentacion fotokopje për vërtetimin e anëtarit të familjes që përfiton nga KMCAP.

Dokumentacion fotokopje si punë kërkues të lëshuar zyra e punsimit.

Vërtetim për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë e papunësie nga zyrat e punësimit.

Dokument fotokopje për statusin e jetimit/statsin e të verbërve.

Për fëmijët rom/egjyptianë, listat e konfirmuar nga drejtori i shkollës dhe në disa raste të konfirmuara edhe nga shoqata e komunitetit rom.

Drejtorja Arsimore e Qarkut Tiranë, bazuar në dokumentacionin e mësipërm ka kryer likuidimin për subvencionimin. Dokumentacioni justifikues për nxënësit përfitues për sa më lart, është përcaktuar nga DARQT, në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave.

VI. Auditim, mbi zbatimin e procedurave dhe dispozitave në fuqi për transportin e mësuesve dhe nxënësve.

Auditimi u krye për vitet 4- muhori i fundit i vitit 2015, viti 2016 dhe viti 2017 duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

-Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

-Ligji nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor” i ndryshuar,

- Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016 datë 02.06.2016,

-Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 66 datë 07.02.2007 Për disa ndryshime në Vendimin nr.146, datë 26.02.1998 të Këshilli të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve” të ndryshuar

-Vendimi nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e Fondeve Publike Për Transportin e Punonjësve Arsimore që Punojnë dhe të nxënësve që Mësojnë Jashtë Vendlbanimit”

-Vendimi nr.398, datë 03.05.2017 “Për disa ndryshime në vendimin nr/ 682, datë 29.07.2015

-Udhëzimi nr. 22 datë 29.05.2008 “Për Përdorimin e Fondeve të Planifikuara për Transportin e Mësuesve dhe të nxënësve që Mësojnë e Punojnë Larg Vendlbanimit të Trye”.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për periudhën e sipërcituar rezultoi si më poshtë vijon:

Drejtorja Arsimore Rajonale e Qarkut të Tiranës, nëpërmjet buxhetit të shtetit përballon shpenzimet e transportit, për punonjësit arsimorë të arsimit parauniversitar , ku përfshihen:

a) punonjësit të arsimit parashkollor,

b) arsimit fillor,

c) arsimit të mesëm, të ulët dhe arsimit të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues edukator), të institucioneve arsimore publike, të cilët punojnë jashtë qendrave urbane, qyteti/fshati, larg vendlbanimit të përhershëm të tyre, në largësi mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës në vendlbanim. Nxënësit që udhëtojnë nga vendlbanimi i përhershëm në një vendlbanim tjetër, si dhe nxënësit të arsimit parauniversitar të cilët janë më aftësi të kufizuar që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike në një largësi mbi 2 km



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht) gjithashtu përfitojnë nga shteti, mbulimin e transportit.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me njësitë arsimore (drejtorit rajonale arsimore/zyrat arsimore) miratojnë hartën e linjave, mbështetur në numrin e punonjësve mësimorë, nxënësve dhe fëmijëve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, si mësipërm përmendur. Njësitë arsimore pas hartimit të listave të përfituesve, i konfirmojnë ato në vetëqeverisjen vendore për distancat nga vendbanimi i përhershëm. Nga ana e DARQ Tiranë në lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit të tyre, i janë paraqitur kërkesat Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për vitet 2015, 2016 dhe 2017 dhe nga ky institucion janë akorduar fondet nga buxheti i shtetit për këtë zë (për të kompensuar vlefën e shpenzimeve të udhëtimit në zbatim të VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e Fondeve Publike Për Transportin e Punonjësve Arsimore që Punojnë dhe të nxënësve që Mësojnë Jashtë Vendbanimit” i ndryshuar me Vendimi nr.398, datë 03.05.2017 “Për disa ndryshime në vendimin nr/ 682, datë 29.07.2015 . Nga auditimi rezulton se Drejtoria Arsimore Rajonale Qarku Tiranë, planifikon në buxhetin vjetor, fonde për mbulimin e shpenzimeve të transportit të nxënësve dhe mësuesve që mësojnë dhe punojnë larg vendbanimit të tyre.

Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore. Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a. Masa e shpenzimeve për llogaritë në bazë të numrit të nxënësve dhe të mësuesve, numrit të ditëve mësimore, çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetase të shërbimit të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, dhe të indeksimit të çmimeve të shërbimit të transportit, të botuara çdo vit nga INSTAT-i, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Nga auditimi mbi mënyrën e organizimit të veprimtarisë së transportit si dhe pagesat e kryera për drejtorët, mësuesit, nxënësit e rreth 65 shkollave të cilat ndodhen në qarkun e Tiranës, për 4-mujorin e vitit 2015, viti 2016 si dhe vitin 2017 rezultoi se:

Për vitin akademik 2014-2015:

Drejtoria Rajonale Arsimore, ka përgatitur hartën e linjave dhe me shkresën nr.373/1 datë 22.05.2014, si dhe vendimin nr. 201 datë 12.05.2014 ka miratuar nga Këshilli i Qarkut Tiranë, linjat e transportit për mësuesit dhe nxënësit për rrethin e Tiranës, mbështetur në ligjin nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, i ndryshuar, me VKM nr.709 datë 05.10.2011 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit” i ndryshuar. DAR Qark Tiranë, nuk ka hapur procedure prokurimi publik për shërbimin e transportit, sipas pikës 2 të VKM nr.709, datë 05.10.2011 të Këshillit të Ministrave, “Fondet publike për shërbimin e transportit prokurohen nga çdo drejtori arsimore rajonale dhe zyrë arsimore, në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar” dhe si rezultat i mos hapjes së procedures ka realizuar mbulimin e shpenzimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

duke kryer pagesat individuale të mësuesve nëpërmjet llogarisë bankare dhe nxënësve nëpërmjet zyra të [REDAKTUAR] sh.a. Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarkut Tiranë, pas miratimit të linjave nga Këshilli i Qarkut Tiranë, kryen likuidimet në [REDAKTUAR] (për nxënësit) dhe nëpër bankat e nivelit të dytë (për mësuesit) duke verifikuar fillimisht listprezencat e dorëzuara në DAR nga drejtoret e shkollave, mbi prezencën apo jo të nxënësve dhe mësuesve të shkollave përkatëse.

Per vitin akademik 2015-2016

Drejtoria Arsimore Rajonale, me shkresën nr. 2496 datë 27.10.2015, i është drejtuar Këshillit të Qarkut Tiranë, për miratimin e linjave të transportit për vitin shkollor 2015-2016 bashkë me distancat në kilometra dhe kategoritë e rrugëve, për punonjësit arsimorë si dhe nxënësit të cilët mësojnë jashtë vendbanimit të tyre. Pas bisedimeve me përgjegjësin e sektorit të shërbimeve të përgjithshme [REDAKTUAR], na komunikojë së edhe pse shkresa është dërguar zyrtarisht, nga ana e Këshillit të Qarkut Tiranë nuk pati asnjë përgjigje, dhe si rezultat Drejtoria Rajonale Arsimore, qarku Tiranë ka vazhduar procedurën e pagesës së mësuesve dhe nxënësve nëpërmjet miratimit të linjave të një viti të mëparshëm, viti 2014. Nga auditimi u konstatua se DAR-Qarku Tiranë, edhe pse ka dërguar vetëm një shkresë zyrtare mbi miratimin e linjave për vitin 2015, mospërgjigja nga Këshilli i Qarkut ka mjaftuar për të vazhduar me miratimin e linjave të një viti të mëparshëm në kundërshtim me pikën 2 të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 682 datë 29.07.2015 “Mbi Përdorimin e fondeve të Planifikuara për transportin e Mësuesve dhe nxënësve.....” i cili citon se “Njësitë arsimore vendore, mbështetur në numrin e mësuesve dhe nxënësve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, në bashkëpunim me këshillat e qarqeve e njësitë bazë të qeverisjes vendore, miratojnë hartën e linjave.”.

DAR Qark Tiranë, nuk ka hapur procedure prokurimi publik për shërbimin e transportit, sipas pikës 2 të VKM nr 709, datë 05.10.2011 të Këshillit të Ministrave, “Fondet publike për shërbimin e transportit prokurohen nga çdo drejtori arsimore rajonale dhe zyrë arsimore, në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar” ,por ka realizuar mbulimin e shpenzimit nëpërmjet zyra të Postës Shqiptare sh.a(per nxënësit) dhe bankës së nivelit të dytë (për mësuesit) duke bere pagesën për seclin nga mësuesit apo nxënësit individualisht për shërbimin e transportit. Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarkut Tiranë, me miratimin e linjave të një viti të mëparshëm, kryen likuidimet në Postën Shqiptare (për nxënësit) dhe në bankat e nivelit të dytë (për mësuesit) duke verifikuar fillimisht listprezencat e dorëzuara në DAR nga drejtoret e shkollave, mbi prezencën apo jo të nxënësve dhe mësuesve të shkollave përkatëse.

Me shkresën nr. 343 date 15.01.2016 Ministria e Arsimit dhe Sportit, i drejtohet Bashkisë së Tiranës për ti deleguar, zbatimin e vendimit nr. 682, dt 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mesojnë jashtë vendbanimit” e cila ndër të tjerash citon se “Duke filluar nga dt. 01.01.2016, në zbatim të vendimit nr.682 datë 29.07.2015, fondet për mbulimin e shpenzimeve të transportit të punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre do të mbulohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të deleguara për Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Per vitin 2016, DAR- Qarku TR nuk ka kryer asnjë pagesë për shërbimin e transportit, për shkak të kalimit të këtij shërbimi Bashkisë së Tiranës. Pagesat që janë kryer për mësuesit janë detyrime të prapambetura për vitin 2015 si rezultat i miratimit me vonësë të tre linjave të reja.

Per vitin akademik 2016-2017



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Me shkresën nr.7798 datë 16.08.2017 Ministria e Arsimit dhe Sportit i drejtohet DAR-Qarkut TR si dhe për njoftim Bashkisë së Tiranës, ka njoftuar për të vazhduar shërbimin e transportit për mësuesit dhe nxënësit Drejtoria Rajonale Arsimore e Qarkut Tiranë.

DAR- Qarku Tiranë me shkresën nr.2170 prot. Datë 09.10.2017 i është drejtuar bashkisë së Tiranës për miratimin e linjave të transportit për punonjësit arsimore që punojnë dhe nxënësit që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre. Kjo listë është miratuar nga Bashkia e Tiranës me shkresën nr. 37213/1 datë 30.10.2017, duke u mbështetur në VKM nr. 398, datë 03.05.2017.

DAR Qark Tiranë edhe për këtë vit, nuk ka hapur procedurë prokurimi publik për shërbimin e transportit, sipas pikës 3 të VKM nr 398, datë 03.05.2017 të Këshillit të Ministrave, *“Njësitë arsimore (drejtoritë rajonale arsimore/zyrat arsimore), mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të fëmijëve, nxënësve dhe punonjësve arsimorë sipas hartës së linjave të shërbimit të transportit publik, të licencuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose qendrore.”*.

DAR- Qark Tiranë ka realizuar mbulimin e shpenzimit nëpërmjet zyrave të ■■■ sh.a. për nxënësit dhe në bankat e nivelit të dytë (për mësuesit). Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarkut Tiranë, pas miratimit të linjave nga Këshilli i Qarkut Tiranë, kryen likuidimet në ■■■ dhe bankat e nivelit të dytë duke verifikuar fillimisht listprezencat e dorëzuara në DAR nga drejtoret e shkollave, mbi prezencën apo jo të nxënësve dhe mësuesve të shkollave përkatëse.

-Nga auditimi mbi miratimin e linjave për vitin akademik 2015-2016 si dhe 2016-2017, u konstatua se, DAR- Qarku Tiranë edhe pse viti shkollor fillon në shtator dhe përfundon në qershor të viti pasardhës, institucioni në asnjë nga vitet objekt auditimi nuk ka çuar miratimin e linjave përpara fillimit të vitit shkollor, por këto linja janë dërguar praktikisht për vitin akademik 2015-2016 me shkresën nr. 2496, datë 27.10.2015, pra në muajin tetor dhe për vitin 2016-2017 edhe pse Ministria e Arsimit ja ka kaluar me shkresën nr. 7798, datë 16.08.2017, pra në muajin gusht, institucioni i ka dërguar për miratim hartën e linjave me shkresën nr. 2170 prot., datë 09.10.2017, pra në muajin tetor. Për të dyja vitet akademike, institucioni edhe pse viti akademik ka filluar në muajin shtator, dërgimi për miratimin e linjave si dhe miratimi nga Bashkia e Tiranës ka rezultuar dy muaj me vonesë nga fillimi i vitit akademik, duke shkaktuar kjo vonesa në pagesat e mësuesve dhe nxënësve të cilët mesojnë jashtë qendrës së banimit. Si rezultat objektivi i këtij shërbimi është pagesa e mësuesve dhe nxënësve të cilët udhëtojnë jashtë qendrës së banimit për në shkollë, por në kundërshtim me këtë fakt pagesat e kundrejt mësuesve dhe nxënësve nuk janë bërë në kohën kur është kryer shërbimi i transportit. Fondet për shërbimin e transportit nuk e realizojnë plotësisht objektivin për të cilin janë planifikuar dhe pritët të shpëndahen.

Mbi pagesat e kryera për likuidimin e shërbimit të transportit të nxënësve dhe mësuesve të cilët mesojnë jashtë qendrës së banimit.

Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë pas miratimit të linjave çdo vit për transportin e mësuesve dhe nxënësve të cilët udhëtojnë nga qendra e banimit për në shkollë, si dhe pas marrjes nga drejtorët e shkollave të listprezencave të mësuesve dhe nxënësve, cakton tarifat duke ju referuar vendimit nr. 66 datë 07.02.2007 për disa ndryshime në vendimin nr.146 datë 26.02.1198 të Këshillit të Ministrave *“Për Ndryshimin e Tarifave të Transportit të udhëtarëve”* të ndryshuar.

DAR- Qarku Tiranë për periudhën objekt auditimi ka kryer pagesat për shërbimin e transportit për mësuesit si dhe nxënësit të cilët punojnë dhe mesojnë jashtë qendrës së banimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

duke ju referuar VKM nr. 682 datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike...” i ndryshuar me vendimin nr. 398 datë 03.05.2017 “për disa ndryshime në vendimin nr.682 datë 29.07.2015” dhe VKM nr 624, datë 01.11.2017 “Për disa ndryshime te vendimin nr.682 datë 29.07.2017” te cilat citojnë se në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të [REDAKTUAR], sh.a.

Nga auditimi u konstatua se DAR Qarku Tiranë, edhe pse për të tre vitet nuk ka hapur procedure prokurimi, por e ka kryer këtë shërbim nëpërmjet Postës Shqiptare, për vitin 2015, *ky shërbim është kryer pa asnjë kontratë shërbimi të lidhur me [REDAKTUAR]* për të përcaktuar te drejtat dhe detyrimet të cilat lindin nga kryerja e këtij shërbimi nga ana e insitucionit përkatës. Konstatohet se vetëm për vitin 2017 me shkresën nr.2494/1 datë 08.11.2017 është lidhur kontrata e shërbimit me Filialin e Postës Shqiptare duke përcaktuar objektin e kontratës si dhe të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.

Planifikimi dhe realizimi për shërbimin e transportit per vitet 4 mujorin e vitit 2015, viti 2016 dhe viti 2017:

Emertimi	Viti					
	2015		2016		2017	
Shpenzime transporti	Planifikim	Realizim	Planifikim	Realizim	Planifikim	Realizim
	19,465,919	18,088,149	20,439,214	1,056,390	10,662,552	9,424,624

Për 4-mujorin e vitit 2015 janë kryer pagesat per transportin e nxënësve nëpërmjet [REDAKTUAR] për nxënësit dhe bankës së nivelit të dytë për mësuesit me urdhër shpenzimet nr.279, 280, 281, 282, datë 20.11.2015 per periudhën shtator-tetor , urdhër shpenzimin nr. 302, 303,304,305,306,307,309 datë 10.12.2015 dhe urdhër shpenzimit nr. 317, 318, 319, 326 per muajin nëntor.

Për vitin 2016, shërbimi i trasnprotit për mësuesit dhe për nxënësit, është deleguar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bashkisë së Tiranës. Edhe pse është planifikuar në vlerën 20,439,214, ky fond i është celur Bashkisë së Tiranës. Pagesa prej 1,056,039 lekë, ka të bëjë me shlyerjen e detyrimeve vetëm për mësuesit për vitin 2016, për tre linja të cilat janë miratuar me vonesë ku praktikisht, linja Zallbastar, linja Shëngjergj dhe linja Shkallë me urdhër shpenzimin datë 28.07.2016.

Për vitin 2017, si rezultat i kalimit të shërbimit të transportit me shkresën zyrtare nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nga Bashkia e Tiranës ne DAR- Qarku Tiranë, janë kryer likuidimet për nxënësit dhe mësuesit për mujat, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor me urdhër shpenzimet nr. 341,342,343,344 datë 28.12.23017, udher shpenzimet nr. 329,330,331,334,335 datë 18.12.2017 si dhe urdhër shpenzimet nr.334, 335 datë 19.12.2017.

Nga auditimi u konstatua se, referuar kontratës së lidhur me nr. nr.2494/1 datë 08.11.2017, për pagesat e kryera për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor nga Posta Shqiptare për shërbimin e transportit të nxënësve, kjo kontratë nuk është zbtuar, referur nenit 7 të saj e cila citon se “ [REDAKTUAR] ka për detyrim që në fund të cdo muaji të bëjë rakoridmet dhe të japë informacion në DARQT mbi numrin e përfituesve dhe shumën e lekëve të shpëndara” si dhe referuar nenit 6 i cili citon se “DAR qarku Tirane ka të drejtë të kërkojë nga Filiali I [REDAKTUAR], cdo



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

fund muaji pasardhës të raportojë mbi numrin e përfituesvë si dhe shumat e tërhequra nga përfituesi”

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve periudhën objekt auditimi, u konstatua se mbi verifikimin nga ana e DAR-Qarkut Tiranë për pagesat e kryera nga [REDAKTUAR] për pagesat e nxënësve të cilët udhëtojnë jashtë qendër së banimit duke ju referuar vkm nr. 682 datë 29.07.2015 e ndryshuar me vkm nr.398, datë 03.05.2017 e ndryshuar me vendimin nr.624 datë 01.11.2017 “*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e....*”, vetëm për vitin 2015 janë dërguar dy aktrakordime nga [REDAKTUAR] drejtuar DAR-Qarku Tiranë në të cilën bashkalidhur nuk ka asnjë dokument justifikues mbi tërheqjen e shumave nga personat të cilet kanë përfituar këtë pagesë. Për pagesat e kryera për vitin 2016 (likuidimet për detyreimet e prapambetura për vitin 2015) si dhe pagesat e kryera për vitin 2017 nuk ka asnjë dokument justifikues bashkalidhur, akt rakordimit, në kundërshtim me pikën 35/b, të udhëzimit nr. 30 datë 27.11.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike*” i ndryshuar i cili citon së “*Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale, të tillë si dokumenta vërtetues, të cilët vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve ekonomike, të tillë si flethyrje, fatura, procesverbale, apo akte-rakordime...*”.

Për vitin 2015, në lidhje me pagesën për tarifën e shërbimit që përfshin [REDAKTUAR] rezultoi se, detyrimi i cili ka lindur si rezultat i shërbimit nga [REDAKTUAR] për pagesat e transportit të nxënësve është kryer nga DAR-Qarku Tiranë me urdhër shpenzimin nr. 320 datë 29.12.2015 në vlerën 53,138 lekë, ky detyrim i cili ka lindur si rezultat i shërbimit nga posta shqiptare për 4 vite mbi pagesat e nxenesve mbi sigurimin e transportit, ku praktikisht për vitin 2012, 2013, 2014, 2015. Bashkalidhur faturës tatimore e leshuar nga Posta Shqiptare, nuk ka asnjë dokument justifikues, dhe asnjë aktrakordim mbi pagesat të cilat ka kryer posta në shërbim të DAR-Qarku Tiranë duke rezultuar kështu në faktin se nga ana e DAR/Qarku Tiranë nuk ka pasur asnjë monitorim mbi cilësinë dhe arritjen e objektivit mbi lëtë shërbim. Nga bisedime me specialisten e fiancës, ky detyrim ka qënë 0.06% e vlerës totale së pagesës së kryer, por si rezultat i mos lidhjes së kontratës, ky detyrim ka mbetur në kuadër të një marrëveshjeje verbale.



V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT:

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

Titulli i Gjetjes 1: Nevoja për rishikim/shfuqizim të Rregullores së Brendshme Tip për DAR/ZA-et.

Situata:	1.1. Rregullorja tip për organizimin dhe funksionimin e njësive arsimore vendore është hartuar në bazë dhe në detyrim të ligjit nr. 7592, datë 21.06.1995, që është dispozitë e shfuqizuar dhe rënë nga fuqia nga ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. 1.2. Duke analizuar përmbajtjen e ligjit që rregullon fushën e arsimit parauniversitar, si dhe rregulloren e brendshme të institucionit, konstatohet se Drejtoritë Arsimore, funksionojnë mbi bazën e akteve ligjore e nënligjore si dhe të strukturave, të cilat nuk janë sjellë në koherencë me dispozitat e ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rregullorja tip mbi organizimin dhe funksionimin e DRA/Za-ve që është në fuqi, nuk është në koherencë dhe nuk ka pasqyruar ndryshimet e: - legjislacionit të shërbimit civil, - ligjit organik që rregullon funksionimin e tyre, ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. -dispozitave ligjore që normojnë kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar publik, pasi rregullorja nuk është rishikuar pas miratimit të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015. 1.3. Disa pika të rregullores tip, bien ndesh me kuadrin ligjor në fuqi. Konkretisht: I. Në nenin 26, të Rregullores Tip, miratuar nga Ministri MASH me Udhëzimin nr. 3, datë 18.01.2011, “Rregullore e brendshme e DAR-it dhe e ZA-së”, nënvizohet se: <u>“Drejtori i DAR-it miraton Rregulloren e Brendshme të DAR-it dhe të ZA-së përkatëse”.</u> Ky përcaktim është në kundërshtim dhe tejkalim të përcaktimeve të pikës nr.7, të VKM nr. 66, datë 3.2.2010, “Për riorganizimin e Drejtorive Rajonale dhe Zyrave Arsimore”, që shpreh se, <u>“Ministri i Arsimit dhe Shkencës, miraton rregulloret e brendshme të funksionimit të drejtorive arsimore rajonale dhe të zyrave arsimore”.</u> Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk ngarkon Ministrin për miratimin e
-----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	rregullores tip dhe nuk ngarkon drejtorët e DAR-it të miratojnë rregulloret e juridiksionit të tyre, por ka vendosur miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të çdo DAR dhe ZA nga Ministri përgjegjës për arsimin. Nga ana tjetër, rregullorja tip është e vitit 2011 dhe nuk është korigjuar a përditësuar. 1.3.2 Në nenin 27, “Përshkrimi i vendeve të punës”, të Rregullores së Brendshme tip, miratuar nga Ministri MASH me Udhëzimin nr. 3, (311/1 prot), datë 18.1.2011, është përcaktuar se: <i>“Drejtori i DAR-it/ përgjegjësi i ZA-së miratojnë përshkrimin e vendit të punës për secilin punonjës. Në përshkrimin e vendit të punës së përgjegjësit të sektorit parashikohet që në një pjesë të kohës kryen detyra si specialisti sektorit”.</i> -Konstatohet se, këto përcaktime të Rregullores së brendshme bien ndesh dhe nuk përputhen me kërkesat e pikës 18, germa “c”, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 , datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, sipas së cilës, përshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë.
Kriteri:	Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave (i ndryshuar). ligji nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 66, datë 3.2.2010, “Për riorganizimin e Drejtorive Rajonale dhe Zyrave Arsimore”; VKM nr. 142/2014, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”,
Ndikimi/Efekti	Mos rishikimi dhe miratimi i rregullores së brendshme mbart risqe që lidhen me mos përditësimin e saj, përcaktimin e rregullave dhe detyrave të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve të ndryshme të punës.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	a. Ministri i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë: Të marrë masa për shfuqizimin e Rregullores Tip, miratuar nga Ministri MASH me Udhëzimin nr. 3, datë 18.01.2011, “Rregullore për funksionimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Zyrës Arsimore”, si akt i dalë në zbatim të ligjit nr. 7592, datë 21.06.1995, <u>dispozitë e shfuqizuar</u> dhe rënë nga fuqia, si dhe të hartojë një rregullore të re, e cila të harmonizohet me ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dispozitat ligjore që rregullojnë menaxhimin financiar publik e kontrollin e brendshëm, si dhe aspektet e veprimit të ligjit për shërbimin civil mbi miratimin e përshkrimit të vendit të punës për secilin punonjës. Kjo rregullore të miratohet nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Menjëherë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	b.Nga ana e DAR Qark Tiranë: 1. Të rishikohen dhe përmirësohen dispozitat e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit DAR Qark, miratuar me Urdhërin e Drejtorit nr. 233, datë 31.1.2014, (në referencë të rregullores tip të miratuar nga MAS), dhe mbi këtë bazë të kryhet përmirësimi dhe azhurnimi i saj. 2. Drejtori i DARQT dhe njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, të koordinojë veprimet dhe miratojë përshkrimet e punës tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe të koordinojë veprimet me Departamentin e Administratës Publike, në përputhje me kërkesat e pikës 18, germa “c”, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” si dhe pikës nr. 4.1.1, kreu IV, të Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 2, datë 7.4.2014, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”. Menjëherë
--	---

Titulli i Gjetjes 2:

Gjendje shumë e lartë e librit shkollor stok, jashtë përdorimit si pasojë e ndryshimit të kurikulave mësimore.

Situata:	Gjatë auditimit të llogarisë 35 “Mallra” (në aktivin e bilancit kontabël), konstatohet se një pjesë e tyre janë mallra stoqe. Llogaria për periudhën e audituar 2015 dhe 2016 paraqitet respektivisht me vlerën 3,455,707 lek dhe 3.143.230 lekë. Kjo vlerë përfaqëson libra stok, një kontingjent prej 89 artikujsh të regjistruar në v.2015 dhe 77 artikuj në v.2016, ose 31,427 copë librash shkollorë jashtë katalogut / libri shkollor stok, që përfaqëson përkatësisht: - Tekste të arsimit 9 vjeçar, 16.752 copë libra, me vlerë 1.670.555 lekë, - Tekste të arsimit të mesëm, 14.675 copë libra, me vlerë 1.472.675 lekë. Këto libra ndodhen gjendje në magazinë, që nga viti 2002, 2003, 2004 dhe 2005, duke mbetur stok pasi janë jashtë curricul-ave (jashtë programit mësimor), e për pasojë nuk kanë vlera përdorimi. Si gjetje u konstatua: Krijimi i një nomenklature të tillë të librit shkollor stok 31,427 copë librash shkollor për v.2015 jashtë katalogut me vlerë 3,455,707 lek vetëm DAR Qark, (por kjo situatë rezulton dhe në DAR Qytet ku stoku i librit në v.2015 është me vlerë 4,453,819 lekë, gjë që do të thotë se vetëm dy DAR e Qytetit dhe Qarkut Tiranë arrin vlerën 7,9 milionë lekë), tregon për një proces të pa studiuar dhe një shpenzim jo efektiv të fondeve të buxhetit për periudhat kur ata janë prodhuar Megjithëse kanë kaluar rreth 15 vite që janë furnizuar me këto tekste, pas ndryshimit të strukturave dhe programeve mësimore MAS nuk ka lëshuar udhëzim të posaçëm, se si duhet vepruar për këto raste.
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Shuma respektive në vlerën 3,455,707 lek dhe 3.143.230 lekë për periudhën e audituar 2015 dhe 2016 paraqitet si shpenzim joefektiv dhe për një shpenzim jo efektiv të fondeve të buxhetit për periudhat kur ata janë prodhuar
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Për përmirësim dhe ndryshim dispozitash: MASR të evdintojë dhe vlerësojë gjendjen në shkallë vendi, të librit shkollor të mbetur stok, tekste që janë jashtë <i>curricul-ave</i> (jashtë programit mësimor), e për pasojë nuk kanë vlere përdorimi dhe mbi këtë bazë të hartojë e miratojë një udhëzim të posaçëm , se si do të veprohet për këtë kontigjent të teksteve shkollore stok dhe jashtë funksionit, duke shqyrtuar gjetjen e mundësive për një përdorim eficient të këtyre vlerave. Ky proces duhet shoqëruar edhe me një analizë të shkaqeve e reflektim në praktikën aktuale, për të mos u përballur me situata të ngjashme në të ardhmen.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6 muajve të prapë 2018.

Titulli i Gjetjes 3:

Udhëzimi i MAS nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, ka disa mangësi dhe lind nevojë për përmirësim:

Situata:	1. Nga auditimi në 16 raste, kandidatët rezultojnë në renditjen përfundimtare me numër të barabartë pikësh, (nga këto 4 raste në portalin 2015-2016 dhe 12 raste në portalin 2016-2017). Për këtë situatë, Udhëzimi i MAS nuk parashikon asnjë instruksion udhëzues mbi mënyrën e renditjes së kandidatëve për këto raste, ndonëse kjo merr shumë rëndësi pasi bëhet fjalë për mundësinë për tu punësuar. 2. Auditimi vëren dobësi dhe problematika në mënyrën e njoftimit të kandidatëve të rankuar, për ti ftuar në zgjedhjen e pozicionit të punësimit. Udhëzimi i MAS nuk përcakton rregulla e kritere mbi mënyrën e njoftimit dhe dokumentimin e rasteve kur subjektet nuk përgjigjen, apo ka mungesë aksesit. Konstatohet se , Komisioni i Vlerësimit ka vijuar me njoftimin e kandidatëve të rradhës, duke u shprehur se “<i>nuk ekziston numri i telefonit</i>”, “<i>nuk përgjigjet abonenti</i>”, etj. Në 18 raste gjithsej, (nga këto 5 raste të lidhura me portalin 2015-2016 dhe 13 raste për kandidatët e
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	portalit 2016-2017), është vënë shënimi që, “nuk përgjigjet në telefon”, “fikur telefoni”, “nuk ekziston numri i telefonit”, etj, duke e konsideruar të përfunduar detyrimin për njoftimin e tyre dhe ka vijuar me emërimin e kandidatëve, që listohen më poshtë në renditjen e fituesve. Udhëzimi duhet të përcaktojë mënyrën e njoftimit të kandidatëve fitues që u ka ardhur rradha për të përzgjedhur pozicionin e punës (nëpërmjet publikimit në fqen zyrtare të DAR, nëpërmjet dërgimit të e-mailit apo me sms, qe duhen dokumentuar në një regjistër të posaçëm, etj). 3. Në DARQT, u evidentua se në 106 raste të lëvizjeve paralele, të ndara sipas periudhave: Nga 59 raste janë kryer gjatë muajve shtator (2015-2017), në 28 raste janë kryer gjatë muajve tetor (2015-2017); në 16 raste janë kryer gjatë muajve nëntor (2015-2017); në 3 raste janë kryer gjatë muajve dhjetor (2015-2017, objekt auditimi); Nga ana e drejtuesve të DARQT lëvizjet paralele janë kryer deri në mesin e vitit akademik, pasi: -Në 9 raste janë realizuar për sistemimin e arsimtarëve në profil, ose për sistemim të normës mësimore. -Në 47 raste janë imponuar nga rënia e numrit të nxënësve në klasa/shkolla. Shkollat që krijojnë më shumë probleme të rënies së numrit të nxënësve dhe që kanë pasur më shume kërkesa për lëvizje paralele janë shkollat vartëse , me klasa kolektive, por dhe në shkollat qendër vihet re një tendencë e rënies së vazhdueshme të numrit të nxënësve këto vitet e fundit. (Kjo situatë ka detyruar kryerjen e lëvizjeve paralele në muajt në vazhdim). -Në 50 raste, për trajtimin e kërkesave të mësuesve, (per arsye shendetesore, distanca e largët e qendrës arsimore me vendbanimin apo vjetersinë në punë të punonjësit që ka bërë kërkesë), të cilat kanë qenë të shpërndara gjatë vitit shkollor e në mënyrë të vazhdueshme (nga momenti që është krijuar një vend i lirë sipas profilit përkatës të kërkuarit, janë kryer lëvizjet paralele të arsimtarëve, etj. Këto situata nuk parashikohen në udhëzimin e MAS, i cili në kreun VII, pika 3, përcakton se për lëvizjet paralele, “Komisioni i vlerësimit në njësinë arsimore vendore, brenda muajit gusht, bën vlerësimin e dosjeve dhe rendit mësuesit sipas pikëve në profil/lëndë” 4. Në kreun 2, pika 2, të Udhëzimit të MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, ku trajtohet dokumentacioni që duhet të përmbajné dosjet e aplikimit për mësues, përcaktohet që 3 nga 13 dokumentat e dosjes së aplikimit, paraqiten fotokopje të pa vërtetuara nga noteri. Konkretisht, në pikat “e, g dhe f” stë pikës 2 të Udhëzimit, shkruhet: Fotokopje e librezës së punës, fotokopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, dhe fotokopje e dëshmisë së kualifikimit
--	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	Nga ana tjetër, në kreun 2, pika 3 , të Udhëzimit, përcaktohet se, 3 nga 13 dokumentat e dosjes së aplikimit , konsiderohen si dokumente të detyrueshëm , <i>(mungesa e së paku njërit prej tyre sjellin dhe skualifikimin)</i> : raport mjeko-ligjor, vërtetim i qendrës së banimit dhe fotokopje të diplomës dhe shtojcave.
Kriteri:	✓ Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ✓ Udhëzimi i MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”. ✓ Urdhri i MAS-it nr. 363, datë 16.09.2014 “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesve në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, ✓ Udhëzimi nr. 21, datë 23.07.2010, i MASH-it, “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar,
Ndikimi/Efekti	Dobësitë në udhëzimin e mësipërm, si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm mbi procesin e konkurimit dhe testimit nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, mbartin risqe që lidhen me mos përcaktimin e rregullave të qarta për emërimin e mësuesve apo lëvizjen paralele në kuadër të marrëdhënieve të punësimit
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	MASR të rishikojë dhe përmirësojë Udhëzimin MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, në lidhje me aspektet e mëposhtme: a. Të korigjohet kreu II, pika 2 e Udhëzimit, duke përcaktuar që gjithë dokumentet të jenë fotokopje të noterizuara, pasi nëse nuk janë të noterizuara ato dokumente mund të lënë vend për abuzim. b. Të hiqet në piken 1 të kreut II të Udhëzimit kalsifikimi i dokumenteve të detyrueshme, ku 3 nga 13 dokumentat e dosjes së aplikimit, konsiderohen si dokumente të detyrueshëm, <i>(mungesa e së paku njërit prej tyre sjellin dhe skualifikimin)</i> dhe duke caktuar përfundimisht listën e dokumenteve për aplikim. Nuk ka pse të jetë kriter për skualifikim leja e banimit, por skualifikimi të bëhet për dokumentat e dosjes. c. Të qartësohet në Udhëzim procedurat e njoftimit dhe të konfirmimit nga ana e kandidatëve, pasi shumë kandidatë banojnë në rrethe dhe mbeten jashtë skemës së njoftimeve. d. Të plotësohet udhëzimi dhe për nevoja të arsyetuara (që duhen detajuar në udhëzim), të lejohet kryerja e lëvizjeve paralele dhe gjatë vitit, kur nevojat e shkollave e bëjnë këtë transferim të nevojshëm. Pra, lëvizjet paralele të bëhen dhe gjatë vitit, aq më tepër në muajin gusht që është deadline sipas udhëzimit, nuk kanë përfunduar regjistrimet e nxënësve dhe balancimi i numrit të klasave dhe mësuesve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim
Titulli i Gjetjes 4:	Nevoja për përmirësim legjislativ, në VKM për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit
Situata:	Referuar VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar, është konstatuar se ky vendim, <u>nuk ka përcaktuar afate kohore për miratimin e linjave në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore</u> , për nxënësit dhe mësuesit të cilët udhëtojnë larg qendrës së banimit. Si rezultat i hartimit dhe miratimit të linjave gjatë vitit shkollor, dhe jo në fillim të tij, pagesat e mësuesve dhe nxënësve kryhen me vonesa të ndjeshme. Gjithashtu konstatohet se, nuk ka procedura dhe rregulla të përcaktuara mbi monitorimin e këtij shërbimi, kur ky shërbim është realizuar nga Posta Shqiptare. Si rrjedhojë e vonesës në shlyerjen e këtyre shpenzimeve, fondet për shërbimin e transportit për mësuesit dhe nxënësit, që punojnë dhe mësojnë jashtë vendbanimit të tyre, nuk e realizojnë plotësisht objektivin për të cilin janë planifikuar dhe shpenzohen.
Kriteri:	VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar,
Ndikimi/Efekti	Si rrjedhojë e vonesës në shlyerjen e këtyre shpenzimeve, fondet për shërbimin e transportit për mësuesit dhe nxënësit, që punojnë dhe mësojnë jashtë vendbanimit të tyre, nuk e realizojnë plotësisht objektivin për të cilin janë planifikuar dhe shpenzohen.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Me qëllim arritjen e objektivit në drejtim të mirëadministrimit dhe përdorimit të fondeve publike të planifikuara për “Transportin e Mësuesve dhe të Nxënësve që Mësojnë e Punojnë larg Vendbanimit të Tyre” me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, të hartohet dhe miratohet një Udhëzim nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit me objekt rregullimin apo standardizimin e afateve kohore për miratimin e linjave, pagesat e mësuesve dhe nxënësve si dhe përcaktimin e rregullave për monitorimin nga DAR-ët përkatëse.
Afati	brenda 6-mujorit të parë 2018

B. MASA ORGANIZATIVE:

Çështja 2/a – Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Titulli i Gjetjes 1: Nuk janë caktuar drejtuesit e menaxhimit të programeve buxhetore (EMP)

Situata:	Nga auditimi u konstatua se, DARQ Tiranë zbaton tre (3) programe buxhetore, “Planifikim/Menaxhim/Administrim”, “Arsimi Bazë” dhe “Arsimi Mesëm”, por për asnjërin prej programeve nuk është krijuar Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP), e për pasojë nuk është caktuar nga nëpunësi autorizues, drejtuesi i EMP. Gjithashtu, në periudhën objekt auditimi nuk është hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, Deklarata e Politikës së Programit.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar; Pika 40-42 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23 datë 22.11.2016 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA”.
Ndikimi/Efekti	Mos ngritja e Ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP), ka ndikuar në mungesën e kërkesës së llogarisë dhe evidentimin e përgjegjësisë së çdo hallke për zbatimin e strukturës buxhetore dhe raportimin e çdo drejtuesi të programit përpara nëpunësit autorizues, gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Sa më sipër, kjo ndikon gjithashtu në mospërcaktimin e qartë të proceseve të punës, si pjesë e gjurmës së auditimit për buxhetimin.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Nëpunësi autorizues të marrë masa, ku referuar tre programeve buxhetore të institucionit të miratojë drejtuesit e Programeve si dhe Ekipin e Menaxhimit të Programeve, duke bërë të mundur njohjen e përgjegjësi dhe detyrave të drejtuesit të çdo programi, në lidhje me hartimin e kërkesave buxhetore, për realizimin e qëllimeve, objektivave si dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Nga ana tjetër, të merren masa për hartimin dhe miratimin e Deklaratës së Politikës së Programit, e cila përbëhet nga Qëllimi i Politikës së Programit, Objektivat dhe Treguesit e Performancës.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 2: Mangësitë në hartimin e PBA-ve

Situata:	Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, hartimi i PBA ka mangësi në trajtimin e tyre, të tilla si në përshkrimin e misionit të njësisë, përshkrimin e programeve dhe veprimtarive të njësisë, paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës së performancës, planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve dhe aktiviteteve si dhe treguesit faktik për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin në vazhdim si dhe për tri vitet e ardhshme buxhetore. Gjithashtu, u konstatua se, për periudhën objekt auditimi,
-----------------	--



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	institucioni ka dorëzuar vetëm fazën e dytë të hartimit të PBA, duke mos i bërë të njohur Ministrisë e Arsimit dhe Sportit kërkesat buxhetore që në fazën e parë të përgatitjes së këtij dokumenti.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “ <i>Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë</i> ”; i ndryshuar; Pika 6 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23 datë 22.11.2016 “ <i>Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA</i> ”.
Ndikimi/ Efekti	Mosrespektimi i fazave të hartimit dhe miratimit të PBA-së ndikon në mos evidentimin në kohë të kërkesave buxhetore, gjë që mund të kërcënojë realizimin e cilësisë së shërbimeve arsimore publike.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Institucioni të marrë masa që gjatë hartimit të PBA të sigurojë që, alokimet e buxhetit të reflektojnë prioritetet gjatë një periudhe afatmesme (3 - vjeçare), duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë midis alokimit të buxhetit dhe objektivave të politikës së programit, duke përcaktuar qarte prioritetet, objektivat, masat që do të merren për arritjen e këtyre objektivave si dhe kërkesat shitesë për secilin program buxhetor. Gjithashtu, drejtuesi i DAQRT të miratojë fazën e parë të PBA, dhe ta dorëzojë brenda afateve të referuara në Udhëzimin e sipërcituar mbi buxhetin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vazhdimësi

Titulli i

Gjetjes 3:

Mangësitë në plotësimin e raporteve të monitorimit

Situata:	Nga auditimi u konstatua se raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi si dhe raportet periodike që DAR Qarku Tiranë i ka paraqitur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse, <i>lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë</i> . Gjithashtu konstatohet se, për të tre vitet objekt auditimi, institucioni nuk i ka dorëzuar të gjithë raportet 4-mujore, referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave. Institucioni nuk ka publikuar raportet e monitorimit në faqen zyrtare të tij.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “ <i>Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë</i> ”; i ndryshuar; Pika 33, Kreu IV “ <i>Monitorimi</i> ”, i Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22 datë 17.11.2016, “ <i>Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore</i> ”
Ndikimi/ Efekti	Publikimi i raporteve të monitorimit i ndihmon transparencës së përdorimit të fondeve publike.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve buxhetore në DARQT, gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të argumentojnë mosrealizimin e produkteve dhe të parashikojnë masat që duhen ndërmarrë në të ardhmen për realizimin e tyre. Institucioni të marrë masa për dorëzimin e raporteve 4-mujore të monitorimit në Ministrinë e linjës si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare, referuar Udhëzimit të sipërpërmendur.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Periodikisht, çdo katërmujor

Çështja 2/b – Marrëdhëniet e punës e pagave dhe zbatimin e rekomandimeve

Titulli i

Gjetjes 1:

Rregullorja e brendshme e institucionit nuk është përditësuar

Situata:	Organizimi i brendshëm i DARQT, është bërë mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me urdhërin nr. 199, datë 01.12.2010, të Kryeministrit dhe të pasqyruar në Rregulloren e Brendshme me nr. 233 prot., datë 31.01.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë”, rregullore me të cilën institucioni ka funksionuar në vijimësi. Në rregullore janë evidentuar detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, si detyrat dhe përgjegjësitë e titullarit, përgjegjësit të sektorit por nuk janë specifikuar të ndara detyrat e specialistit për sektorët e veçantë .
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave (i ndryshuar); VKM nr. 199, datë 01.12.2010 “Për riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”.
Ndikimi/Efekti	Mos rishikimi dhe miratimi i ndryshimeve në rregulloren e brendshme mbart risqe që lidhen me mos reflektimin e ndryshimeve të ndodhura në legjislacion si dhe përcaktimin e rregullave dhe detyrave të hollësishme që burojnë në kuadër të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve të ndryshme të punës.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, të marrë masa për rishikimin dhe përditësimin e rregullores në përputhje me ndryshimet që ka pësuar kuadri ligjor mbi arsimin parauniversitar, ligji për statusin e nëpunësit civil, të specifikohen detyrat e specialistit për sektorët e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	veçantë si dhe detyrat për pozicione të tjera, mbështetur në strukturën e miratuar me si dhe shkresën nr. 450/23 prot., datë 19.01.2017 “Dërgohet detajimi i numrit të punonjësve për vitin 2017” të MAS .
Afati për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6-mujorit të parë 2018.

Titulli i Gjetjes 2:

Listëprezencat ditore, libri i pagave dhe dosjet e personelit

Situata:	Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e DAR Qarku Tiranë, dhe personelin e shkollave të arsimit para universitar në varësi, janë bërë në mënyrë të përmblodhur, me numrin e ditëve të punës në muaj dhe jo mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë, duke mos pasqyruar prezencën e mësuesve dhe punonjësve të shkollave çdo ditë gjatë muajit, për ditët që kanë punuar. Gjithashtu, libri i pagave nuk është plotësuar për punonjësit që janë në marrëdhënie pune, në të cilin duhet të shënohen për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave duke filluar nga paga bruto, shtesa e ndalesa deri në pagën neto. Nga auditimi u konstatua se, dosjet personale të nëpunësve janë administruar duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumentave. Dosjet nuk janë inventarizuar, administruar me indeks të vecantë, ku evidentohen shkresat e fashikujt në veçanti si dhe pasqyrimi kronologjik i inventarit të fletëve në dosje.
Kriteri:	Neni 6 i ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Lidhjet nr. 1 dhe 2, të VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen , procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit”
Ndikimi/Efekti	Mungesa e inventarit të dosjes dhe e fletës inventariale të saj krijon probleme në besueshmërinë dhe ruajtjen e elementeve të domosdoshëm që janë pjesë e dosjes së çdo punonjësi/arsimtar
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, të marrë masa që listë prezencat mujore për punonjësit e saj dhe personelin e shkollave të arsimit para universitar në varësi, të përpilohen duke pasqyruar prezencën e mësuesve dhe punonjësve të shkollave për çdo ditë kalendarike të muajit. DARQT të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve personale të nëpunësve dhe arsimtarëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe manualit “Mbi arkivimin e dokumenteve” dhe aktet e tjera që normojnë këtë proces.
Afati për	Brenda 6-mujorit të parë 2018



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

zbatimin e rekomandimit

Titulli i Gjetjes 3:

111 mësues (nga 4261 mësues gjithsej në DARQT), nuk kanë patur ngarkesë të plotë të normave mësimore në shkolla.

Situata:	Nga auditimi në lidhje me zbatimin e normave të punës mësimore-edukative dhe numrit të nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, rezultojnë gjithsej 111 mësues (nga 4261 mësues), të cilët nuk kanë patur ngarkesë të plotë mësimore. Më koncretisht: <i>Në vitin shkollor 2015-2016</i>, nga 1563 mësues gjithsej, rezultojnë 34 mësues me ngarkesë jo të plotë mësimore, nga të cilët me -1 orë / mësimore më pak se ngarkesa 24 mësues dhe -2 orë / mësimore më pak se 10 mësues; Gjithësej -44 orë/mësimore. <i>Në vitin shkollor 2016-2017</i>, nga 1350 mësues gjithsej, rezultojnë 58 mësues me ngarkesë jo të plotë mësimore, nga të cilët 40 mësues me -1 orë/mësimore më pak dhe 18 mësues -2 orë/mësimore më pak se ngarkesa, gjithsej - 76 orë/mësimore. <i>Për vitin shkollor 2017-2018</i>, nga 1348 mësues gjithsej, rezultojnë 19 mësues me ngarkesë jo të plotë mësimore nga të cilët 12 mësues me -1 orë/mësimore më pak dhe 7 mësues me -2 orë mësimore; Gjithsej -26 orë mësimore.
Kriteri:	Udhëzimi i MAS, nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, si dhe Udhëzimi i MAS, nr.44, datë 16.10.2014, “Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.
Ndikimi	Shpërndarja e ngarkesës midis arsimtarëve
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, të studiojë mundësinë për plotësimin me ngarkesë të plotë të normave mësimore në shkolla, të mësuesve që rezultojnë me diferenca dhe orë mësimore të paplotësuara, dhe të vepohet në bazë të paracaktimeve të Udhëzimit të MASR nr. 21, datë 23.07.2010, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 44, datë 16.10.2014.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi

Çështja 3 – Zbatimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Titulli i Gjetjes 1: Dobësi në dokumentimin dhe konfirmimin e kryerjes së shërbimeve të riparimit për automjetin e institucionit.

Situata:	Nga auditimi u konstatua se, me urdhër-prokurimin nr.16, datë 18.10.2016 është realizuar procedura e prokurimit të shërbimit, për “Riparim për automjetin tip Mitsubishi Pajero 2800 Turbo Diesel, viti i prodhimit 1995”, me fond limit 247.567 pa TVSH / 297.081 lekë me TVSH, ku është shpallur fitues subjekti me çmimin më të ulët “[REDAKTUAR]” në vlerën 197.800 lekë pa tvsh, ose 237.360 me TVSH. Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos së riparimit të automjetit, ka mbajtur një procesverbal ku ka specifikuar nevojat për riparim të makinës, ku janë kërkuar 15 artikuj për servis. Fatura tatimore e shitjes është firmosur vetëm nga shitësi dhe jo nga përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktor..
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti	Mos dokumentimi i rregullt me situacion të nënshkruar nga përfaqësuesit e subjektit, rrezikon besueshmërinë e kryerjes së shpenzimit si dhe procesin e gjurmimit të transaksionit.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Institucioni të marrë masa për të gjitha rastet e kryerjes së shpenzimeve për shërbime, të përpilojë rregullisht dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton kryerjen efektive të shërbimit, apo marrjen në dorezim të aktiveve sipas kushteve të kontratës. Në të gjitha rastete, procesverbali i realizimit të shërbimit të nënshkruhet rregullisht nga komisioni, duke e bashkëlidhur me faturën e furnitorit, situacionet e shpenzimeve për shërbimet dhe riparimet, dhe dokumentuar në përputhje me kërkesat e parimet e menaxhimit financiar publik.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 2: Parregullsia në prokurimin e “Shërbimit të internetit për vitin 2016”, pasi komisioni nuk ka pasqyruar një përllogaritje të detajuar të fondit limit në procesverbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos

Situata	Grupi i punës i ngritur nga AK me Urdhërin nr.15 datë 29.02.2016, për hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos, nuk ka pasqyruar një përllogaritje të detajuar të fondit limit në proces verbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike dhe analizën e kostos, duke mos dokumentuar mënyrën se si është kryer përllogaritja e vlerës
----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	së kontratës. Nga auditimi i regjistrit të parashikimeve me ndryshimet e bëra për këtë prokurim, rezulton se është pakësuar fondi nga 7.500.000 planifikimi fillestar në vlerën 3.489.141 dhe është realizuar në vlerën 2.823.307 lekë pa tvsh. Ofertat financiare nga OE pjesmarrës në këtë procedurë kanë ofruar shërbimin e internetit për 10 muaj. Fondi limit nga DARQT është përlogaritur për ofrimin e shërbimit për 9 muaj, ndërsa shërbimi i internetit është realizuar për 8 muaj. Për rrjedhojë kjo procedurë është zhvilluar me një fond që nuk i përgjigjet shërbimit të kërkuar për të cilin është lidhur kontrata. Parregullsi u konstatuan se në proces verbalin e mbajtur nga KVO, nuk është firmosur nga njëri prej anëtarëve të tij, i cili ka firmosur deklaratën e paanësisë, DST, raportin përmbledhës për zhvillimin e procedurës së tenderit.
Kriteri	VKM nr. 914, datë 29/12/2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar
Ndikimi/ Efekti	Si rrjedhojë e mosdokumentimit dhe detajimit të përlogaritjes së fondit limit, krijohen risqe për realizimin e objektivit për të cilin janë planifikuar dhe shpenzohen këto fonde.
Shkaku	Ndryshimet e pësura në fondin limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandime	Grupi për llogaritjen e kostos dhe fondit limit përveç procesverbaleve për përcaktimin e mënyrës së llogaritjes së çmimeve, duhet të detajojë dhe argumentojë procedurën e ndjekur në marrjen e çmimeve në treg. Njësia e Prokurimit, grupi i punës për përlogaritjen e kostos dhe fondit limit në çdo rast duhet që përveç nënshkrimit të akteve të prodhuara të kryejë dhe protokollimin e tyre. Kmisioni për Vlerësimin e Ofertave, në çdo rast duhet të nënshkruajë procesverbalin e hapjes së procedurës, dhe për rastet e mosfirmosjes së këtre akteve nga anëtarët duhen parashtruar arësyet në lidhje me mos nënshkrimin.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Ne vijmësi

Çështja II/C – Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

Titulli i Gjetjes 1: **Kontabiliteti nuk është mbajtur sipas parimit të të drejtave të konstatuara**

Situata:	Gjatë viteve që janë objekt auditimi, një pjesë e detyrimeve të lindura apo faturave të lëshuara për shpenzimet e kryera, janë likuiduar në periudha të vitit pasardhës. Vlera e detyrimit të mbetura pa u likuiduar, nuk është kontabilizuar si angazhim për tu paguar në bazë të parimit të të drejtave dhe detyrimeve të kontatuara. Vlerat e këtyre faturave janë likuiduar me urdhër shpenzimet përkatëse, por janë kontabilizuar dhe paraqitur si detyrim dhe në të njëjtën kohë edhe si likuidim i këtij
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	detyrimeve në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Si rrjedhim efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (<i>ka ndodhur kur vlerat ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen</i>) dhe të regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.
Kriteri:	Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.
Ndikimi/ Efekti	Cënohet parimi i mbajtjes së kontabilitetit mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Transaksionet dhe ngjarjet ekonomike kur ato ndodhin dhe të regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin,
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Nga Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme të merren masat që, në mbajtjen e kontabilitetit, të aplikohen në mënyrë të drejtë rregullat kontabël, mbështetur mbi bazën e parimit të kontabilitetit të angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara, si dhe standarteve të zbatueshme për mbajtjen e kontabilitetit mbi baza monetare. Në këtë mënyrë, pasqyrat financiare përmbushin objektivat e tyre për informimin e përdoruesve, jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t’u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë trajtë, ato do të paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara, të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 2:

Në kontabilitet është regjistruar vlera e ndërtesave të ish-subjektit “Qendra Ekonomike dhe garazh” në shumën 12,064,250 lekë, objekte që efektivisht nuk ekzistojnë dhe për rrjedhojë këto regjistrime dëmtojnë treguesit e vërtetësisë së të dhënave të bilancit kontabël.

Situata:	Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” në Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara (aktivi i bilancit) ka të regjistruar vlerën 19,721,850 lekë, e cila paraqet vlerën e ndërtesave të ish-subjektit “Qendra Ekonomike dhe garazh” me vlerë 12,064,250 lekë, (<i>objekte që efektivisht nuk ekzistojnë për periudhën objekt auditimi dhe për rrjedhojë këto regjistrime denatyrojnë treguesit e vërtetësisë së të dhënave të bilancit kontabël të këtij institucioni</i>) si dhe vlera 7,667,600 lekë që është rikonstruksioni i zyrave që DAR ka në përdorim që në vitin 2006. Në vitin 2006 kur ky në institucion është transferuar dhe vendosur ne mjediset e shkollës speciale „[REDAKTUAR]” vlera e rikonstruksionit është kontabilizuar si Aktiv i Qëndrushëm i Trupëzuar, në llogarinë 219
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	„Ndërtesa“. Ky veprim kontabilizimi nuk është i drejtë sepse, në fakt ky objekt nuk është në pronësi të DAR Qark, por në bazë të përcaktimeve të pikave 2/b dhe c të Aneksit nr. 1, që shoqëron VKM nr. 204, datë 26.03.21998 „Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit vendor“, i ndryshuar, pushteti lokal është kompetent, administron dhe përgjigjet për objektet arsimore.
Kriteri:	Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006 dhe me ligjin nr. 10110, datë 02.04. 2009; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; VKM nr. 204, datë 26.03.21998 “Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit vendor“, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12. 2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjsteve që varen prej tyre”;
Ndikimi/ Efekti	<i>Vlera e kontabilizuar e ndërtesave së ish-subjektit “Qendra Ekonomike dhe garazh” prej 12,064,250 lekë ka ndikuar në mosevidentimin e vlerës reale të gjendjes pasurore të DARQT në llogarinë 212, duke sjellë pasaktësi në pasqyrat financiare.</i>
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	3. Drejtori i DARQT të ngrejë një grup pune për të pasqyruar çfarë ka ndodhur me këto objekte, të ndërtojë gjurmën e auditimit për ecurinë e procesit të privatizimit apo kthimit të pronave, duke saktësuar se çfarë është bërë me këto objekte, nëse janë privatizuar apo kthyer pronarëve dhe vetëm pas administrimit të dokumentacionit të plotë, në bashkëpunim me pronarët e truallit dhe ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, dhe pas saktësimit të ndërmarrin veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit. 4. Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme të kryejë sistemimet në kontabilitet dhe të reflektojë korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017, sa kontabilizuar padrejtësisht vlera e situacionit prej 7,667,600 lekë për rikonstruksion të mjediseve të shkollës speciale “L.G”, (në pronësi të Bashkisë Tiranë), rikonstruksioni i kryer në vitin 2006 si vlerë e AQT në zërin “Ndërtesa” për DAR Qark Tiranë.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i

Gjetjes 3:

Mbi përlllogaritjen e amortizimit të aktiveve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Situata:	Nga ana e Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme janë kryer llogaritjet e amortizimit, për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, objekti Zyrat e Qendrës Ekonomike e Magazina, në vlerën vjetore prej 197,219 lekë për v.2015 dhe për v.2016 lekë, objekte që efektivisht nuk ekzistojnë për periudhën objekt auditimi, dhe për rrjedhojë këto rregjistrime denatyrojnë treguesit e shpenzimeve në bilancin kontabël të këtij institucioni. Nga ana tjetër, edhe përlllogaritja e amortizimit, për pjesën e rikonstruksionit të kryer sipas një fondi të akorduar nga MAS, llogaritet për një objekt, i cili, nuk është në pronësi të DAR, sepse objektet shkollorë janë në administrim të pushtetit vendor.
Kriteri:	Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”; Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006 dhe me ligjin nr. 10110, datë 02.04. 2009; VKM nr. 204, datë 26.03.21998 “Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit vendor”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12. 2011, “Për menaxhimin e aktiveveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjsteve që varen prej tyre”, i ndryshuar;
Ndikimi/Efekti	Vlera e reflektuar në pasqyrat financiare për amortizimin nuk është e saktë, pasi është rritur me pa të drejtë llogaria 219 ”Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme”.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Nga Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme, të merren masa të menjëhershme për rillogaritjen e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, për vitet 2015, 2016 e 2017 si dhe të kryejë sistemimet e nevojshme dhe të pasqyrojë situatën e duhur në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare që do të mbyllen për vitin 2017.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i

Gjetjes 4:

Mbi regjistrimin e transfertave në buxhetet familjare

Situata:	Auditimi në Formatin nr. 3/1 të llogarisë 606 “Transferta për buxhete familjare e individë” me rakordimin e shpenzimeve me Degën e Thesarit Tiranë, konstatoi se në këtë llogari janë mbajtur vlerat e transferuara nga MoF dhe ministria e linjës (MAS) të përdorura për shpërblime të punonjësve kur dalin në pension; punonjësve me sëmundje të rënda dhe të gjata, kompensimin e çmimit të librave për nxënësit rom si dhe për nxënësit që kanë prindërit me ndihmë ekonomike dhe me sëmundje të
-----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	rënda e të gjata. Kjo llogari është pasqyruar për të njëjtën vlerë dhe kaluar tek klasa 6, <i>llog 603 “Subvencionet”</i> , në vend që të pasqyrohej tek llogaria 606 “transferime për buxhetet familiare e individuale”.
Kriteri:	Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “ <i>Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare</i> ”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006 dhe me ligjin nr. 10110, datë 02.04. 2009; UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “ <i>Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjstëve që varen prej tyre</i> ”, i ndryshuar;
Ndikimi/ Efekti	Kjo ka ndikuar në mos pasqyrimin e vlerës reale në llogarinë 606, megjithatë, kjo konsiderohet si pasaktësi jomateriale për pasqyrat financiare
Rëndësia	I ulët
Rekomandimi	Sektori i Shërbimeve të Brendshme të kryejë sistemimet e duhura në bilancin e vitit 2017, dhe pjesën e “Transferteve për buxhetet familjare e individë”, ta pasqyrojë në kolonën nr. 38, llogaria 606 “transferime për buxhetet familiare e individuale”, në bazë të rakordimit të shpenzimeve me Degën e Thesarit Tiranë, dhe jo në llogarinë 603 “Subvencione”, sikundër është veprur për vitin 2015 dhe 2016 në formatin përkatës nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit”.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Çështja IV – Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Titulli i Gjetjes 1: Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në praktikë nga drejtuesit e programeve buxhetore.

Situata:	Nga auditimi u konstatua se, rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë praktika pak të zhvilluara në praktikë. Nga ana tjetër, për natyrën e veçantë të këtij subjekti publik, koncepti i “Menaxhimit të Riskut” dhe vendosja e kontroleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e DAR Qark Tiranë. Ndonëse janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Riskeve, mungon monitorimi i kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Në institucionin e DAR Qark është hartuar regjistri i riskut ku janë evidentuar risqet para kontrollit dhe përcaktuar zotëruesit e këtyre risqeve, si Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektorin e TIK, Sektorin e Programim Zhvillimit. Për periudhën objekt auditimi, nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Riskeve dhe plani i veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 8/a, 10 dhe 21/ 2, të ligjit nr. 10296/ 2010.
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	Nga analiza e rubrikave të plotësuara të Pyetësorit sipas komponentëve mbi MFK, konstatohet se vlerësimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar janë kryer me pikë (1-3), por për vitin 2015 dhe 2016, nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e pikës nr. 17, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pasi Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka të përfshira gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe nuk referon një plan veprimi për të ardhmen, sikundër përcaktohet në këtë udhëzim. Konstatohet se: 4. Ky dokument është hartuar për vitin 2015, (me nr. 195 prot, datë 29.01.2016) dhe nuk është përditësuar. 5. Nuk janë pjesë e këtij regjistri aktivitet që realizon Sektori i Kurikulës dhe Cilësisë, për kërcënimin e objektivave themelore të këtij sektori, (përfshij mangësitë dhe parregullsitë në zbatimin e kërkesave të portalit “Mësues për Shqipërinë”). 6. Nuk parashikohet niveli i ri i risqeve pas aplikimit të kontrolleve, referuar programit buxhetor afatmesëm, etj.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave (i ndryshuar).
Ndikimi	Kërcënohen arritja e objektivave të institucionit
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	1. DAR Qark Tiranë, të marrë masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Drejtorinë e Buxhetit dhe Drejtorinë e Financës së Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, për të mundur vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 “Menaxhimi i riskut”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. 2. DAR Qark Tiranë të rishikojë çdo vit dhe përditësojë Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioritetëve dhe qëlimeve afatmesme e afatgjata bazë që ka ky institucion, në zbatim të neneve 10 dhe 21, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim
Titulli i Gjetjes 2	Mungesa e planit të trajnimeve dhe e hartës së proceseve të punës në Institucion
Situata:	Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale njësia arsimore vendore nuk disponon plane të trajnimeve dhe mungon një data-base mbi trainimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik, për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e pikës nr. 3/1, nënçështja “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore”, të Kapitullit III të Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhërin nr. 108, datë 17.11.2016. Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime të stafit në drejtim të në drejtim njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimin e fondeve publike së njësive menaxhuese. U verifikua zbatimi i kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, mbi përgatitja e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës. Këto manuale garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Auditimi i KLSH-së vëren se, ka një moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së përshkrimit të proceseve të punës. Jo vetëm kaq, por përshkrimi i procesit të punës konfundohej me përshkrimin e pozicionit të punës. Për të bërë të mundur që çdo institucion të përgatisë manualin e proceseve të punës. struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave ka përgatitur dhe një format standard për të asistuar institucionet për ta realizuar këtë proces në vazhdimësi.
Kriteri:	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
Ndikimi/Efekti	Trajnimi dhe kualifikimi synojnë që të përgatisin punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur
Rëndësia	I Mesëm
Rekomandimi	Nga DAR Qark në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat e duhura për parashikimin e nevojave për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, dhe në bazë të këtyre parashikimeve të hartohen dhe kryhen trajnime dhe seminare, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe nga Ministria e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	Financave dhe Ekonomisë, vecanërisht mbi aspektet e analizës së Menaxhimit të Riskut, për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve në dispozicion, prokurimin publik elektronik, si dhe të gjitha detyrimeve të tjera, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave etj. Të sigurohet pjesëmarrja në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, drejtuesve të njësive shpenzuese, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues, drejtuesve të shkollave si dhe specialistëve të tjerë. Detyrimi për trainimin e stafit dhe drejtorëve të shkollave mbi aspektet e menaxhimit financiar bëhet i domosdoshëm, për faktin se ato autorizojnë pagesat e mësuesve për orët mësimore sipas normës së miratuar dhe ato mbinormë, shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve, subvencionimin e teksteve shkollore për kategoritë vulnerabël, etj. DARQT të përgatisë manualin e proceseve të punës, bazuar në modelimin dhe formatet standarde të lëshuara nga struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave, për të asistuar institucionet për ta realizuar këtë proces.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 3

Nuk janë miratuar përkshkrimet e pozicioneve të punës nga Sekretari i Përgjithshëm i MASR

Situata:	Nga auditimi konstatohet se, në nenin 27, “Përkshkrimi i vendeve të punës”, të Rregullores së Brendshme tip, miratuar nga Ministri MASH me nr. 311/1, datë 18.1.2011, është përcaktuar se: <i>“Drejtori i DAR-it/ përgjegjësi i ZA-së miratojnë përkshkrimin e vendit të punës për secilin punonjës. Në përkshkrimin e vendit të punës së përgjegjësit të sektorit parashikohet që në një pjesë të kohës kryen detyra si specialisti sektorit”.</i> Këto përcaktime të Rregullores së brendshme nuk përputhen me kërkesat e pikës 18, germa “c”, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 “Për përkshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, sipas së cilës, përkshkrimet e vendit të punës miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë. Konkretisht: <i>“Përkshkrimi i punës miratohet nga:</i> <i>a) sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për Kryeministrinë dhe institucionet në varësi të Kryeministrit;</i> <i>b) sekretari i Përgjithshëm i institucionit të pavarur, për institucionet e pavarura;</i> <i>c) sekretari i Përgjithshëm i ministrisë, për ministrinë dhe institucionet në varësi të ministrit;</i> <i>ç) sekretari i Përgjithshëm apo pozicioni ekuivalent me të, për njësitë e qeverisjes vendore.”</i>
Kriteri:	Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, VKM nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përkshkrimin dhe klasifikimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	<i>pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, Udhëzimi i DAP nr. 2, datë 7.4.2014, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.</i>
Ndikimi/Efekti	Paqartësia në ndarjen e roleve dhe përgjegjësi të aktorëve në kuadër të procesve të kontrollit të brendshëm, krijon konfuzion dhe mbivendosje të tyre.
Rëndësia	I Mesëm
Rekomandimi	1. Drejtori i DARQT dhe njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, të koordinojë veprimet dhe miratojë përshkrimet e punës tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe Departamentin e Administratës Publike, në përputhje me kërkesat e pikës 18, germa “c”, kreu IV, të VKM nr. 142/2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” si dhe pikës nr. 4.1.1, kreu IV, të Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 2, datë 7.4.2014, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”. 2. MASR të marrë masa të shfuqizojë nenin 27, të Rregullores tip të DAR, miratuar nga Ministri MASH me nr. 311/1, datë 18.1.2011, si të papajtueshme me VKM nr. 142, datë 12.03.2014, i ndryshuar.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Çështja VI – Transporti i mësuesve dhe nxënësve

Titulli i Gjetjes 1: Moskryerja e procedurave të prokurimit të fondeve publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimore, sipas linjave rrethqytetase

Situata:	Nga auditimi u konstatua se, DAR Qarku Tiranë për periudhën objekt auditimi nuk ka prokuruar fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimore, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.
Kriteri:	VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Moskryerja e procedurave të tenderit nuk garanton shërbimin më të mirë për përfituesit (mësuesit dhe nxënësit)
Rëndësia	I mesëm



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Rekomandimi	Nëpunësi autorizues të marrë masa, për zbatimin në kohë të përcaktimeve të VKM nr. 682, datë 29.07.2015, i ndryshuar, duke hapur procedurën e tenderit për fondet e programuara, ne lidhje me shërbimin e transportit për mësuesit të cilët punojnë dhe nxënësit të cilët mësojnë jashtë vendbanimit.
Afati	Në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 2: **Për vonesat në miratimin e hartës së linjave dhe dobësitë në ndjekjen e kontratës për pagesat e shërbimit të transportit të mësuesve dhe nxënësve.**

Situata:	1.Nga auditimi mbi miratimin e linjave për vitin akademik 2015-2016 si dhe 2016-2017, u konstatua se, edhe pse viti shkollor fillon në shtator dhe përfundon në qershor të viti pasardhës, DAR Qarku Tiranë në vitet objekt auditimi nuk ka çuar miratimin e linjave përpara fillimit të vitit shkollor, por këto linja janë dërguar praktikisht për vitin akademik 2015-2016 në muajin tetor dhe për vitin 2016-2017 në muajin gusht, institucioni i ka dërguar për miratim hartën e linjave me shkresën nr. .2170 prot. Datë 09.10.2017, pra në muajin tetor. Për të dyja vitet akademike, institucioni edhe pse viti akademik ka filluar në muajin shtator, dërgimi për miratimin e linjave si dhe miratimi nga Bashkia e Tiranës <u>ka rezultuar dy muaj me vonesë nga fillimi i vitit akademik</u>, duke shkaktuar kjo vonesa në pagesat e mësuesve dhe nxënësve të cilët mësojnë jashtë qendrës së banimit. 2.Nga auditimi u konstatua se për vitin 2015 institucioni nuk ka lidhur kontratë shërbimi me Postën Shqiptare. Për vitin 2017 referuar kontratës së lidhur me nr. nr. 2494/1 datë 08.11.2017, për pagesat e kryera për muajt shtator- dhjetor nga [REDAKTUAR], për shërbimin e transport të nxënësve, nuk ka gjetur zbatim neni 7 i kontratës, ku përcaktohet se, “[REDAKTUAR] ka për detyrim që në fund të çdo muaji të bëjë akt rakordimet dhe të japë informacion në DARQT mbi numrin e përfituesve dhe shumën e lekëve të shpërndara” dhe neni 6 i ssj, sipas të cilit, “DARQT ka të drejtë të kërkojë nga [REDAKTUAR], çdo fund muaji pasardhës të raportojë mbi numrin e përfituesve si dhe shumën e tërhequra nga përfituesi”.
Kriteri:	VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar,
Ndikimi/ Efekti	Mosndjekja me rigozitet të përcaktimeve të kontratës, krijon rrishtje për shumën e fondeve të shpërndara dhe efikasitetin e tyre. Mos plotësimi i kërkesave për monitorimin rrezikon të çënojë procesin që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve, me fondet përkatëse për realizimin e tyre.
Rëndësia	I lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Rekomandimi	1.Nëpunësi autorizues së bashku me Sektorin e Programeve të Zhvillimit dhe atë të Shërbimeve të Përgjithshme (<i>që bëjnë hartën e linjave si dhe planifikimin e buxhetit për këtë zë</i>), të marrin masa për dëgimin në kohë të kërkesave për hartimin e linjave, duke u lënë hapësirën e nevojëshme kohore orageneve të pushtetit vendor për të kryer verifikimet si dhe miratimin e tyre, përpara fillimit të viti shkollor, për të mundësuar realizimin e qëllimit të këtij objekti si dhe pagesën nga ana e Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme në kohë për nxënësit që mësojnë dhe mësuesit të cilët punojnë jashtë vendbanimit të tyre. 2.Nëpunësi autorizues së bashku me strukturat përgjegjëse të marrë masa, në respektimin e kontratës së lidhur me Postën Shqiptare, sidomos mbi me verifikimin dhe monitorimin nga ana e DARQT të pagesave sipas kategorive që përcakton VKM, por me prioritet pagesat për nxënësit që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre.
Afati	Në vazhdimësi

Çështja II/d – Mbi funksionimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe procedurat e emërimit të mësuesve

Titulli i Gjetjes 1: Tregues shumë të ulët të performancës për rekrutimet nga gara konkurruese e portalit

Situata:	1. Në Portalin “Mësues për Shqipërinë” për juridiksionin e DARQT, konkurimi 2015-2016 dhe 2016-2017 <u>kanë marrë pjesë 587 aplikantë gjithsej dhe janë sistemuar në vende vakante /definitive 98 kandidatë, ndërsa në pozicione provizore 49 kandidatë. Pra, konstatohet se vetëm 16,6 % e kandidatëve që kanë konkurruar nëpërmjet këtyre dy portaleve janë sistemuar me kontratë punësimi definitive, (ose vetëm 25 % janë punësuar nga pozicioni definitiv dhe zëvendësues).</u> 2. Në Portalin “Mësues për Shqipërinë” 2015 dhe 2016 për DARQT janë sistemuar në vende vakante të gjithë kandidatët e profileve <i>Arsim Special</i>, përkatësisht 1 kandidat në portalin e vitit 2016-2017. Referuar të dhënave në tabelën e përgjithshme të renditjes së kandidatëve pjesëmarrës në portale, u evidentua se numrin më të lartë të kandidatëve, që janë punësuar, e përbëjnë ato të profilit <i>Arsimi Fillor, Gjuha Angleze, Matematikë, etj..</i> 3. Asnjëri nga kandidatët e profileve <i>Shkenca Shoqërore, Gjuha Frënge, Gjuha Gjermane, Gjuha Italiane</i>, të listuar në portalin 2015-2016 dhe kandidatët e profileve <i>Gjeografi, TIK, Edukim Muzikor e Shkenca Shoqërore</i> të listuar në portalin 2016-2017, nuk ka arritur të emërohet nëpërmjet DAR Qark Tiranë.
Kriteri:	✓ Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	✓ Udhëzimi i MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.
Ndikimi/ Efekti	Nuk arrihen synimet e portalit, në bërë të së cilës, “ <i>kjo nismë do të krijojë mundësi për të rinjtë të cilëve do t’u ofrohen mundësi reale punësimi dhe përfitimi të eksperiencave pozitive në drejtim të mësimdhënies. Angazhimi i tyre si mësues në zonat ku ata aplikojnë ose në komunitetet në nevojë i shërben pozitivisht çdo individ, por edhe vetë shoqërisë</i> ”.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Të përsosën mekanizmat, për të nxitur jo vetëm pjesëmarrjen e mësuesve dhe të rinjve të diplomuar në procesin e konkurimit në portalin e punësimit “Mësues për Shqipërinë”, por edhe të krijojnë mundësinë reale të punësimit të tyre. Në këtë mënyrë, kjo iniciativë mund të ndikojë në përmirësimin e cilësisë në arsim në komunitetet në nevojë si dhe në ndryshimin e mentalitetit të kërkuesve të punës në arsim, meqenëse, ende në disa shkolla ka një numër të lartë të mësuesve jashtë profilin apo pa arsimin përktës.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

**Titulli i
Gjetjes 2:**

Ende në shkollat e DARQT ka një numër të ndjeshëm të mësuesve pa arsim përkatës dhe jashtë profilin.

Situata:	1. Pavarësisht faktit që, janë zhvilluar disa portale për rekrutimin dhe plotësimin e pozicioneve të punësimit (2014, 2015-2016, 2016-2017 dhe tani është në proces portali 2017-2018), rezulton se, ende në disa shkolla të zonave të thella malore, japin mësim 17 mësues pa arsim përkatës dhe 14 mësues jashtë profilin . Këto vende pune, nga DAR-ja nuk rezultojnë të dokumentuara të shpallur si vende pune të lira, por pretendohet se asnjë nga mësuesit e portalit, nuk kanë pranuar të shkojnë të punojnë në këto pozicione të largëta. Për KV dhe zyrtarët e DARQT problematikë ngelet mospranimi i vendeve vakant në shkollat të cilat gjenden jashtë zonave urbane si në Klllojkë, Njësia administrative Zall-Bastar.
Kriteri:	Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi i MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.
Ndikimi/ Efekti	Mësuesit me arsimin përktës dhe kualifikimet e nevojshme mund të garantojnë mësimdhënie cilësore dhe kontribuojnë në përgatitjen e brezave të ardhshëm të shkolluar
Rëndësia	I Lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

Rekomandimi	DRQT të marrë masat dhe të shpallë si vende pune të lira, ato profile/degë ku edhe japin mësim 17 mësues pa arsim përkatës dhe 14 mësues jashtë profilin dhe të shikohet mundësia e zëvendësimeve apo lëvizjeve paralele, me persona kompetentë që kanë përfunduar studimet në fushën e mësimdhënies.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 3: **Mangësi në dokumentimin e procedurave të ndjekura nga Komisioni i Vlerësimit (KV) për emërimet.**

Situata:	1. Nga auditimi vërehet se, KV nuk ka një regjistrim të procedurave për rastet e njoftimit të kandidatëve, si për marrjen e konfirmimit, (apo refuzimit me shkrim për mospranim të vendeve apo pozicioneve të punësimit të ofruara), ose të regjistrimit dhe printimit për përgjigjet me SMS për refuzimin e vendeve të ofruara. Këto veprime bien ndesh me kërkesat e Kreut III, pika 3 të udhëzimit të MS nr. 38/2015, që pëcakton se “Komisioni dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat”. Auditimi konstaton raste të shumta të refuzimeve (mospranimit) për mundësitë e ofruara kandidatëve të rankuar më lartë, meqenëse kjo lidhet me largësinë e madhe të shkollave apo me ofrimin e një pozicioni punësimi të përkohshëm (si zëvendësues për raport leje lindje, etj). 2. Komisioni i Vlerësimit nuk ka bërë raportimet 3-mujore në MAS mbi monitorimin e punësimeve të kandidatëve pjesëmarrës në portal, siç përcaktohet në Kreun 5, pika 5/g, të udhëzimit nr. 38 të MAS, si dhe nuk ka asnjë raport, sipas cilësimeve të germës “g” të Kreu V, pika 5, mbi “Monitorimin e punësimeve sipas renditjes së përgjithshme të kandidatëve dhe raportimin në MAS, çdo tre muaj”.
Kriteri:	Udhëzimi i MAS-it nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.
Ndikimi/Efekti	Cënohet parimi i plotësisë së informacionit të raportuar dhe kjo pengon ndjekjen e gjurmës së auditimit.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Komisioni i Vlerësimit të regjistrojë dhe dokumentojë të gjitha aspektet e punës dhe mbledhjeve të tij, të evidentojë refuzimeve (mospranimit) për mundësitë e ofruara kandidatëve të rankuar në renditjen përfundimtare të portalit, si dhe të monitorojë procesin e emërimeve në kuadër qarku, duke informuar Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, çdo tre muaj.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

C.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Titulli i Gjetjes 1: Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për largimin e padrejtë nga puna të punonjësve.

Situata:	Janë likuiduar shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas 14 urdhër shpenzimeve të kaluara në thesar për vitin 2015 për 5 persona në shumën 6,222,721 lekë, 3 urdhër shpenzimeve për vitin 2016 për 2 persona në shumën 1,747,075 lekë dhe 16 urdhër shpenzimeve në vitin 2017 për 5 persona në shumën 4,264,861 lekë. E gjithë shuma për ekzekutimin këtyre vendimeve gjyqësore, është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit duke qenë se i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, në shumën 12,234,657 lekë në total, ku përfshihen 368,200 lekë tarifa përmbartimore dhe shpenzime gjyqësore.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	E gjithë shuma për ekzekutimin këtyre vendimeve gjyqësore në shumën 12,234,657 lekë në total, (ku përfshihen 368,200 lekë tarifa përmbartimore dhe shpenzime gjyqësore), është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit, meqenëse i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna të punonjësve
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	DARQT të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumën e shenjuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, pasi u përkasin vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, në shumën 12,234,657 lekë në total, ku përfshihen 368,200 lekë tarifa përmbartimore dhe shpenzime gjyqësore
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 2: Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për periudhën e audituar 2015 e 2016 gjendja e saj paraqitet respektivisht me vlerën 3,455,707 lekë, si stok i 31,427 copë libra shkollorë jashtë katalogut.

Situata:	Kjo vlerë përfaqëson një kontingjent prej 89 artikujsh të regjistruar të librave stok, të regjistruar në v.2015 dhe 77 artikujsh në v.2016, ose 31,427 copë librash shkollorë jashtë katalogut, që përfaqëson
-----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	përkatësisht: - Tekste të arsimit 9 vjeçar, 16.752 copë libra, me vlerë 1.670.555 lekë, - Tekste të arsimit të mesëm, 14.675 copë libra, me vlerë 1.472.675 lekë. Këto gjendje të stokut të librit në magazinë, janë krijuara gjatë periudhës 2002 - 2005, duke mbetur stok pasi janë jashtë <i>curriculum-ave</i> (jashtë programit mësimor), e për pasojë nuk kanë vlera përdorimi. Krijimi i një nomenklature të tillë të librit shkollor stok prej 31,427 copë librash shkollor jashtë katalogut me vlerën 3,455,707 lekë lidhet vetëm me DAR Qark, (por kjo situatë rezulton dhe në DAR Qytet, ku stoku i librit në v.2015 është në vlerën 4,453,819 lekë, gjë që do të thotë se vetëm në dy DAR-et e Qytetit dhe Qarkut Tiranë arrin vlerën 7,9 milionë lekë), tregon për një proces të pa studiuar dhe një përdorim jo efektiv të fondeve të buxhetit për periudhat kur ata janë shpenzuar.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Krijimi i një nomenklature të tillë të librit shkollor stok prej 31,427 copë librash shkollor jashtë katalogut me vlerën 3,455,707 lekë lidhet vetëm me DAR Qark, (por kjo situatë rezulton dhe në DAR Qytet, ku stoku i librit në v.2015 është në vlerën 4,453,819 lekë, gjë që do të thotë se vetëm në dy DAR-et e Qytetit dhe Qarkut Tiranë arrin vlerën 7,9 milionë lekë), tregon për një proces të pa studiuar dhe një përdorim jo efektiv të fondeve të buxhetit për periudhat kur ata janë shpenzuar.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	a. Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të evidentojë dhe vlerësojë gjendjen në shkallë vendi, të librit shkollor të mbetur stok, tekste që janë jashtë <i>curriculum-ave</i> (jashtë programit mësimor), e për pasojë nuk kanë vlera përdorimi dhe mbi këtë bazë të hartojë e miratojë një udhëzim të posaçëm, se si do të veprohet për këtë kontigjent të teksteve shkollore stok dhe jashtë funksionit, duke shqyrtuar gjetjen e mundësive për një përdorim eficient të këtyre vlerave. Ky proces duhet shoqëruar edhe me një analizë të shkaqeve, nxjerrjen e përgjegjësive dhe me reflektim në praktikën aktuale, për të mos u përballur me situata të ngjashme në të ardhmen.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6 muajve të parë 2018.

Në vijim po paraqesim një opinion, bazuar në konstatimet kryesore që kanë rezultuar gjatë auditimit dhe të pasqyruara më lartë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

OPINIONI I AUDITUESIT:

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100⁴ dhe 4200⁵) e shpenzimeve:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë⁶, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti, DARQ Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan në përgjithësi zbatimi tyre por edhe disa raste të devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat kryesisht, konsistojnë si më poshtë:

Në drejtim të menaxhimit financia dhe kontrollit të brendshëm publik, zbatimin e kërkesave të portalit të punësimit të mësuesve, rritjes në një nivel më të lartë të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit menaxherial, të hartimit të rregullave të brendshme për gjurmët e auditimit në funksion të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore.

Konkluzion/Opinion:

Nën gjykimin tonë, aktiviteti i DARQT, kontrollet e brendshme të zbatuara si dhe pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë gjendjen e këtij institucioni, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë përputhshmërinë dhe raportimin financiar.

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë Arsimore Rajonale Qarku Tiranë u konstatuan edhe devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të konsideruara jo materiale, për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**.

VI. ANEKSE

Anekset janë pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështje të mëposhtme:

Aneksi nr.1: Qasja dhe metodologjia e Auditimit

Aneksi nr. 2: Llojet e opinionit të plikuar nga KLSH-ja

Aneksi nr.3 “ Mbi gjendjen e librit stok dhe me qarkullim të ngadalashëm”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

⁴ ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

⁵ ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.

⁶ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

ANEKSI I:

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar **materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë** të planifikuara për t’u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë **faktoret e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet**, niveli i precizionit pranohet në vlerën **20,814,218** lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm **kanë risk të ulët deri në të moderuar**. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (*u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli*);

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditimi, (në këtë **rast 50 çështje ose artikuj**) mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:

Çështje për t'u shqyrtuar = (Artikulli buxhetor : Precizioni x Faktor risku)

Niveli i materialitetit për vitin 2016, është përlllogaritur sipas tabelës së mëposhtme.:

Drejtoria Arsimore Rajonale Qark Tirane			
Sruktura Buxhetore	Baza e materialitetit	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7, 2, 3)	Çështje për t'u shqyrtuar = (Artikull/Precizion x Faktor risku)
Paga (600)	1,095,699,248	0.70	37
Sigurime Shoqërore (601)	151,092,983	0.70	5
Mallra e Shërbime (602)	10,956,279	2.00	1
Të tjera transfertë korrente (604)	-	0.70	0
Transferta korrente të huaja (605)	-	0.70	0
Tranf. buxhetet familjare indiv. (606)	16,446,477	7.00	6
Investime të brendshme (230)	10,633,288	2.00	1
Investime të brendshme (231)	-	2.00	0
Garanci kontrate (5%)		7.00	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

	-		
Gjithsej			50

Totali	1,284,828,275
---------------	----------------------

Materialiteti në %	2%
--------------------	----

Materialiteti në vlerë	25,696,566
------------------------	-------------------

Përlllogaritja e saktësisë	
Materialiteti	25,696,566
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	2,569,657
Nën-Totali	23,126,909
Saktësia e planifikuar (80 - 90%)	90%
Saktësia (precizioni)	20,814,218

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2016, grupi i auditimit mori në shqyrtim **40 çështje/artikuj** për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizmin, mbi llogarinë **600 e 601 (kjo reflektuar në letrat e punës, pjesë e dosjes së auditimit)**. Gjithashtu u shqyrtuan **3 çështje për llogarinë 230 nga 1 e llogaritur sipas formulës** (ose 100% e mbulimit të këtij zëri), për të verifikuar plotësinë, ndodhjen, matjen, rregullshmërinë dhe zbatueshmërinë; dhe **7 çështje për llogarinë 602 nga 1 e llogaritur sipas formulës, (blerja e mallrave dhe shërbimeve)**.

Mbi verifikimin dhe rakordimin e gjendjeve të llogarive në fund të periudhës, grupi i auditimit analizoi dhe verifikoi ekzistencën, plotësinë, vlerësimin dhe alokimin e tyre.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione



ANEKSI II:

LLOJET E OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Baza për Opinionin

a. Manuali i auditimit të përputhshmërisë në KLSH.

Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

Një **opinion i pakualifikuar** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësine publike të audituar; dhe
- janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Opinionit me rezerve. Opinionit me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinionit i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Opinionit negativ (kundërshtues). Opinionit negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinionit qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

ANEKSI III:

Gjendja e librit shkollor stok, DARQT, 2015

		Inventari i librit stok ne magazine 31.12.2015					
	Kod Artikulli	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera	Llog aria
1	,001	Gjuhe Shqipe 6 Viti 2003	cope	77	110	8470	35
2	,002	Gjuhe Shqipe 6 Viti 2004	cope	537	110	59070	35
3	,003	Lexim Letrar 6 Viti 2003	cope	173	110	19030	35
4	,004	Lexim Letrar 6 Viti 2004	cope	537	110	59070	35
5	,005	Matem 6 Viti 2003	cope	202	110	22220	35
6	,006	Matem 6 Viti 2004	cope	894	110	98340	35
7	,007	Histori 6 Viti 2003	cope	93	110	10230	35
8	,008	Histori 6 Viti 2004	cope	877	110	96470	35
9	,009	Biologji 6 Viti 2003	cope	47	110	5170	35
10	,010	Biologji 6 Viti 2004	cope	877	110	96470	35
11	,011	Gjeogr 6 Viti 2003	cope	216	110	23760	35
12	,012	Gjeogr 6 Viti 2004	cope	894	110	98340	35
14	,014	Fizika 6 Viti 2004	cope	621	110	68310	35
15	,015	Eduk Qytet 6 Viti 2003	cope	82	110	9020	35
16	,016	Eduk Qytet 6 Viti 2004	cope	894	110	98340	35
17	,017	Eduk Muzik 6 Viti 2004	cope	894	110	98340	35
19	,019	Eduk Shendet 6 Viti 2004	cope	894	110	98340	35
20	,020	Gjuhe Angl. 6 Viti 2003	cope	453	110	49830	35
21	,021	Gjuhe Freng. 6 Viti 2004	cope	208	110	22880	35
24	,024	Fizik . 7 Viti 2003	cope	133	110	14630	35
25	,025	Eduk.Qytet 7. Viti 2003	cope	64	110	7040	35
26	,026	Eduk. Shendet 7Viti 2003	cope	107	110	11770	35
27	,027	Anglisht 7 Viti 2003	cope	106	110	11660	35
28	,028	Freng.7 Viti 2003	cope	440	110	48400	35
31	,031	Shuqe Shqipe 8 Viti 2005	cope	168	113	18984	35
32	,032	Lexim 8 Viti 2005	cope	79	147	11613	35
33	,033	Matem 8 Viti 2005	cope	120	148	17760	35
34	,034	Histori 8 Viti 2005	cope	157	135	21195	35
35	,035	Fizike 8 Viti 2005	cope	85	127	10795	35
36	,036	Gjeog 8 Viti 2005	cope	133	114	15162	35
38	,038	Edukate qyt.8	cope	105	53	5565	35
41	,041	Biologji kl.8	cope	162	155	25110	35
42	,042	Fl.Mod.Kl.1 v.03	cope	370	40	14800	35
43	,043	Fl.mod.kl.2 v.03	cope	400	40	16000	35
44	,044	Fl.pun.nx.kl.1 v.03	cope	600	70	42000	35



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “DAR Qark Tiranë”

45	,045	Fl.p.gjuhe kl.1 "	cope	203	45	9135	35
47	,047	Fl.pune.mat.2 "	cope	950	85	80750	35
50	,050	Fl.pune.mat.6 "	cope	1,400	85	119000	35
51	,051	Fl.pune fizike 6 "	cope	1,500	85	127500	35
		Arsimi i mesem					
52	,052	Anglisht viti 2 "	cope	100	110	11000	35
53	,053	Anglisht viti 3 "	cope	100	110	11000	35
54	,054	Fizike viti 3 "	cope	307	110	33770	35
55	,055	Biologji viti 3 "	cope	308	110	33880	35
56	,056	Letersi shqip.3 "	cope	100	110	11000	35
57	,057	Letersi bot.3 "	cope	340	110	37400	35
58	,058	Matemat.3/1 "	cope	527	110	57970	35
59	,059	Matem.3/2 "	cope	324	110	35640	35
60	,060	Histori koha sot."	cope	197	110	21670	35
61	,061	Kimi 11 "	cope	500	110	55000	35
63	,063	Hyrje ne filozofi "	cope	179	110	19690	35
64	,064	Fizike 3 fl.p.lab. "	cope	900	80	72000	35
65	,065	Kimi 12 "	cope	215	110	23650	35
66	,066	Astronomi 4 "	cope	202	110	22220	35
67	,067	Letersi bot 4 "	cope	115	110	12650	35
68	,068	Fizike fl.p.lab.4 "	cope	380	80	30400	35
69	,069	Fl.pun.ab.v.2004	cope	215	70	15050	35
70	,070	Mat 3 fl.p. "	cope	185	85	15725	35
71	,071	Mat.7 Fl.p. "	cope	1,270	90	114300	35
72	,072	Fiz.7.fl.p. "	cope	690	90	62100	35
73	,073	Fiz.6.fl.p.lab. "	cope	1,670	85	141950	35
75	,075	Freng.2 "	cope	195	110	21450	35
77	,077	Qytetari 3 "	cope	143	110	15730	35
78	,078	Anglisht 3 "	cope	200	110	22000	35
79	,079	Ekonomi zbat.3 "	cope	537	110	59070	35
80	,080	Matemat.4/1 "	cope	598	110	65780	35
81	,081	Fizike 4 "	cope	580	110	63800	35
82	,082	Kimi 12 "	cope	500	110	55000	35
83	,083	Biologji 12 "	cope	583	110	64130	35
84	,084	Hist.Pop.Shq. "	cope	300	110	33000	35
85	,085	Let.bot.4 "	cope	650	110	71500	35
86	,086	Let.shq.4 "	cope	445	110	48950	35
87	,087	Matem.4/2 "	cope	580	110	63800	35
88	,088	Gjuhe ang.4 "	cope	240	110	26400	35
89	,089	Fizike 4.fl.p. lab. "	cope	300	80	24000	35
		Totali				3,143244	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “**DAR Qark Tiranë**”